



Koha

www.koha.mk



Sheriati nuk është ligj!

FAQE 13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3139 • E premte 4 gusht 2017 15 DEN

Shumica e sigurt për miratimin e Ligjit për shqipen



Shkup, 3 gusht - Partitë e shumicës parlamentare - LSDM, BDI dhe LR-PDSH shprehën të sigurt se Ligji për gjuan shqipe shumë shpejtë do të miratohet në Parlament ndërsa vonesa e deritashme nuk është arsye për shtyrje eventuale të zgjedhjeve. Tomisllav Tuntev, koordinator

i grupit Parlamentarë të LSDM-së të enjten në Parlament i quajti të pasakta akuzat e partive opozitare se për shkak të Ligjit për gjuhën shqipe, zgjedhjet mund të mos shpallen më 6 gusht. "Nuk e shoh që Ligji për gjuhët është arsye për shtyrje të zgjedhjeve lokale. Në fund të seancës, Ligi për

gjuhët do të jetë në procedurë parlamentare bashkë me paketën e ligjeve nga sfera e ekonomisë dhe ajo sociale. Pra ligji për gjuhët nuk është pengesë për zgjedhjet lokale", theksoi Tomisllav Tuntev nga LSDM. Ai, po ashtu deklaroi se deputetët e shumicës parlamentare...

FAQE 3

Një e treta e amvisërive vështirë paguajnë borxhet

Varfëria po bllokton llogaritë



Më shumë se një e treta e totalit apo 189.730 amvisëri në Maqedoni kanë vështirësi që me kohë të paguajnë llogaritë komunale, taksën radiodifuzive dhe këstet e kredive, andaj dhe u janë bllokuar llogaritë në muajin mars të këtij viti

FAQE 4

"Vala..." e falimentuar rikthehet me format të ri



Shkup, 3 gusht - Një prej projekteve të Ministrisë së Kulturës që në vite konsumoi të tërë interesin e pjesëmarrësve, "Vala e ngrohtë e kulturës", do të realizohet sërisht edhe këtë vit. Për shkak të borxheve të akumuluar, por edhe të interesimit të pakët të komunave për të marrë pjesë në të, realizimi i këtij projekti për

këtë vit u vu në pikëpyetje, derisa Ministria e Kulturës vendosi që me vonesë të shpallë këto ditë konkursin, të ndarë në dy afate. Me emërtesë dhe kritere të reja aplikimi, konkursi për "Valën e re të kulturës", vjen i formatuar ndryshe, edhe pse thelbi mbetet i njëjtë, demetropolizimi i kulturës dhe transferimi nga qendra

drejt qyteteve më të vogla. Po ashtu, është zhvendosur edhe periudha e shtrirjes së manifestimit, që këtë vit do të jetë nga muajit shtator e deri në fund të tetorit. Ndër risitë e konkurrimit është se e drejta për të marrë pjesë nuk i takon vetëm komunave, por edhe organizatave, shoqatave...

FAQE 2

SPECIALE

Pa dashuruar, zemra ime nuk mund të jetë e lumtur



Martesa më së fundi fiksohet për datën 21 gusht 1745. Mëngjesin e kësaj dite Katerina, pasi bën një banjë, drejtohet nga apartamentet e Elizabetës, e cila me disa gra të tjera e zhveshin lakuriq dhe e kontrollojnë. Katerina...

FAQE 12

RAJON

Çfarë do të bëhet me transgjiorët e ushtrisë amerikane

FAQE 15

FORUM

Rama-Zaev, përjashtimi nga rregulli në Evropë

FAQE 10

RAJON

Konstituohet Parlamenti në Kosovë



FAQE 15



Zgjerohet zjarri në Makedonski Brod, zjarr i ri në Zërnovci

Shkup, 3 gusht - Zjarri në zonën e f. Trebovle në komunën e Makedonski Brodit ende është aktiv, por tani për tani nuk ka rrezik për fshatin, informojnë nga Qendra për menaxhim me kriza. Sipas të dhënave deri në orën tetë të mëngjesit, për këtë rajon planor jug-perëndimor, është penguar edhe përparimi i zjarrit drejt f. Rastesh dhe ajo pjesë e zjarrit po kontrollohet. Në këtë hapësirë kanë vepruar pjesëtarët e ARM-së, NJTZ, EP Makedonski Brod dhe EP Kavadar, Në rajonin planor Tetovë-Pollog, zjarri i cili është aktiv në f.Zdunje në Makedonski Brod ka tendencë për zgjerim në pjesën e f. Gurgurnicë në komunën e Tetovës. Zjarri pyjor në rajonin midis fshatrave Devič dhe Greshnicë, është aktiv, por për momentin nuk ka rrezik në vendin e banuar. Në shuarjen e këtij zjarri kanë intervenuar NJTZ Makedonski Brod dhe EP Makedonski Brod. Zjarri që një kohë të gjatë është aktiv në rajonin e Makedonski Brodit, në orët e pasdites dje është shpërndarë në territorin e Komunës së Goditavrit, në pjesën e fshatrave Koritë dhe Zhelezna Reka.

Zjarri është në terren të papërshtatshëm për automjetet. Është përfshirë edhe sipërfaqja me bari të thatë, dëllinjë dhe pyll të përzier. Në shuarjen e zjarrit të f.Zhelezna Reka ka intervenuar ekipi i SHAR Gostivar. I njëjti nga ana e f.Strajane dhe te manastiri është lokalizuar, ndërsa nga ana e kundërt ende është aktiv. EP "Shar"- Gostivar, raporton se në pjesën e f. Koritë po digjet bari i thatë dhe kullosat dhe gjendja atje nuk është e rrezikshme.

Në Rajonin planor të Shkupit nga Brigada për mbrojtje kundër zjarreve të qytetit të Shkupit njoftojnë se gjatë ditës së djeshme nga ora 21:45, po intervenojnë në pyllin e djegur në zonën e f. Studeničan, komuna e Studeniçanit.

Me emërtesë dhe kritere të reja aplikimi, konkursi vjen i formatuar ndryshe, edhe pse thelbi mbetet i njëjtë, demetropolizimi i kulturës dhe transferimi nga qendra drejt periferisë. Ndër risitë e konkurrimit është se e drejta për të marrë pjesë nuk i takon vetëm komunave, por edhe organizatave, shoqatave të qytetarëve, grupeve joformale, krijuesve nga sfera e artit dhe kulturës. Ende nuk dihet nëse ndryshimet do të ndikojnë tek pjesa shqiptare, kryesisht komunat, të cilat për gati dhjetë vjet e kanë konsideruar si të paarsyeshme pjesëmarrjen

Koha **Evis HALILI**

Shkup, 3 gusht - Një prej projekteve të Ministrisë së Kulturës që në vite konsumoi të tërë interesin e pjesëmarrësve, "Vala e ngrohtë e kulturës", do të realizohet sërish edhe këtë vit. Për shkak të borxheve të akumuluar, por edhe të interesimit të pakët të komunave për të marrë pjesë në të, realizimi i këtij projekti për këtë vit u vu në pikëpyetje, derisa Ministria e Kulturës vendosi që me vonesë të shpallë këto ditë konkursin, të ndarë në dy afate. Me emërtesë dhe kritere të reja aplikimi, konkursi për "Valën e re të kulturës", vjen i formatuar ndryshe, edhe pse thelbi mbetet i njëjtë, demetropolizimi i kulturës dhe transferimi nga qendra drejt qyteteve më të vogla. Po ashtu, është zhvendosur edhe periudha e shtirjes së manifestimit, që këtë vit do të jetë nga muaji shtator e deri në fund të tetorit. Ndër risitë e konkurrimit është se e drejta për të marrë pjesë nuk i takon vetëm komunave, por edhe organizatave, shoqatave të qytetarëve, grupeve joformale, krijuesve nga sfera e artit dhe

Ministria e Kulturës shpall konkursin në dy afate

"Vala..." e falimentuar rikthehet me format të ri



kulturës.... Sipas Ministrisë së Kulturës, edhe pse janë duke u përballuar me probleme financiare serioze për shkak të borxheve të trashëguara, për këtë manifestim kanë siguruar një buxhet prej dhjetë milionë denarësh. Të vetëdijshëm për sasinë e limituar të të hollave, i apelojnë donatorëve që të kontribuojnë në plotësimin e nevojave dhe vizioneve të manifestimit. Afati i parë i konkurrimit zgjat deri më 14 gusht, ndërsa afati i dytë është nga data 16 gusht. Projektet do të shqyrtohen brenda një afati të shkurtër, manifestimi do të nisë nga fundi i muajit gusht dhe do të zgjasë deri në fund të tetorit, ndërsa për datat e fillimit dhe mbarimit të tij Ministria e Kulturës ende nuk i ka saktësuar.

"Qëllimi i manifestimit është që të sigurohet demetropolizimi dhe decentralizimi i kulturës, disperzimi në mjediset lokale dhe pasurimi masivizimi dhe lëvizja e ofertës kulturore nëpër të gjitha rajonet e Maqedonisë...", sqarojnë nga ky institucion me rastin e shpalljes së konkursit. Ende nuk dihet nëse ndryshimet do të ndikojnë tek pjesa shqiptare, kryesisht komunat, të cilat për gati dhjetë vjet e kanë konsideruar si të paarsyeshme pjesëmarrjen. Gjatë këtyre viteve pjesa më e madhe nuk kanë konkurruar për arsye reale, mungesën e shtëpive apo qendrave të kulturës, si në Haraçinë, Saraj, e të tjera, edhe pse edhe paradoksalisht asnjë prej tyre nuk ka bërë kërkesë për

themelimin e një të tille. Ndërsa komunat e tjera, kryesisht arsyetohen me buxhetin e vogël që akordohet, si të pamjaftueshëm për të realizuar një manifestim të tillë. Në vit, në fillimet e "turneut festiv të verës", konkurronin mesatarisht rreth 30 komuna, si Resnja, Pehçeva, Strumica, Manastiri, Prilepi, Ohri, Dojrani e të tjera, ndërkohë që në konkursin e fundit numri u reduktua në tre dhe interesimi ishte shumë i vogël. Por pavarësisht se cila komunë zgjidhjet fituese, "Vala e ngrohtë e kulturës", ka pasur si destinacion edhe komunat shqiptare në të cilat zhvilloheshin aktivitete dhe manifestime sipas një agjende të përcaktuar nga Ministria e Kulturës.

Gratë shtatzëna dhe personat mbi 60 vjeç të lirohen nga puna

Shkup, 3 gusht - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) i përkujton punëdhënësit për obligimin e tyre për respektimin e rekomandimeve për mbrojtjen e punëtorëve, ndërsa lidhur me paralajmërimet për kushtet e motit dhe temperaturat shumë të larta gjatë ditëve në vijim. Pas takimit të mbajtur të Komisionit për valë të nxehta,

rekomandohet gjatë tri ditëve të ardhshme (prej të premtës deri të dielën) prej obligimeve të punës të lirohen gratë shtatzëna dhe personat mbi moshën 60-vjeçare, ndërsa të gjithë personat e tjerë gjatë paraqitjes së çfarëdo problemi shëndetësor menjëherë të paraqiten tek mjeku i tyre amë. Punëdhënësit e rekomandohet që ta riorganizojnë

orarin e punës në drejtim të shmangies së aktiviteteve në qiell të hapur në periudhë prej orës 11 deri në orën 17, si dhe sigurimin e pushimit nën hije dhe lëngjeve të mjaftueshme çdo dy orë. Gjithashtu, rekomandim është që të mos mbahej aktivitete sportive në qiell të hapur në periudhën prej orës 11 deri në orën 17, ndërsa veçanërisht rekomandohet

që institucionet që kujdesen për fëmijët (kopshtet e fëmijëve) të mos i nxjerrin fëmijët në qiell të hapur dhe të mos praktikojnë aktivitet fizik në periudhën e njëjtë. Shkelje të rekomandimeve nga punëdhënësit mund të paraqiten edhe tek inspektori kujdestar i cili i koordinon ekipet në vend 075 402 856, informojnë nga MPPS.

"Proto Tema" për projektin Greqi-Maqedoni-Serbi

Si mund të arrijë Vardari dhe Danubi deri në Selanik!

Athinë, 3 gusht - Projekti grandioz për ndërlidhje të kryeqytetit serb, beogradit me Selanikun përmes rrugës ujore, përmes Moravës dhe Vardarit, mund ta shndërrojë portin grek në qendër kyçe për transport të mallrave drejt Evropës së mesme, thekson gazeta athinase "Proto Tema". Gazeta përkujton se bëhet fjalë për projekt të përbashkët të Greqisë, Maqedonisë dhe Serbisë, për realizimin e të cilit posaçërisht është e intere-

suar Kina, i cili do të kushtonte 17 miliardë dollarë amerikanë. Sipas "Proto Tema"-s, bëhet fjalë për ide të kryeministrit grek Aleksis Cipras, i cili dëshiron që emri i tij të ndërlidhet me këtë projekt të rëndësishëm, i cili do t'i sillte rëndësi të madhe gjeostrategjike Selanikut. Kanali për lidhje të Danubit me Detin Egje, duhet të jetë i gjatë 650 kilometra dhe me të Selaniku do të bëhet i kapshëm përmes rrugës ujore edhe për vendet nga Evropa e

Mesme. projekti është prioritet për qeveritë e Greqisë, Maqedonisë dhe Serbisë, por edhe Kinës, e cila është e interesuar për getje të rrugëve alternative për transport më të shpejtë dhe më të lirë të mallrave të saj drejt Evropës, thekson "Proto Tema". Gazeta shton se për realizimin e këtij projekti është biseduar edhe në takimin e kohë më parshëm të kryeministrit grek Cipras me presidentin serb Vuçiq. Sipas planit, është paraparë af-

tësimi i Vardarit dhe Moravës për lundrim në kanalit për lidhjen e tyre, i cili do të ishte i gjatë rreth 30 kilometra. "Proto Tema" përkujton se ky nuk është plani i parë për ndërtimin e kanalit lundruar që i ndërlidhë Selanikun dhe Beogradin, duke shtuar se ideja e tillë ka ekzistuar që nga mesi i shekullit 19, kur Austro-Hungaria e fuqishme ka inicuar projekt për lidhje të Vjenës me Detin Egje përmes rrugës ujore.





BESA kundër shtyrjes së zgjedhjeve lokale

Shumica e sigurt për miratimin e shqipes

"Në fund të seancës, Ligi për gjuhët do të jetë në procedurë parlamentare bashkë me paketën e ligjeve nga sfera e ekonomisë dhe ajo sociale. Pra, Ligi për gjuhët nuk është pengesë për zgjedhjet lokale", theksoi Tomisllav Tuntev nga LSDM. Se Ligi për gjuhën shqipe do të miratohet brenda njëqind ditëshit të parë të Qeverisë shprehet i sigurt dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 3 gusht - Partitë e shumicës parlamentare - LSDM, BDI dhe LR-PDSH shprehen të sigurt se Ligji për gjuan shqipe shumë shpejtë do të miratohet në Parlament ndërsa vonesa e deritashme nuk është arsye për shtyrje eventuale të zgjedhjeve. Tomisllav Tuntev, koordinator i grupit Parlamentarë të LSDM-së të enjten në Parlament i quajti të pasakta akuzat e partive opozitare se për shkak të Ligjit për gjuhën shqipe, zgjedhjet mund të mos shpallen më 6 gusht. "Nuk e shoh që Ligi për gjuhët është arsye për shtyrje të zgjedhjeve lokale. Në fund të seancës, Ligi për gjuhët do të jetë në procedurë parlamentare bashkë me paketën e ligjeve nga sfera



e ekonomisë dhe ajo sociale. Pra ligji për gjuhët nuk është pengesë për zgjedhjet lokale", theksoi Tomisllav Tuntev nga LSDM. Ai, po ashtu deklaroi se deputetët e shumicës parlamentare janë marrë vesh që të mos i shfrytëzojnë pushimet vjetore përderisa nuk përfundon diskutimi për shkarkimin e Prokurorit Publik, Marko Zverlevskit. "Ne jemi në qëndrimin që të mos shkojmë në pushim përderisa Zverlevski nuk shkarkohet. Jemi në pajtim dhe kemi premtuar se do të diskutojmë dhe pas propozimit të opozitës për emërimin e prokurorit publik. Pritet rebalanci i buxhetit të përfundojë deri në fund të javës, pas të cilit pritet që kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi t'i caktojë zgjedhjet lokale", tha Tuntev. Se Ligi për gjuhën shqipe do të miratohet brenda njëqind ditëshit të parë të

Qeverisë shprehet i sigurt dhe ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari, njëherësh sekretar i përgjithshëm i LR-PDSH-së. "Ashtu siç kemi theksuar para futjes në Qeveri, flas për LR-PDSH, e përsërisim dhe tani. Që ditën e parë kur u emërova ministër dhe hymë në Qeveri, e kemi thënë dhe e themi sërish se ligji për gjuhën shqipe do të kalojë në 100 ditët e para të Qeverisë", ka theksuar Arben Taravari. Ai ka potencuar se nuk ka mospajtime mes partnerëve qeveritar, ndërsa është shprehur se askush nuk do të braktis Qeverinë, pasi tashmë janë të koordinuar rreth kësaj çështje. Sipas Taravarit, nëse LR-PDSH ka përgjegjësi për 36.000 vota shqiptare, përgjegjësia më e madhe bie edhe mbi LSDM-në, e cila ka më shumë vota shqiptare se LR-PDSH. "Kështu që, ata sikurse ne kanë obligim... të mos

flasim për BDI-në, të cilët pothuajse dy herë më shumë obligim se ne. Konsiderojmë se kjo do të kalojë. Ka pajtim tek të gjitha partnerët e koalicionit që gjuha shqipe të kalojë në 100 ditët e para", ka shtuar ministri Arben Taravari. Nga ana tjetër, vetë zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, një ditë më parë i tha gazetës KOHA se Ligji për gjuhën shqipe mund të vijë në Parlament para datës 8 gusht kur është paraparë që deputetë të shkojnë në pushim vjetor. Paraprakisht nga Lëvizja BESA të enjten thanë në Parlament se partitë në pushtet - LSDM dhe BDI mund ta përdorin Ligjin për gjuhën shqipe me qëllim për ti shtyrë zgjedhjet lokale, ndërkaq si parti - Lëvizja BESA është kundër shtyrjes së zgjedhjeve lokale. "Situata e krijuar lë hapësirë të mendojmë se edhe Ligji për gjuhën shqipe nuk sillet me qëllim

AFRIM GASHI

"Situata e krijuar lë hapësirë të mendojmë se edhe Ligji për gjuhën shqipe nuk sillet me qëllim që të përdoret si alibi për shtyrjen e zgjedhjeve. Kjo, për shkak se LSDM nuk dëshiron ta sjellë Ligjin para zgjedhjeve, ndërsa nëse BDI shkon në zgjedhje pa Ligjin e gjuhëve, atëherë do të shkatërrohet. Ne besuam se BDI kur hyri në Qeveri ka bërë të paktën marrëveshje për Ligjin për gjuhën shqipe, por situata e krijuar dëshmon se BDI nuk ka bërë asnjë marrëveshje për hyrje në Qeveri dhe se është vasale e partive maqedonase

ARBEN TARAVARI

"Nëse LR-PDSH ka përgjegjësi për 36.000 vota shqiptare, përgjegjësia më e madhe bie edhe mbi LSDM-në, e cila ka më shumë vota shqiptare se LR-PDSH. Kështu që, ata sikurse ne kanë obligim... të mos flasim për BDI-në, të cilët pothuajse dy herë më shumë obligim se ne. Konsiderojmë se kjo do të kalojë. Ka pajtim tek të gjitha partnerët e koalicionit që gjuha shqipe të kalojë në 100 ditët e para

lim që të përdoret si alibi për shtyrjen e zgjedhjeve. Kjo, për shkak se LSDM nuk dëshiron ta sjellë Ligjin para zgjedhjeve, ndërsa nëse BDI shkon në zgjedhje pa Ligjin e gjuhëve, atëherë do të shkatërrohet. Ne besuam se BDI kur hyri në Qeveri ka bërë të paktën marrëveshje për Ligjin për gjuhën shqipe, por situata e krijuar dëshmon se BDI nuk ka bërë asnjë marrëveshje për hyrje në Qeveri dhe se është vasale e partive maqedonase", ka akuzuar deputeti i BESËS, Afrim Gashi. Sa i përket shtyrjes së zgjed-

hjeve lokale nuk duket opionion i pamundur kur LSDM - që po udhëheq me Qeverinë e re, nuk i konvenon aspak që ato të mbahen më datë 15 tetor. Kjo për shkak se partia e kryeministrit Zoran Zaev e preokupuar me instalimin e pushtetit në të gjitha nivelet dhe me reformat në shumë sfera në opinion po llogaritet se kjo parti do të pres impaktet pozitive të reformave dhe realizimit të premtimeve si ajo për pagën minimale që të ndihet e sigurt se të paktën do të barazojë me VMRO-në në zgjedhje lokale.

Vazhdon debati në Parlamentin e Maqedonisë

Pushteti mbron rebalancin: I bazuar në projekte reale

Shkup, 3 gusht - Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të enjten e vazhdoi debatin për rebalancin e Buxhetit, që filloi të martën. Buxheti i masakruar, shkurtrim i investimeve të kapitalit, të mjeteve në arsim, shëndetësi, polici, armatë... në llogari të shpenzimeve joproductive, punësimet partiake dhe ndërimit të kampeve të refugjatëve, janë vërejtjet kryesore që i shprehën deputetët e opozitës. Nga LSDM-ja u kundërpërgjigjën, se me rebalancin e investimeve të kapitalit nuk shkurtohen, por barazohen në bazë reale, ndërsa vërejtjet e VMRO-DPMNE-së do të mbaheshin nëse kjo parti nuk ishte në pushtet 11 vjet. I pari në akuzat e opozitës replikoi ministri i Financave, Dragan Tevdoski. "Nuk është e saktë se investimet e kapitalit

shkurtohen, por përkundraz, janë vendosur realisht. Në Buxhet këtë vit janë paraparë 27 miliardë denarë për investimet e kapitalit, ndërsa me rebalancin janë reduktuar në 23,4 miliardë. Ky nuk është shkurtrim, por projektim optimist sepse realizimi vitin e kaluar ka qenë 16,9 miliardë denarë. Asnjë vit investimet e kapitalit nuk kanë arritur 19 miliardë denarë, ndërsa tani jashtë vendosur pesë miliardë më i lartë. Këtë ju duhet ta keni të qartë sepse çdo buxhet nga kriza globale e këtij, është projektuar në mënyrë të rrejshme te investimet e kapitalit, shitej përrallë se goja ka ndonjë zhvillim", theksoi Tevdoski. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2017, shtoi, realizimi i investimeve të kapitalit është 8,7 miliardë denarë, ndërsa me rebalancin për

gjashtë muajt e ardhshëm janë projektuar investimet e kapitalit në vlerë sa realizimi në tërë vitin 2016 që aspak nuk është shkurtrim, por madje edhe projektim optimist. "Investimet e kapitalit në arsim vitin e kaluar kanë qenë 1,1 miliardë denarë, ndërkaq tani, me rebalancin janë vendosur në 1,8 miliardë ose 64 për qind më shumë. Nuk bëhet fjalë për shkurtrim. Investimet e përgjithshme në arsim vitin e kaluar kanë qenë 3,77 për qind nga BPV, ndërsa me rebalancin arrijnë 3,96 për qind. Kemi projektim shumë më të lartë nga realizimi në vitin 2016," thekson ministri. Deputetët shqiptarë fokusin e diskutimit të tyre e vendosën në zhvillim rajonal. Theksuan se me rebalancin, sërish nuk janë shpërndarë në mënyrë të barabartë

mjetet për këtë qëllim. Rebalanci, theksuan është social, në vend për zhvillim, ndërsa qëllimi është i njëjtë si në buxhetet paraprake, të shfrytëzohet për qëllime politike. "Vazhdon zakoni i vjetër për mosshpërndarje të mjeteve në të gjitha rajonet barabartë, posaçërisht në pjesën e infrastrukturës. Buxheti duhet të jetë i balancuar, e jo i ndryshëm për shtresat e ndryshme në Maqedoni. U zotuar si deputet se do të ndërtojë shoqëri të barabartë në pajtim me standardet evropiane sepse pretendojmë të jemi pjesë nga BE-ja. Shpresojmë se në vitin 2018 do të kemi buxhet të drejtë, të barabartë për të gjithë qytetarëve në të gjitha rajonet", ishte qëndrimi i deputetëve shqiptarë. Debati për rebalancin duhet të vazhdojë pas pauzës së rregullt njëorëshe. (F.R)

Aktakuzë për sulmuesin e Shekerinskës

Shkup, 3 korrik - Për sulmin brutal të deputetëve dhe gazetarëve që më 27 prill ndodhi në Parlament, Prokuroria e Shkupit së fundmi e ka shqyrtuar hapjen e procedurës hetimore për dhunuesin e deputetes Radmilla Shekerinska. Ngjashëm si shumica e të akuzuarve, edhe ky sulmues nga ana e Prokurorisë ngarkohet për vepër penale "dhunë", për të cilën Kodi Penal i Maqedonisë ka paraparë heqje lirie prej tre deri në pesë vite burg. Pas përfundimit të kësaj procedure hetimore,

Prokuroria e Shkupit deri te Gjykata Penale e Shkupit ka dorëzuar aktakuzë kundër personit të dyshuar për sulmin ndaj ministres aktuale të Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska. Sipas përshkrimit të akuzës, sulmuesi ngarkohet se gjatë kohës kur ka ndodhur thyerja brutale e dyerve të Parlamentit, ai ka kryer dhunë brutale, me çka e ka kapur për flokësh deputeten e Parlamentit të Maqedonisë. Me këtë rast, e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore.





Një e treta e amvisërive vështirë paguajnë borxhet

Varfëria po bllokoi llogaritë

Më shumë se një e treta e totalit apo 189.730 amvisëri në Maqedoni kanë vështirësi që me kohë të paguajnë llogaritë komunale, taksën radiodifuzive dhe këstet e kredive, andaj dhe u janë bllokuar llogaritë në muajin mars të këtij viti

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 3 gusht - Në katër e vitet e kaluara është zvogëluar numri i llogarive të bllokuara të firmave, ndërsa është dyfishuar numri i llogarive të qytetarëve që janë bllokuar. Më shumë se një e treta e totalit apo afër 190 mijë amvisëri në Maqedoni kanë vështirësi që me kohë të paguajnë llogaritë komunale, taksën radiodifuzive dhe këstet e kredive, andaj dhe u janë bllokuara llogaritë në muajin mars të këtij viti. Sipas statistikës së Bankës Popullore të Maqedonisë, në periudhën mars 2013 deri në mars të këtij viti, është rritur prej 93.447 në 189.730 numri i llogarive të bllokuara të qytetarëve, dhe është zvogëluar po në këtë kohë nga 60.121 në 51.916 numri i llogarive të bllokuara të bizneseve. Me këtë statistikë përfshihen bllokadat e deponentëve dhe llogarive transaksionale në banka sipas vendimeve ekzekutive për



ELEM-I PËR GJASHTË MUJ ME FITIM PREJ 8.6 MILIONË EURO

SHA ELEM në gjashtë muajt e parë të këtij viti realizoi neto fitim prej 533 milionë denarë ose 8,6 milionë euro, ndërsa depozitat në disa banka vendore së bashku me 31 korrikun janë 1.250 milionë denarë, gjegjësisht 20 milionë euro, informoi drejtori i përgjithshëm i kompanisë, Hristian Mickoski në takim me gazetarët. Ai theksoi se kompania rregullisht i shlyen obligimet e veta ndaj shtetit, partnerëve afaristë dhe të punësuarve dhe theksoi se së bashku me 31 korrikun janë paguar të gjitha kërkesat e skaduara. Para kohe është paguar edhe kredia ndaj Bankës Botërore në shumë prej 903.526 dollarë. "Kompania është me rezultate financiare të shkëlqyeshme dhe kondicioni i shkëlqyer financiar dhe likuiditet, ndërsa edhe kapaciteti teknik është në nivel të lakmueshëm. Vazhdojmë t'i dërgojmë sasi të domosdoshme për konsumatorët në tregun e rregullt, ndërsa do të përpiqemi edhe një pjesë të këtyre sasive, në pajtim me mundësitë tona, në nivel vjetor t'i plasojmë në pjesën e lirë të tregut", tha Mickoski.

borxhet e kryera dhe të papaguara. Nëse përllogaritet se në Maqedoni - në mesatare jetojnë afër 500 mijë amvisëri, atëherë del se më shumë se një e treta e numrit të tyre janë me llogari të bllokuara. Qytetarët më së shpeshti bllokohen për shkak të

vonesës së pagesës së llogarive komunale, taksës radiodifuzive dhe kësteve të kredive. Nga ana tjetër, rritje të vazhdueshme tregun hyrja në borxh e amvisërive në banka që në muajin maj të vitit 2017 ka qenë e vlefshme 134.896 milionë denarë e

që paraqet një rritje të konsiderueshme në raport me 115.577 milionë denarë në muajin korrik të vitit 2015. Me fjalë të tjera, është rritur hyrja në borxh e amvisërive prej 1 miliardë e 870 milionë euro në 2 miliardë e 190 milionë euro.

Ekonomistët nuk janë të befashuar me trendin e rritjes së borxhit të qytetarëve si dhe vonesës së pagesës së borxheve të qytetarëve, për shkak të mungesës së parave të mjaftueshme nga ana e amvisërive për një jetesë me dinjitet dhe pa brenge, andaj qytetarët bëjnë çmos që të kapërcejnë hendekun midis nevojave dhe mundësive reale të xhepit. Sipas ekonomistëve, standardi i ulët, çmimet e larta të shërbimeve dhe prodhimeve të ndryshme dhe pagat e ulëta diktojnë faktin që qytetarët nuk mundën me kohë të paguajnë borxhet, andaj janë të detyruar që me të madhe të marrim borxhe të reja nëpër banka. Në dy vitet e kaluara shënon rritje niveli i borxheve të qytetarëve në banka prej më shumë se 300 milionë euro. Më shumë se gjysma e borxheve ka të bëjë me kreditë për mbulimin e nevojave themelore si pagesa e llogarive, blerja për nevojat e amvisërive, kreditë konsumatore pa të cilat vështirë mund të mendohet rinovimi i teknikës së bardhë si televizorit apo frigoriferit, pagesën e borxheve të mbetura dhe kësteve të ndryshme të kredive konsumatore. Kreditë konsumatore, kreditë banesore apo minuset në kartelat kreditore tregojnë rritje edhe si rrjedhojë e presionit të krizës ekonomike dhe tejkalimit të hendekut mes të ard-

hurave dhe harxhimeve mujore të familjeve. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të BPRM-së, rreth 55 për qind e borxhit të amvisërive ndaj bankave ka të bëjë me qytetarët që marrin paga deri në 30 mijë denarë. Më së shumti kanë marrë borxhe nëpër banka qytetarët me paga prej 15 mijë deri 30 mijë denarë, që me 35 për qind marrin pjesë në totalin e kredive. Ato kanë rreth 280 mijë shfrytëzues dhe shumë borxhi prej 47.115.752 mijë denarë apo rreth 600 milionë euro.

Të dytët me 78 mijë shfrytëzues të kredive janë qytetarët që marrin paga prej 30-50 mijë denarë me borxh prej afër 300 milionë euro, ndërsa të tretët janë me 15 për qind apo afër 250 mijë shfrytëzues, qytetarët me paga prej 7-15 mijë denarë e që kanë borxh prej afër 300 milionë euro ndaj bankave.

Ndryshe, sipas zyrës evropiane të statistikës - EUROSTAT, të ardhurat për frymë nga Brut Prodhimi Vendor në Maqedoni janë sa 36 për qind e mesatares së Bashkimit Evropian, ndërsa konsumi aktual për frymë vlerësohet në 40 për qind të mesatares së BE-së. Këto të dhëna tregojnë se Maqedonia është vendi i tretë më i varfër në Evropë. Më të varfër se Maqedonia, sipas EUROSTAT-it, janë vetëm Bosnje e Hercegovina dhe Shqipëria.

Nga viti i ardhshëm fillon E-Tatimi personal

Hiqet detyrimi për paraqitjen e tatimit personal

Novaković sqaron se nga 1 gushti fillon zbatimi i aktiviteteve, ku bashkërisht do të marrin pjesë të gjitha palët e involvuara në procesin e krijimit dhe testimit e shërbimeve tatimore të sistemit të ri E-Tatim Personal

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 3 gusht - Nga fillimi i këtij muaji, Drejtoria për të Hyra Publike (DHP) do të fillojë me thjeshtësimin e procedurave për paraqitjen e formularit vjetor për tatim personal të firmave dhe qytetarëve, me çka realizimi i kësaj reforma në masë të madhe do të ndryshon mënyrën e përllogaritjes së tatimit personal nga vetë firmat, qytetarët dhe zyrat e kontabilitetit. Vesna Novaković sqaron se nga 1



gushti fillon zbatimi i aktiviteteve, ku bashkërisht do të marrin pjesë të

gjitha palët e involvuara në procesin e krijimit dhe testimit e shërbimeve

tatimore të sistemit të ri E-Tatim Personal. "Njëra nga ndryshimet pozitive që do të ndodhë e që pritet të realizohet me E-Tatimin personal është se hiqet dorëzimi i formularit vjetor për tatim personal nga ana e qytetarëve dhe firmave nëpër sportelet e DHP-së", thotë Novaković. Me zbatimin e këtij Ligji, i cili do të hynë fuqi pasi të bëhet ndryshimi i ligjit për tatim personal, Novaković shprehet se firmat dhe qytetarët nga viti i ardhshëm nuk kanë detyrim në sportelet e DHP-së të paraqesin personalisht formularët për tatim personal. "E-Tatimi do të realizohet në dy faza. E para do të jetë përgatitja dhe dorëzimi i llogarive të tatimit personal nga ana e firmave përmes llogarisë elektronike E-Tatimi personal. Përgatitja dhe dorëzimi i llogarisë elektronike të qytetarëve për realizimin e fitimeve dhe llogaritjen e akontacionit të pagesës së tatimit. Ky sistem i ri

njëherësh ofron që qytetarët për gjatë tërë viti të kenë qasje në raportin e DHP për të gjitha pagesat e kryera nga ana e firmave", thotë Novaković. Faza e dytë e sistemit të ri E-Tatim personal, sipas Novaković, ka të bëjë me dhënien e fletëparaqitjes vjetore të tatimit nga ana e DHP-së deri te qytetarit, ku i përmban të gjitha të dhënat për të ardhura plotësuese të realizuara gjatë një viti kalendarik. "DHP deri të qytetarët lëshon formularin e plotësuar për tatimi vjetor në bazë të dhënave të dorëzuar nga firmat dhe qytetarët që realizojnë të hyra plotësuese. Qytetarët kanë për obligim të vërtetojnë se përllogaritja është e saktë dhe të njëjtën përmes postës elektronike ta kthejnë prapa deri të DHP-ja. Nëse në formularin e përgatitur nga DHP në bazë të llogarive të bëra nga firmat apo vetë qytetarët atëherë ata mund të bëjnë korrigjimin dhe përsëri të njëjtën e kthen

deri të DHP-ja. Pikërisht vendosja e këtij sistemi të ri E-tatim personal nga viti i ardhshëm i liron qytetarët dhe firmat që të shkojnë dhe të presin me orë të gjata para sporteleve të DHP-së që të dorëzojnë formularin për tatim personal vjetor", thotë Novaković. Pra ky detyrim hiqet dhe sipas Novaković, nga viti i ardhshëm qytetarët dhe firmat do lirohen nga detyrimi që vetë të plotësojnë dhe dorëzojnë formularët për tatim vjetor në sportelet e DHP-së. Projekti për thjeshtësimin e procedurave për paraqitjen e tatimit personal vjetor sipas Novaković financohet nga Fondet IPA në vlerë prej 93.730 euro dhe nga buxheti i Republikës së Maqedonisë në vlerë prej 574.800 euro. Njëherët projekti është pjesë e Programit për modernizimin e DHP-së 2017-2020. Ndryshe, sipas DHP-së, çdo vit 300 mijë qytetar dorëzojnë formularë për tatim vjetor.



Gati ratifikimi i Konventës së Stambollit

Çdo e treta grua dhunohet në baza gjinore

Ministria Carovska tha se dhuna seksuale dhe dhuna në familje janë përpjekje më dominante të dhunës në baza gjinore, por në Maqedoni shumë pak flitet për të dhe shumë pak raportohen rastet e tilla

Koha Evis HALILI

Shkup, 3 gusht - Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Shëndetësisë në Maqedoni kanë prezantuar të enjten përgatitjen për ratifikimin dhe zbatimin e "Konventës së Stambollit" - miratimin e politikave dhe praktikave më të mira për eliminimin e dhunës ndaj grave. Përgatitja e ratifikimit dhe zbatimit të "Konventës së Stambollit" mbështetet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (KB), e cila ka siguruar mjete financiare në vlerë prej 300 mijë dollarë amerikanë.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska, theksoi se një nga prioritetet e Qeverisë së Maqedonisë është të fillojë procesin e ratifikimit të Konventës së Stambollit, por për këtë siç tha ajo, nevojitet intervenimi nga shteti dhe mundësi për përdorimin e fondeve ndërkombëtare. "Ratifikimi është një çështje, por vendosja e një mekanizmi që ajo konventë të jetë e zbatuar në Maqedoni kërkon mjete financiare dhe kushte të cilat drejtpërdrejt do t'u ofrohen qytetarëve", u shpreh Carovska. Ajo shtoi se dhuna seksuale dhe dhuna në familje janë përpjekje më dominante të dhunës në



TARAVARI PARALAJMËRON SHKARKIMIN E 8 DREJTORËVE

Ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari deklaroi se do të emërohen gjashtë deri në tetë drejtorë të rinj të disa klinikave dhe spitaleve, ndërsa do të ketë edhe emërimet e tjera. Duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve pas konferencës për shtyp në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale theksoi se mendojnë për drejtorë të caktuar të cilët do të mbeten në vendet e drejtorëve. "Ende nuk mund të them saktë. Megjithatë tanimë mendojmë për disa drejtorë të cilët do të mbeten. Ndoshta do të jenë në periferi, ndoshta në Qendrën klinike. Ende bëjmë konsultime", shtoi Taravari.

baza gjinore, por në Maqedoni shumë pak flitet për të dhe shumë pak raportohen rastet e tilla. Carovska theksoi se dikasteri që drejton ajo është në përgatitje të hapjes së Qendrës për mbrojtje nga dhuna seksuale, që do të funksionojë për strehim të viktimave gjatë periudhës së ndjekjes së procedurave nga autoritetet kompetente.

Ndërkaq, ministri i Shëndetësisë, Arben Taravari, bëri të ditur se do të hapen edhe tre qendra të tjera që do të merren me diskriminimin e gjinisë femërore. "Ministria e Shëndetësisë

është e gatshme që këtë program ta zhvillojë në tre qendra të cilat do të hapen në Maqedoni për këta persona të gjinisë femërore që janë të diskriminuar. Ato tre qendrat do jenë në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë", u shpreh Taravari. Nga ana tjetër, koordinatoresha e përhershme e KB-së dhe përfaqësuesja e Programit për Zhvillim të KB-së, Loiusa Vinton, tha se zbatimi i Konventës së Stambollit gjithmonë ka qenë prioritet i të gjitha organizatave të Kombeve të Bashkuara me zyrë në Maqedoni. "Vështirë gjenden të dhëna të sakta,

por duket qartë se sipas statistikave nga vendet tjera, një në çdo tre gra në Maqedoni gjatë jetës së saj do të jetë viktimë e një forme të dhunës me baza gjinore. Në suaza botërore kjo do të thotë se një në çdo gjashtë persona në planet do të jetë viktimë e një dhune të tillë", theksoi Vinton. Në konferencën për media u njoftua se hapja e qendrave parashikohet të realizohet para Vitit të Ri, pasi që siç thanë ato, së pari nevojiten disa ndryshime të ligjeve në Kuvendin e Maqedonisë. Ndryshe, hapat e këtij projekti që parashihen të zbatohen ndërmerren në bazë të Konventës së Këshillit Evropian për parandalimin dhe luftën kundër dhunës familjare dhe asaj ndaj grave (e njohur si Konventa e Stambollit), e cila është themeluar në vitin 2011. Në botë "Konventa e Stambollit" është e njohur si instrumenti më i mirë ligjor në luftën kundër dhunës në familje dhe në të gjitha format e tjera të dhunës me baza gjinore.

Disa pjesë të Maqedonisë në fazën e portokalltë

Shkup, 3 gusht - Rajoni i Vardarit Verior dhe Ohrit-Prepsës sot (e premte) do të përfshihen me temperatura nga faza e portokalltë, njoftoi Drejtoria për punë hidrometeorologjike (DPHM). Moti në Maqedoni do të jetë me diell dhe shumë i ngrohtë me erë të dobët deri në mesatare nga drejtimi verilindor. Temperatura e mëngjesit do të lëvizë prej 10 deri në 19, ndërsa ajo ditore prej 33 deri në 40 gradë. Indeksi UV do të jetë 9. Në Shkup moti do të jetë me diell dhe shumë i ngrohtë me erë të dobët deri në mesatare nga drejtimi verilindor. Temperatura e mëngjesit do të arrijë deri në 18, ndërsa ajo ditore deri në 40 gradë Celsius. DPHM informon se vazhdon periodua e motit kryesisht me diell dhe shumë të ngrohtë. Në pjesën më të madhe të vendit temperatura maksimale do të arrijë mbi 35, ndërsa në disa vende përgjatë luginës së Vardarit do të tejkalojë edhe 40 gradë. Celsius. Posaçërisht i ngrohtë moti do të jetë i ngrohtë gjatë ditëve të fundjavës, kur temperatura maksimale në rajonet më të ngrohta do të arrijë deri në 42 gradë. Indeksi UV do të jetë shumë i lartë, me vlerë 9.

Tetova nis me restriktionet e ujit

Tetovë, 3 gusht - Komuna e Tetovës nga sonte fillon me restriktionet e ujit. Në një njoftim për mediat, ndërmarrja komunale "Tetova" thotë se, me qëllim të furnizimit të barabartë me ujë për pije për të gjithë qytetarët në të gjitha lagjet e qytetit, NPK Tetova nga sot (03.08.2017) do të fillojë me restriktion prej disa orësh edhe atë: nga 00:30 deri në orën 03.00 të mëngjesit. "Shkak i restriktionit është mungesa e sasisë si dhe keqpërdorimi i ujit për pije nga ana e qytetarëve. Sasia e ujit për pije momentalisht është rreth 340 l/s. Duke marrë parasysh temperaturat e larta që regjistrohen ditëve të fundit në Tetovë, NPK "Tetova" Tetovë iu bën apel qytetarëve që në mënyrë racionale të bëjnë shfrytëzimin e ujit të pijshëm, sepse vetëm kështu nuk do të paraqiten mungesa të sasisë së ujit në lagjet e epërme të qytetit. NPK "Tetova" - Tetovë u bën thirrje qytetarëve që të denoncojnë raste të shpërdorimit të ujit dhe të njoftojnë kur kanë probleme me furnizimin me ujë për pije", thuhet në njoftimin e NPK "Tetova".

Shkup, 24 aksidente për dy ditë

Shkup, 3 gusht - Gjatë dy ditëve të kaluara në rajonin e Shkupit kanë ndodhur 24 aksidente trafiku prej të cilëve në dy lëndime të rënda trupore kanë marrë një këmbësor dhe shofer, në tetë lëndime më të lehta trupore kanë marrë 15 persona, ndërsa në 14 janë

shkaktuar vetëm dëme materiale. Në periudhën e përmendur janë zbuluar shumë kundërvajtje dhe janë ndërmarrë masa kundër shtatë shoferëve të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se sa lejohet, tre shoferë kanë kaluar në dritë të kuqe të se-

maforit, gjashtë gjatë drejtimit të automjeteve, nuk e kanë përdorur rripin e sigurimit ose e kanë përdorur telefonin celular, 18 shoferë i kanë drejtuar automjetet pa patentë shoferi gjegjësisht të paregjistruar, ndërsa 39 automjete kanë qenë të parkuar në mënyrë jo të

rregullt. Janë sanksionuar edhe tre këmbësorë dhe katër shoferë të biçikletave me motor, mopedëve dhe motoçikletave të cilët gjatë vozitjes në rrugë nuk e kanë mbajtur helmët mbrojtëse në kokë. Me ndihmën e automjetit special "Karrotrec", janë larguar 36 automjete.

Grujoski dhe Boshkovski tetë ditë në arrati

Shkup, 3 korrik - Goran Grujoski dhe Nikolla Boshkovski, për të tetën ditë me radhë gjenden në arrati. Policia e shtetit ende nuk posedon të dhëna se ku mund të kenë ikur dy të akuzuarit e Prokurorisë Speciale Publike. Duke pasur parasysh se ndaj tyre është lëshuar fletarrest ndërkombëtar, njohësit e këtyre rrethanave shprehën se është e mundur që

këta të akuzuar të jenë larguar nga shteti. Pasi më 17 korrik u bë i ditur vendimi i Gjykatës së Apelit, se dy të akuzuarit për rastin "Target" dhe "Fortesa", Grujoski dhe Boshkovski, përshi edhe të akuzuarin tjetër, Toni Jakimovski, duhet të shkojnë në paraburgim, menjëherë në bazë të praktikës gjyqësore që u krijua me rastin e Sead Koçanit, pala mbrojtëse

parashtrij ankesë deri te Gjykata Supreme. Gjykata e Lartë e shtetit vendimin për paraburgimin e Boshkovski dhe Grujoskit i vërtetoi më 26 korrik, ndërsa për të akuzuarin, Jakimovski, solli vendim për marrjen e pasaportës diplomatike, krahas asaj të rregullt. Sidoqoftë, aksioni policor për arrestimin e këtyre dy të akuzuarve që u zhvilluar

mbrëmjen e 26 korrikut në Shkup, Veles dhe Ohër rezultoi pa sukses, pasi që të njëjtit nuk janë gjetur në adresat zyrtar që i kanë parashtruar. Nga ana tjetër Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, tha se përgjegjësia për mos kapjen e Grujoskit dhe Boshkovskit, bie mbi sistemin gjyqësor dhe në asnjë mënyrë mbi nëpunësit policor të cilët vetëm i re-

alizojnë vendimet të cilët i shqiptojnë organet gjyqësore. Përveç publikimit të lajmit se ndaj të akuzuarve është lëshuar fletarrest ndërkombëtar, MPB-ja në faqen elektronike me fotografike dhe të dhënat persona e ka publikuar identitetin e të njëjtit. Dy prej gjithsej 14 të akuzuarve për rastin "Target" dhe "Fortesa", ngarkohet si përgjegjës

kryesor për përgjimet e jashtëligjshme që janë zhvilluar nga vitit 2008-2015, po siguruar paraprakisht urdhëresa gjyqësore, gjegjësisht Grujoski dhe Boshkovski, akuzohen edhe për shkatërrimin e sistemi për përcjelljen e komunikimeve të cilët ata së bashku me ish shefin e policisë Sasho Mijalkov, e kanë blerë në Londër në vitin 2010. (O.XH)



Të shtënat me armë zjarri assesi të ndalen

Dasmat me krisma i shqetësojnë qytetarët

Policia e Shkupit thotë se festimi me armë zjarri nuk është forma e duhur e shprehjes së gëzimit dhe për këtë arsye apelojnë që qytetarët t'i përmbahen krismave gjatë festave familjare, përndryshe ato thonë se do të shqiptohen sanksione komfor normave ligjore



Koha Omer XHAFERI

Shkup, 3 gusht - Festat e ndryshme dhe gazmendet familjare, përveç muzikës së bujshme, në Shkup dhe rrethinë vazhdojnë të shoqërohen edhe me krismë nga armë zjarri. Ky fenomen negativ ndonëse se shpeshherë lidhet me traditën e kamotshme të nisjes dhe mbarimit të dasmave, për shumë qytetarë të Çairit dhe më gjerë paraqet shkelje të rendit dhe qetësisë publike. Nga ana tjetër, reagimet e banorëve të kësaj pjesë të Shkupit lidhen edhe me çështjen e sigurisë dhe

frikës se vallë - ndonjë nga ato plumba që krisen mund të kenë pasojë fatale në jetë njerëzish. Kësisoj, banorët e rrugës "393" dhe "Saraevska", viteve të fundit - sidomos gjatë periudhës së verës janë të detyruar t'i dëgjojnë krismat sporadike të armëve të zjarrit, të cilët në të shumtën e rasteve vijnë nga dasmorët që ahengjet e tyre i organizojnë në ndonjërin prej mini-restoranteve në këtë pjesë. Qytetarët, të cilët jetojnë përreth këtyre lokaleve, thonë se në vazhdimësi janë ankuar për mënyrën

se si festojnë dasmorët, megjithatë shqetësimin dhe brengat e tyre askush deri më sot nuk i ka marrë parasysh. Policia e Shkupit, duke i komentuar këto zhvillime, thotë se festimi me armë zjarri nuk është forma e duhur e shprehjes së gëzimit dhe për këtë arsye apelojnë që qytetarët t'i përmbahen krismave gjatë festave familjare, përndryshe ato thonë se do të shqiptohen sanksione komfor normave ligjore. "Ne kryesisht veprojmë në bazë të denoncimeve dhe paraqitjeve të rasteve të ndryshme,

qoftë në numrin 192 apo në stacionin policor më të afërt. Gjatë këtij viti në kuadër të ministrisë tonë janë regjistruar tetë raste të plumbave qorr. Prej tyre pesë raste kanë ndodhur në Shkupit, dhe tre raste tjera janë regjistruar në Kumanovë, Ohër dhe Tetovë. Si pasojë e këtyre të shtënave lëndime ka pasur në dy raste, gjegjësisht në Shkup dhe Kumanovë", thonë nga Sektori i Punëve të Brendshme Shkup. Ndërkohë, sipas të dhënave të Ministrisë për Punë të Brendshme, gjatë

NJË I MBYTUR DJE NË DIGËN "LISIÇE", NDËRSA TJETRI NË LIQENIN E PRESPËS

B.I (52), banor i fshatit Drenovë, dje në digën "Lisiçe" derisa ka peshkuar me G.J.J (58) ka parë një prizë për peshkim, ka kërcyer në ujë që ta nxjerr, pas çka është përmbatur dhe nuk është paraqitur në sipërfaqe. MPB kumtoi se në vendin e ngjarjes janë dërguar nëpunës nga SPB Veles, ndërsa janë angazhuar edhe pjesëtarë të Njësitit për detyra të posaçme për gjetjen dhe nxjerrjen e trupit. MPB informon se dje në afërsi të fshatit Dollno Dupeni në Liqenin e Prespës, është gjetur R.A (53) i mbytur nga Prilepi. Nëpunësit policorë nga Stacioni policorë Markova Noga e kanë nxjerrë trupin nga lumi.

viti të kaluar në të gjithë territorin e Maqedonisë janë regjistruar 46 raste të plumbave qorr, me çka në disa prej tyre ka pasur edhe qytetar të lënduar. Pavarësisht lajmeve të përditshme se qytetarët e rëndomtë zakonisht janë ajo kategori e popullatës që pësojnë më tepër nga plumbat qorr, brendësitë e lagjeve shqiptare në Shkup dhe rrethinë vazhdojnë t'i dëgjojnë krismat nga armate zjarrit si në orët e pasdites ashtu edhe në ato të mbrëmjes. Ndryshe, gjatë dhjetë ditëve nëpunësit e MPB-së kanë regjistruar disa raste si pasojë e lëndimeve

nga plumbat qorr, respektivisht ngjarja më tragjike ndodhi në rajonin e Likovës, ku një 19 vjeçar shtetas i Gjermanisë, pas plagëve të marr në afërsi të gjoksi ndërroi jetë rrugës për në spitalin e Kumanovës. Ndërkohë, për tu veçuar është lëndimi i një grua nga rrethina e Tetovës, e cila gjatë punëve të përditshme në arrë në fshatin Saraqinë papritmas ka ndërjerë dhimbje në kraharorin e djathtë. Fatmirësisht plumbi qorr i cili ende është objekt studime se nga ka ardhur nuk ka pasur pasojë fatale në jetën e këtij personi.

Publicitet



Republika e Maqedonisë



Komuna e Radovishit



Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016), nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrjet publike dhe nenit 22 dhe 23 të LMP dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike me numër 0202-360/3 të datës 13.07.2017, ndërsa në cilësi të Drejtorit të NP "Pllavaja" Radovish, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2017

Për themelimin të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar

NP Pllavaja Radovish ka nevojë për plotësimin e vendeve të punës dhe punësim të personave për kohë të pacaktuar të punës nga grupi i ofruesve të shërbimeve publike dhe personave ndihmës teknik edhe atë: 5 (pesë) realizues nga grupi i ofruesve të shërbimeve publike dhe 2 (dy) realizues nga grupi i personave ndihmës-teknik ose gjithsej 7 (shtatë) realizuesve.

I. Nga grupi i ofruesve të shërbimeve publike NP Pllavaja Radovish ka nevojë për punësim të punëtorëve në vendet e punës në vijim, me numrin e realizuesve në vijim:

(1) 2 (dy) realizues për vendin e punës "Ngarkues të mbeturinave", shifra e vendit të punës KDR 0305 V02 033, me neto pagesë bazë prej 12.300,00 denarë, **Kushtet e posaçme** të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët për këtë vend pune:

- së paku nivelin e kualifikimeve I ose arsim fillor, - me ose pa përvojë pune në profesion.

Kushtet e tjera të posaçme

- i aftë fizikisht për realizim të detyrave

Orari i kohës së punës

Orari i punës do të organizohet varësisht nga programi për punë të punëdhënësit, ndërsa në kuadër të 40 orëve në të kohës së punës në javë.

Orë të punës në javë: 40

(2) 1 (një) realizues për vendin e punës "Punëtor në gjelbërim", shifra e vendit të punës KDR 03 05 V02 015, me neto pagesë bazë prej 11.560,00 denarë, **Kushtet e posaçme** të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët për këtë vend pune:

- së paku nivelin e kualifikimeve I ose arsim fillor, - me ose pa përvojë pune në profesion

Kushtet e tjera të posaçme

- i aftë fizikisht për realizim të detyrave dhe aftësi për drejtim të makinës për kositje të barit

Orari i kohës së punës

Orari i kohës së punës

Orari i punës do të organizohet varësisht nga programi për punë të punëdhënësit, ndërsa në kuadër të 40 orëve në të kohës së punës në javë.

Orë të punës në javë: 40

Orë të punës në javë: 40

(3) 1 (një) realizues për vendin e punës "Mirëmbajtës të parqeve dhe gjelbërimit", shifra e vendit të punës KDR 03 05 V01001, me neto pagesë bazë prej 11.560,00 denarë

Kushtet e posaçme të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët për këtë vend pune:

- së paku nivelin e kualifikimeve I ose arsim fillor, - me ose pa përvojë pune në profesion

Kushtet e tjera të posaçme

- i aftë fizikisht për realizim të detyrave dhe aftësi për drejtim të makinës për kositje të barit

Orari i kohës së punës

Orari i punës do të organizohet varësisht nga programi për punë të punëdhënësit, ndërsa në kuadër të 40 orëve në të kohës së punës në javë.

Orë të punës në javë: 40

(4) 1 (një) realizues për vendin e punës "Vozitës të makinës së lehtë transportuese deri më 3.5 tonelatë", shifra e vendit të punës KDR 03 05 B04 060, me neto pagesë bazë prej 13.170,00 denarë

Kushtet e posaçme të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët për këtë vend pune:

- së paku nivelin e kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar, - me ose pa përvojë pune në profesion

Kushtet e tjera të posaçme

-leje të vozitjes të kategorisë B ose C

Orari i kohës së punës

Orari i punës do të organizohet varësisht nga programi për punë të punëdhënësit, ndërsa në kuadër të 40 orëve në të kohës së punës në javë.

Orë të punës në javë: 40

II. Nga grupi i personave ndihmës-teknik NP Pllavaja Radovish ka nevojë të punësojë punëtorë në vendet e punës në vijim, me numër të realizuesve në vijim:

(1) 1 (një) realizues për vendin e punës "Popmuës - rojtar", shifra e vendit të punës KDR 04 01 A02 060, me neto pagesë bazë prej 14.770,00 denarë

Kushtet e posaçme të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët për këtë vend pune:

- së paku nivelin e kualifikimeve III, 180 kredi sipas

ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm trevjeçar

- përvoja e punës nuk kërkohet

Kushtet e tjera të posaçme

-Licencë për sigurim të personave dhe pronës

Orari i kohës së punës

Orari i punës do të organizohet varësisht nga programi për punë të punëdhënësit, ndërsa në kuadër të 40 orëve në të kohës së punës në javë.

Orë të punës në javë: 40

(2) 1 (një) realizues për vendin e punës "Punëtor i përgjithshëm në departamentin për ujësjellës", shifra e vendit të punës KDR 04 01 A03 012, me neto pagesë bazë prej 11.560,00 denarë,

Kushtet e posaçme të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët për këtë vend pune:

- së paku nivelin e kualifikimeve I ose arsim fillor, - me ose pa përvojë pune në profesion

Kushtet e tjera të posaçme

- i aftë fizikisht për realizim të detyrave dhe aftësi për drejtim të makinës për kositje të barit

Orari i punës do të organizohet varësisht nga programi për punë të punëdhënësit, ndërsa në kuadër të 40 orëve në të kohës së punës në javë.

Orë të punës në javë: 40

III. Shpallja publikohet për shkak të kapacitetit të rritur të punës në NP "Pllavaja" Radovish dhe për shkak të vendeve të zbrazëta të punës për shkaqe të ndryshme.

Të gjithë kandidatët (dhe nga grupi i ofruesve të shërbimeve publike dhe nga grupi i personave ndihmës-teknik) duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos jetë i shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

IV. Të gjithë kandidatët (dhe nga grupi i ofruesve të shërbimeve publike dhe nga grupi i personave ndihmës-teknik) duhet të parashtrorin dokumentet në vijim për përmbushje të kushteve të nevojshme për vendin e punës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter:

- Certifikatë të shtetësisë,
- Certifikatë të lindjes,
- Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Certifikatë të mjekut për aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- Diplomë për arsim të mbaruar përkatës,
- Vërtetim për përvojën e punës nëse kërkohet (dokument nga APRM),
- Fletëparaqitje të plotësuar që mund të merret nga arkivi i NP Pllavaja Radovish.

Procedura për përzgjedhje për punësim përbëhet nga kontrollimi i të dhënave të futura në fletëparaqitje për punësim me kushtet e përcaktuara në shpalljen publike, kontrollimi i dëshmitë të parashtruar dhe intervistë. Shpallja zgjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në tabelën për shpallje të ndërmarrjes dhe në shtypin ditor - në tri gazeta ditore prej të cilave një që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Kandidatët fletëparaqitjet me të gjitha dokumentet e nevojshme duhet ti dorëzojnë në adresën në vijim: NP Pllavaja Radovish, rr. "Sveti Spaso Radovishki" nr. 32, Radovish, personalisht në arkiv ose përmes postës. Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të paplotësuar nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Vërejtje: Punësimet të parapara në pajtim me Planin vjetor për punësim në institucion për vitin 2017 janë: 6 maqedonas 1 rom.

NP "Pllavaja" Radovish
Drejtor
Dragi Milenkov



Sipas mërgimtarëve, të cilët aktualisht kanë ardhur në Dibër dhe janë duke shfrytëzuar shërbimet dentale, bëhet fjalë për një gjest që ndërlidhet me interesin ekonomik. Ata thonë se shërbimet këtu janë shumë fish më të ulëta në krahasim me shtetet, siç janë Italia, Zvicra, Gjermania, Austria, por edhe SHBA-ja

Koha | Vjollca SADIKU

Dibër, 3 gusht - Stina e verës është shumë e mirëseardhur për shumë çka. Pos që qyteti i Dibrës merr një gjallëri, por edhe biznesi dibran merr "infuzionin" për të mbi jetuar edhe gjatë tërë vitit. Xhiroja tregtare trefishohet, restorantet dhe hotelet janë përplot, gjithçka lëvizën ashtu siç duhet. Por, është e theksuar edhe shërbimet dentale që janë shumë të kërkuara nga ana e mërgimtarëve, që pos pushimeve realizojnë edhe rregullimin e dhëmbëve të tyre me çmime tejet të levërdishme në krahasim me vendet ku ata jetojnë dhe punojnë.

Një numër i madh i mërgimtarëve që jetojnë dhe punojnë në shtetet e Bashkimit Europian, por edhe nga Amerika kohëve të fundit shfrytëzojnë për mirëmbajtjen e dhëmbëve të tyre dentistët dibran. Edhe këtë verë, ata pothuajse kanë pushtuar disa nga dentistët lokal, ku përveç mirëmbajtjes së dhëmbëve, u ofrohen edhe vendosjen e protezave dhe shërbimeve të

Bizneset dibrane marrin "infuzion"

Mërgimtarët pushtojnë dentistët



tjera dentale.

Sipas mërgimtarëve, të cilët aktualisht kanë ardhur në Dibër dhe janë duke shfrytëzuar shërbimet dentale, bëhet fjalë për një gjest që ndërlidhet me interesin ekonomik. Ata thonë se shërbimet këtu janë shumë fish më të ulëta në krahasim me shtetet, siç janë Italia, Zvicra, Gjermania, Austria, por edhe SHBA-ja. Ka mërgimtarë të cilët enkas gjatë një viti vijnë në Dibër për rregullimin e dhëmbëve të tyre. Këtu, një dhëmb porcelani vendoset për 30-50 euro, kurse në shtetet e

Unionit Europian, në të cilët punojnë dhe jetojnë mërgimtar nga Dibra ky shërbim kushton mbi 600 euro. E njëjta vlen edhe për shërbimet dentale në SHBA, ku vendosja e një dhëmbi nga porcelani i kalon mbi 1 mijë dollarë. Të dhënat jo zyrtare thonë se çdo i treti mërgimtar i moshuar nga Dibra përcaktohet që shërbimet dentale, sidomos kur bëhet fjalë për vendosjen e dhëmbëve nga porcelani dhe silikoni t'i marrin në Dibër.

Pronarët e ordinancave dentale, duke marrë parasysh problemet sociale

që kanë qytetarët e Dibrës, me padurim presin prezencën të mërgimtarëve e sidomos të atyre që vijnë enkas në vendlindje për rregullimin të dhëmbëve. Në disa ordinanca dentare ka rezervime të shumta për dhënien e shërbimeve në fjalë.

Kur jemi tek shërbimet dentale, ka mërgimtarë dibran të cilët shpesh herë për nevojat e tyre dentale shërbimet i kërkojnë edhe në ordinanca të njohura të dentistëve nga Tetova, Gostivari, Kumanova, Struga dhe Shkupi.

Kultura kosovare pasurohet edhe me një mirënjohje



Mentor Zymberaj bartës i çmimit "Teatropis"

Manastir, 3 gusht - Këto ditë ndodhi edhe një befasi e këndshme për punëtorët kulturorë dhe kulturën shqiptare të Kosovës. Asociacioni i kritikës dhe teatrologëve të Maqedonisë, për realizimet si autor tekstesh, regjisor e aktor të shfaqjeve, artistit të njohur Mentor Zymberaj i ndau çmimin "Teatropis".

Pjesëmarrja e shfaqjeve të deritanishme të realizuara nga Mentor Zymberaj në Festivalin e ndryshme ndërkombëtare në Maqedoni ka sjellë. Këtë çmim prestigjioz dhe të rëndësishëm. Pjesëmarrja në Festivalin e Maqedonisë ka qenë qoftë si aktorë, në shumë shfaqje, me shumë çmime, e po ashtu edhe si autor tekstesh dhe regjisor I shfaqjeve. Ky Çmim nuk është i rëndësishëm vetëm për bartësin, por edhe më i rëndësishëm është artin skenik të Kosovës, kulturës dhe artit kombëtarë shqiptarë në përgjithësi. (Q.H)

Lika takoi ambasadorin e Italisë

Shkup, 3 gusht - Zëvendëskryeministri i Republikës së Maqedonisë përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe sistemin politik, Hazbi Lika, të enjten realizoi takim me ambasadorin e Italisë në vendin tonë, Karlo Romeo. Në aspekt të aspiratave të Sekretariatit për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe shtetit tonë, në këtë takim theks të veçantë iu kushtua reformave qeveritare dhe shtyllave që rrjedhin nga Marrëveshja e Ohrit. Zëvendëskryeministri Lika shprehu se vullneti pozitiv që mbizotëron në këtë koalicionim qeveritar dhe marrëveshjet për harmonizim të qëndrimeve të ndërsjellta, duhet të shfrytëzohen me përqendrim të madh për të formuar një shoqëri të shëndoshë multietnike dhe ngritje të standardeve të jetesës në Republikën e Maqedonisë. Paralelisht ata konstatuan se Marrëveshja e Ohrit duhet të ekzistojë deri sa të gjejë implementimin e vet.

Me aeroplan kundër mushkonjave

Shkup, 3 gusht - Në orët e hershme të mëngjesit, të shtunën dhe të dielën (5 dhe 6 gusht) do të kryhet do të kryhet dezinfektim me aeroplan kundër formave më të mëdha të mushkonjave në rajonin e Qytetit të Shkupit. Dezinfektimi në rajonin e Qytetit të Shkupit kundër formave të mëdha të mushkonjave, megjithatë, do të zhvillohet nga e diela deri të enjten (6-10 gusht) në periudhën nga ora 23:00 deri në orën

04:00 të ditës së ardhshme.

Qyteti i Shkupit kumtoi se nëse nuk lejohet kushtet e motit, dezinfektimi me aeroplan do të kryhet ditën e parë të ardhshme kur kushtet e motit do të jenë më të volitshme, në terminin e njëjtë, ndërsa në pajtim me këtë do të kryhet edhe dezinfektim terestik. Prej atje apelojnë edhe deri te letarët që në kohë t'i ndërmarrin masat e nevojshme për mbrojtje të bletëve.



Lehtësi për punëtorët e falimentuar

Kumanovë, 3 gusht - Rreth 560 persona nga Kumanova janë paraqitur në Shoqatën e punonjësve të firmës së falimentuar "Unit" dhe kanë evidentuar listë për stazhin e realizuar në njërin nga ish-kompanitë kumanovare që t'i shfrytëzojnë lehtësitë nga propozim-ligji për punonjës të firmave të falimentuara që para do kohe e miratoi Qeveria.

"Presim që të paraqiten afërsisht 600 punonjës të ish-firmave të falimentuara 'ZIK', 'ÇIK', 'Kiro fetak', 'Bibrok', 'Amballazha'..., duke pa-



• Kumanova

sur parasysh se Kumanova në të kaluarën ishte

një nga qendrat më të mëdha industriale. Nevo-

jitet të sjellin formularë nga SPIM për stazh të re-

alizuar, të cilët pastaj do të dorëzohen deri te Qendra për punësim për evidencë më të lehtë", deklaroi Liljana Georgievska nga "UNIT".

Me Propozim-ligjin është paraparë që rreth 3.000 personave në nivel të shtetit të marrin 7.596 denarë në muaj për çka janë siguruar mjete në Buxhet, ndërsa do të përfshihen persona të papunë me pronësi dominuese të shtetit pas 1 janarit të vitit 1995, përfundimisht me 31 dhjetorin e vitit 2016. Personi i papunë duhet të

ketë 15 vite stazh dhe deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji të ketë 52 vjeç (femrat) ose 55 vjeç (meshkujt), nëse marrëdhënia e punës i është ndërprerë përfundimisht me 31 dhjetor të vitit 2016 dhe në qoftë se ka realizuar të drejtën e kompensimit në të holla pas 1 janarit të vitit 1995 dhe i cili pas realizimit të së drejtës së kompensimit në të holla nuk është pacaktuar në kohë të punësuar, gjegjësisht marrëdhënia e punës i është ndërprerë me vullnet dhe faj të tij.



Në bazë të nenit 79 paragrafi 1 e Ligjit për punë të brendshme ("Gazeta Zyrtare" nr. 42/2014, 116/2014, 33/2015, 5/2016, 120/2016, 127/2016, 142/2016 dhe 190/2016) dhe nenit 97 paragrafi 1 të Ligjit për polici ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 114/2006, 6/2009, 145/2012, 41/2014, 33/2015 dhe 120/2016), ndërsa në lidhje me dispozitat e Rregullores për mënyrën e realizimit të selektimit dhe zgjedhjes së kandidatit për polic dhe mënyrën e punës të komisionit për zgjedhje të kandidatit për polic ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 8/2015 dhe 130/2016)

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME PUBLIKON SHPLLJE PUBLIKE

Për pranimin e 500 realizuesve në vendin e punës "Polic" për punë në Ministrinë e punëve të brendshme, edhe atë:

1. Në Sektorin e punëve të brendshme Shkup	360 realizues
2. Në Sektorin e punëve të brendshme Manastir	20 realizues
3. Në Sektorin e punëve të brendshme Ohër.....	30 realizues
4. Në Sektorin e punëve të brendshme Strumicë.....	20 realizues
5. Në Sektorin e punëve të brendshme Shtip.....	20 realizues
6. Në Sektorin e punëve të brendshme Kumanovë.....	20 realizues
7. Në Sektorin e punëve të brendshme Tetovë.....	10 realizues
8. Në Sektorin e punëve të brendshme Veles	20 realizues

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - të jenë të moshës madhore, dhe të mos ti kenë mbushur 25 vjet, nëse për herë të parë ka lidhur marrëdhënie pune në Ministrinë e punëve të brendshme për të cilën është paraparë arsim i mesëm;
 - të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
 - me kontrollim të sigurisë të vërtetohet se nuk ekziston rrezik sigurie nga të punësuarit e kandidatit;
 - të kenë të mbaruar së paku arsim të mesëm katërvjeçar
 - të ketë aftësi shëndetësore dhe psikofizike dhe
 - me aktgjykim të plotfuqishëm të mos kenë ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- 2. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e posaçme në vijim:**
- të jenë shtatartë së paku 175 cm (meshkujt), përkatesisht 165 (femrat) dhe
 - përgatitje të lartë fizike personale.
- 3. Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë këto dokumente për plotësimin e kushteve të nevojshme për vendin e punës, në original ose koje e vërtetuar te noteri:**
- certifikatë të lindjes,
 - diplomë për arsim të mesëm katërvjeçar të mbaruar;
 - dëshmi se me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënimi për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe
 - dy fotografi, me dimensione 3,5 cm x 4,5 cm.
- Fletëparaqitjen me dokumentet e nevojshme, kandidatit është i obliguar ti parashtrojë PERSONALISHT në njërin nga vendet e parapara për parashtrim, edhe atë:
- Sektori për Punë të Brendshme Shkup;
 - Stacioni policor për kompetenca të përgjithshme- Gazi-Babë,
 - Stacioni policor për kompetenca të përgjithshme- Bit-Pazar
 - Stacioni policor për kompetenca të përgjithshme –Karposh.
 - Sektori për Punë të Brendshme Manastir;
 - Sektori për Punë të Brendshme Veles;
 - Sektori për Punë të Brendshme Kumanovë;
 - Sektori për Punë të Brendshme Tetovë;
 - Sektori për Punë të Brendshme Ohër;
 - Sektori për Punë të Brendshme Strumicë;
 - Sektori për Punë të Brendshme Shtip;
- Gjatë parashtrimit të fletëparaqitjes personi shënon numrin e vendit të punës për të cilin paraqitet në pajtim me pjesën I të shpalljes.

Kandidati është i obliguar gjatë parashtrimit të dokumenteve të nevojshme, me vete të ketë letërnjoftim ose pasaportë për identifikim.

Dokumentacionin e nevojshëm nga pika 3, kandidatët e dorëzojnë çdo ditë pune në kohën e caktuar, në orarin e punës (08,30-16,30).

4. Gjatë parashtrimit të kërkesës kandidatit nënshkruan deklaratë për kandidaturë vullnetare për selektim për zgjedhje për kandidat për polic për të mos mundur të kërkojë dëmshpërblim nga Ministria për Punë të Brendshme në rast të lëndimit gjatë kohës së zbatimit të procedurës për selektim.

5. Procedurën për selektim të kandidatëve e zbaton Komisioni për Zgjedhje të Kandidatit për Polic i formuar nga ministri dhe e njëjta zbatohet në disa faza:

- Kontrollim administrativ(vërtetim se a është i dorëzuar dokumentacioni me kohë dhe i njëjti a është komplet, si dhe a është në rregull me kushtet e parapara);

- Kontrollim të aftësive fizike (për meshkuj 9 pompa për 10 sekonda, së paku 16 ushtrime barku për 30 sekonda, kërcim në largësi prej në vend me gjatësi minimale prej 220 cm, sprint në 20 metra për së paku 3,35 sekonda, sprint në 100 metra për së paku 15 sekonda dhe vrapim në 1500 metra për së paku 5,25 minuta dhe për femra: së paku 6 pompa për 10 sekonda, së paku 12 ushtrime barku për 30 sekonda, kërcim në largësi prej në vend me gjatësi minimale prej 160 cm, sprint në 20 metra për së paku 3,50 sekonda, sprint në 100 metra për së paku 18 sekonda dhe vrapim në 800 metra për së paku 3 minuta dhe kontrollime tjera fizike të përcaktuara nga ana e Komisionit),

- Test psikologjik (kontrollim të aftësive intelektuale dhe emocionale)

- Testim me shkrim(test i përgjithshëm arsimor),

- Intervistë (bisedë individuale me gojë me kandidatin e paraqitur),

- Kontrollim të sigurisë dhe

- Kontrollime mjekësore (kontrollime të aftësive shëndetësore dhe psikofizike të kandidatëve).

6. Ministria e punëve të brendshme do të realizojë kontrollim sigurie të kandidatëve të paraqitur, në bazë të pëlqimit të dhënë më herët me shkrim nga ana e kandidatit. Nëse i njëjti refuzon kontrollimin e sigurisë do të llogaritet se nuk i plotëson kushtet për themelimin të marrëdhënies së punës në Ministri.

7. Kontrollimet mjekësore në procedurën për selektim për kontrollim të aftësive shëndetësore dhe psikofizike të kandidatëve përcaktohen nga ana e Komisionit shëndetësor i formuar nga ministri i punëve të brendshme.

8. Gjatë realizimit të selektimit personave të paraqitur u mundësohet nën kushte të njëjta të demonstronjë aftësitë e tyre, pavarësisht gjinisë, rasës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale ose sociale, besimeve fetare, pozitës pronësore ose shoqërore.

9. Pas zbatimit të procedurës për selektim, kandidatët e zgjedhur për policë lidhin kontratë për trajnim themelorë për policë dhe në të njëjtin dërgohen për 10 % më shumë kandidatët për policë nga numri i vendeve të lira për të cilin është shpallur ky lajmërim.

10. Pas mbarimit të trajnimit themelorë, Ministria për Punë të Brendshme me kandidatin për polic i cili e ka mbaruar trajnimin themelorë për policë dhe i cili në bazë të rezultateve të arritura është i vendosur në listën për rangim lidh Kontratë për punësim në Ministri, me çka kandidati për polic merr statusin "polic – praktikant".

Ministria e punëve të brendshme **PARALJMERON** se, në pajtim me ligjin, polici me marrëveshje për punësim është i obliguar që të qëndrojë në punë së paku pesë vjet në vendin e punës "polic" duke konsideruar nga dita e lidhjes së kontratës për punësim. Në të kundërtën, i njëjti është i obliguar që të kompensojë shpenzimet e bëra për trajnimin e tij në shumë tre herë më të lartë.

11. Afati për dorëzimin e kërkesave është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e shpalljes së lajmërimit (duke mos llogaritur vetë ditën e shpalljes).

12. Mosdorëzimi në kohë i dokumenteve dhe dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

FTESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT (nr. 003-17/4.1.4)

Republika e Maqedonisë ka marrë hua nga Banka botërore për nevojat e realizimit të Projektit për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve që implementohet në kuadër të Ministrisë së arsimit dhe shkencës. Një pjesë të këtyre mjeteve do të shfrytëzohen për pagesë të obligimeve që do të dalin nga marrëveshja që do të lidhet për angazhim të përkohshëm të **Koordinatorit për arsim sipëror**.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për mbështetje të koordinatorit për arsim sipëror gjatë koordinimit të aktiviteteve për implementim të komponentit të parë të Projektit (Përmirësim të transparencës në arsimin sipëror) posaçërisht në pjesën e reformimit të mënyrës së financimit të arsimit sipëror. Periudha e paraparë e angazhimit është shtator 2017- maj 2019.

Përshkrimi i detyrave të punës në gjuhën angleze është i mundshëm në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (<http://mon.gov.mk/index.php/dokumenti/2014-07-30-12-00-34/sdis-proekt>).

Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë universitare në shkencat shoqërore. Diplomë për studime të mbaruara të doktoraturës do të konsiderohet si përparësi.

- Së paku 5 vjet përvojë të mëhershme profesionale në institucion të akredituar për arsim sipëror.

- Përvojë në punë me projekte ndërkombëtare

- Njohuri të shkëlqyeshme të mjedisit rregullator për arsim sipëror dhe sektorit të arsimit sipëror në Republikën e Maqedonisë dhe rajon;

- Aftësi të theksuara për punë ekipore, lidhshmëri, komunikime, marrëdhënie ndërnjerëzore dhe ndërkulturore dhe aftësi kompjuterike. Përvojë në mediacion (arbitrazh) do të llogaritet si përparësi.

- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës së shkruar dhe të folur maqedonase dhe angleze.

Konsulentët e interesuar orientohen në pikën 1.9 të procedurave për furnizime të Bankës botërore {Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers, January 2011 ("Consultant Guidelines")}, ku janë theksuar politikat e Bankës botërore në lidhje me konfliktin e interesave.

Konsulenti do të zgjidhet në bazë të procedurës për zgjedhje të konsulentit individual në pajtim me procedurat për furnizime të Bankës botërore ("Consultant Guidelines").

Informata shtesë mund të merren në adresën e shënuar më poshtë gjatë orarit të punës prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Deklaratat për interes (CV në gjuhën maqedonase ose angleze dhe letër për shprehje të interesit) duhet të dorëzohen në adresën e shënuar më poshtë (përmes postës ose në e-mail) më së voni deri më **15.08.2017**.

Adresa:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Projekti për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve

(Për: Daniealla Maneva/në lidhje me shpalljen nr. 003-17)

rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

e-mail: danijela.maneva@mon.gov.mk (CC: igor.krstevski@mon.gov.mk)



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

FTESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT (nr. 004-17/4.1.4-1)

Republika e Maqedonisë ka marrë hua nga Banka botërore për nevojat e realizimit të Projektit për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve që implementohet në kuadër të Ministrisë së arsimit dhe shkencës. Një pjesë të këtyre mjeteve do të shfrytëzohen për pagesë të obligimeve që do të dalin nga marrëveshja që do të lidhet për angazhim të përkohshëm të **Ndihmës koordinatorit për arsim sipëror**.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për mbështetje të koordinatorit për arsim sipëror gjatë koordinimit të aktiviteteve për implementim të komponentit të parë të Projektit (Përmirësim të transparencës në arsimin sipëror) posaçërisht në pjesën e reformimit të mënyrës së financimit të arsimit sipëror. Periudha e paraparë e angazhimit është shtator 2017- maj 2019.

Përshkrimi i detyrave të punës në gjuhën angleze është i mundshëm në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (<http://mon.gov.mk/index.php/dokumenti/2014-07-30-12-00-34/sdis-proekt>).

Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë universitare në shkencat shoqërore.

- Së paku 5 vjet përvojë të mëhershme profesionale në implementimin e legjisllacionit nacional

- Përvojë në përpilimin e legjisllacionit nacional dhe politikave qeveritare. Përvojë në përgatitjen e3 dokumenteve për furnizime publike do të konsiderohet si përparësi.

- Aftësi të theksuara për punë ekipore, lidhshmëri, komunikime, marrëdhënie ndërnjerëzore dhe ndërkulturore dhe aftësi kompjuterike.

- Njohje të shkëlqyeshme të gjuhës së shkruar dhe të folur maqedonase dhe angleze.

Konsulentët e interesuar orientohen në pikën 1.9 të procedurave për furnizime të Bankës botërore {Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers, January 2011 ("Consultant Guidelines")}, ku janë theksuar politikat e Bankës botërore në lidhje me konfliktin e interesave.

Konsulenti do të zgjidhet në bazë të procedurës për zgjedhje të konsulentit individual në pajtim me procedurat për furnizime të Bankës botërore ("Consultant Guidelines").

Informata shtesë mund të merren në adresën e shënuar më poshtë gjatë orarit të punës prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Deklaratat për interes (CV në gjuhën maqedonase ose angleze dhe letër për shprehje të interesit) duhet të dorëzohen në adresën e shënuar më poshtë (përmes postës ose në e-mail) më së voni deri më **15.08.2017**.

Adresa:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Projekti për zhvillim të aftësive dhe mbështetje të inovacioneve

(Për: Daniealla Maneva/në lidhje me shpalljen nr. 004-17)

rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

e-mail: danijela.maneva@mon.gov.mk (CC: igor.krstevski@mon.gov.mk)



Ka qenë pikërisht Gurakuqi që pati meritën dhe fatin që udhëhoqi drejtpërdrejtë luftën për krijimin e shkollës kombëtare shqiptare dhe të sistemit tonë arsimor. Nën drejtimin e tij u hodhën themelet e para të sistemit arsimor fillor shtetëror në Shqipëri

Anisa DEMIRAJ

Luigj Gurakuqi është një nga njerëzit më të vlerësuar për kontributin që ai ka dhënë në krijimin e shtetit shqiptar dhe jo vetëm. Gurakuqi ka qenë një njeri i nderuar, i cili si shumë figura të tjera të nderuara ka përfunduar i vrarë në pabesi rrugëve të Barit. Ai ka qenë një nga njerëzit më të nderuar nga historia dhe nga gjithë njerëzit pasi ka qenë në kuptimin e plotë të fjalës, mësonjësi i gjuhës shqipe. Ka qenë pikërisht Gurakuqi që pati meritën dhe fatin që udhëhoqi drejtpërdrejtë luftën për krijimin e shkollës kombëtare shqiptare dhe të sistemit tonë arsimor. Nën drejtimin e tij u hodhën themelet e para të sistemit arsimor fillor shtetëror në Shqipëri. U krijua përvoja e parë e ngritjes së administratës arsimore shqiptare, u hartuan dokumentet e para shkollorë, u ngrit një sistem i tërë i përgatitjes dhe i kualifikimit të mësuesve. Dora e tij shkroi alfabetet e miratuar nga Kongresi i Manastirit dhe i zbuloi para delegatëve.

Në tetor të 1909 u emërua drejtor i së parës shkollë normale që u hap në Elbasan, ku dha një ndihmesë me vlerë për vënien e arsimit mbi baza kombëtare. Gurakuqi ka meritën se përcaktoi drejt e qartë, më shumë se çdo paraardhës, konceptin mbi shkollën kombëtare shqiptare, përbajtjen, karakterin dhe parimet e ndërtimit të saj. Ai kërkonte që gjithë fryma dhe përmbajtja e shkollës të ishte në funksion të qëllimeve dhe idealeve kombëtare. Gurakuqi është tekstologu më i shquar shqiptar i fillimit të shekullit tonë. Ai i dha shkollës shqipe, si autor e bashkautor, 8 tekste mësimore me një vëllim prej 738 faqesh.

Detyrohet me ikë prej Elbasanit, të dalë jashtë shtetit bashkë me Aqif pashë Elbasanin. Në prill 1911 merr pjesë në kryengritjen e malësorëve të Mbishkodrës e si një nga udhëheqësit e saj, harton së bashku me Atë Mati Prennushin Memorandumin e Greçës, apo Librin e Kuq siç njihet ndryshe të malësorëve kryengritës, zjarri i armëve të të cilëve do të paralizojmë rronte pavarësinë. Më 1912 zhvillon një veprimtari të dendur për organizimin e kryengritjes së përgjithshme, duke qenë i pranishëm në Toskëri dhe më vonë edhe pranë krerëve të Kosovës. Mori

Personalitete të shquar shqiptare

Luigj Gurakuqin e vrau revolveri i kushëririt të tij



pjesë në mbledhjen e Bukureshtit, dhe do merrte pjesë në shtegtimin nga Bukureshti në Vjenë. Me vaporin e dhënë nga austro-hungarezët duke shoqëruar Ismail Qemalin zbrit në Durrës më 24 nëntor në orën 4 mbrastite, u nisën të nesërmen me 25. Një natë fjetën në Çermë tek Dervish bej Biçakçiu, dhe një natë në Fier tek Omer Pashë Vriçoni. Në Vlorë mbërritën më 27 dhjetor në darkë. Në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës (dhjetor 1912) u zgjodh Ministër i Arsimit dhe vendosi arsimimin e detyruar fillor për djem e vajza. Merr pjesë në Konferencën e Londrës më 1913, me Ismail Qemalin e Isa Boletinin. Nga gjendja e tensionuar në Shqipërinë e mesme, pasi qëndresa nuk u shfaq e frytshme tërhiqet në Shkodër me Aqif pashën ku vihet në krye të një Komisioni Sundimtar të Përkohshëm. Me Luftën i Botërore Shkodra pushtohet nga ushtria malazeze, Luigj Gurakuqi internohet në Podgoricë nga 17 korriku 1915 deri në janar 1916.

Gjatë pushtimit austro-hungarez, prania e Korparmatës XIX të komanduar nga gjenerali Trollmann e vë drejtor të përgjithshëm të Arsimit, nga ku edhe hapi shumë shkolla shqipe. Qe një nga themeluesit e Komisionit të Filologjisë romane në universitetin e Ljubjanës, më parë prof. në Univ. e Gratz-it në Austri që bëri pjesë në punimet e kësaj Komisie, Radomir Nachtingall, e çmon Gurakuqin. Ka merita të shquara në zhvillimin e

gjuhës letrare shqipe, në përpunimin e gjuhës letrare dhe në njësimin e shqipes së shkruar, në stabilizimin e drejtshkrim-it, në pasurimin e fjalorit, në çështjet e leksikologjisë, terminologjisë e të gramatologjisë. Gurakuqi është tekstologu më i shquar shqiptar i fillimit të shekullit tonë. Arsimi vazhdoi të mbetet, siç e thotë vetë ai, dega më e dashur e zemrës së tij. Ai parashtrroi në parlamentin shqiptar ide dhe mendime shumë interesante për politikën arsimore dhe rrugën që duhet të ndiqte shkolla shqiptare. Gurakuqi kishte një vizion të qartë për rolin e shkollës në një shoqëri moderne, për lirinë dhe të drejtat themelore t'individit në fushën e arsimit dhe kërkoi zhvillimin mbi baza ligjore, shkencore e pedagogjike të shkollës shqiptare. Në qeverinë e dalë nga Kongresi i Durrësit ku ishte përfaqësues i Shkodrës dhe Mirditës, u emërua zëvendës i dr. Mihal Turtullit në ministrinë e Arsimit të kabinetit të Turhan Pashë Përmetit. Që në mbledhjen e parë të Kongresit të Durrësit, më 1918, L.Gurakuqi "është kundër që në një mbledhje kombëtare të përmenden fjalët toskë e gegë dhe të krishtenë e mysliman", kërkoi që fjalë të tilla të jenë të ndaluara dhe shton se "...çështja e lirisë dhe e nderimit të feve në Shqipni duhet të zgjidhet mbas formulës: "Feja e lirë në shtet të lirë". I ngarkuar nga kjo qeveri si anëtar i delegacionit të saj në Konferencën e Paqes në Paris ku qëndroi 15 muaj. Çdo shkresë e përdorur nga duart e tij e të

Mustafa Merlikës. Iu dha edhe posti i ministrit të brendshëm, në kabinetin disa ditë të H. Prishtinës. Këto ide e mendime L.Gurakuqi i shtjelloi hollësisht në diskutime në parlamentin shqiptar dhe, posaçërisht n'artikullin "Bazat e bashkëpunimit ndërmjet shqiptarëve muhamedanë e të krishtenë". Ai ishte kategorikisht kundër atyre që mendonin se për të larguar konfliktet fetare që mund të lindnin, duhet, me të butë e me të fortë, të shuhen besimet fetare në Shqipëri.

Më 1921-1924 qe deputet i Shkodrës në Këshillin Kombëtar ku si një nga udhëheqësit e opozitës demokratike luftoi për demokratizimin e jetës së vendit, për lehtësimin e gjendjes së bujkut nga shtypja e rëndë, për zhvillimin ekonomik e kulturor dhe për mbrojtjen e pavarësisë nga synimet skllavëruese të fuqive imperialiste. I qëndroi besnik deri në fund të jetës idealit për të parë një ditë të bashkuar rreth tokës amtare gjithë vëllezërit e kombit. Ai ankohej se: "Na kanë marrë qytetet e na kanë lanë malësinë, na kanë marrë viset ma të çmueshme t'atdheut duke na lanë si një trup pa kokë".

Tingëllojnë të freskta demaskimet që i bënte Gurakuqi politikës së pastrimit etnik që ndiqnin shovinistët serbë: "Qeveria jugosllave nuk do të ndalet para asnjë mjeti", deklaronte ai, "për t'i ndërrue fytyrën Kosovës". Për gjendjen tepër të vështirë të shqiptarëve në shtetin jugosllav fajëson Fuqitë e Mëdha, të cilat bënë theror shqiptarët e trojet e tyre për interesat e veta e të aleatëve të tyre. L. Gurakuqi është partizan për të ndihmuar e për t'u dalë zot të drejtave të popullsisë së Kosovës. E quante si detyrë të rëndësishme të shtetit shqiptar. Faji i vetëm i kosovarëve qëndronte vetëm në atë se ata ishin shqiptar e donin të mbeteshin shqiptar. Ndër fjalimet më të fuqishme të Gurakuqit në parlament janë ato mbi mbrojtjen e popullsisë shqiptare të Kosovës. Kur qeveria jugosllave në një telegram e quante ndërhyrje në punët e brendshme të saj interesimin e shqetësimin e qeverisë shqiptare për gjendjen tepër të vështirë të shqiptarëve të Kosovës, Gurakuqi, plot indinjatë e zemërim do të thoshte: "Si mundte me thanë një qeveri (Jugosllave) e cila ka

mbjellë viset tona me varre të vllazënve tonë, se po i përzihemi në punët e mbrendshme të saj. Si mundte një qeveri me thanë se po i përzihemi në punët e mbrendshme, kur shohim se për shkak të saj me mijëra fëmijë e gra sillen të zhveshur e të zbatshur këtu nepër Tiranë e ushqehen me sevapet e amerikanëve e tepricat e ushtrisë. Qeveria Jugosllave nuk ka të drejtë për të na akuzue për një gjë të tillë kur parlamenti shqiptar kërkonte vetëm në emër të njerëzisë e humanizmit të ndërpriten mizoritë serbe ndaj shqiptarëve."

Më 5 mars 1924 u sëmur rëndë nga një grip i fortë që e mbërtheu afro një muaj në shtrat. Shtypi i dha vëmendje të veçantë, aq sa Avni Rustemi i thoshte Dom Shantojës "Opozita po pushon: Kemi Gurakuqin e sëmurë".

Në Qeverinë e kryesuar nga Fan S. Noli u emërua ministër i Financave. U dallua për ndjenjën e lartë të përgjegjësisë dhe për vendosmërinë e përpjekjet për krijimin dhe forcimin e shtetit demokratik shqiptar. Mori pjesë në Konferencën e Gjenevës krahas Nolit më 1924. Kur në Parlament Ali Këlcyra i bën vërejtje për qëndrimet e tij liberale, Luigji përgjigjet, "Z. Ali Këlcyra më tha si për qortim se jam liberal. I falemnderit dhe mund të jetë i sigurtë zotnia e tij se vdekja do të më ndajë nga mendimet e mija liberale". Duke u deklaruar demokrat e liberal, Gurakuqi thoshte se nuk është as revolucionar as bolshevik e as socialist, koncepte këto që në vitet '20 ishin të barazvlefshëm dhe kishin kuptimin e ndryshimeve me dhunë, me forcën e armëve, me kryengritje. Mark Gurakuqi do shkruajnë ishte trim por s'e pëlqente gjakderdhjen. Gurakuqi ishte për zgjidhjen paqësore të problemeve nepërmas ligjeve, zgjidhjeve "me drejtësi e në mënyrë të butë". Si i tillë, ishte kundër futjes së popullit në udhën e kryengritjes së armatosur. Duke pasur këto koncepte mbi rolin e ligjit, dhe zgjidhjen paqësore dhe jo kryengritjen e zgjidhjen me dhunë të problemeve, Gurakuqi u përfshi në Lëvizjen e 1924, pas një hezitimi e kundërshtimi të fortë. Miku i tij, Mustafa Merlika-Kruja shkruan në letërkëmbimin me Atë Paulin Margjokajn: "Në lëvizjen e qershorit 1924 ka qenë kundërshtar deri që nuk qe vendosun, ka luftue si Luã për t'a

ndalue, tue profetue pikë për pikë të gjitha pasojat që u vërtetuen ma vonë njana mbas tjetrës. Por, mjerisht, mandej kur s'i eci fjala, vot mbas rrymës e u bë edhe ministër me Fan Nolin".

"Gurakuqi u tërhoq (në revolucion) pas një kundërshtimi të fortë. Mund ta dëshmojnë sa u ndodhën në Vlorë". - shkruante Stavro Vinjau. Për veprimtarinë e tij si ministër vazhdojmë të lexojmë Vinjau: "... si ministër i Financave i Kabinetit Noli bëri çudira. Gjeti 4 milion franga ari të paguara; me administrimin e tij të shkëlqyer, me ngursimet e tij (ngursente parat e Shtetit më tepër se paratë e tij) arriti që jo vetëm buxhetin e ri t'a mbyllnjë me një tepricë prej 1.000.000 franga ari, po edhe të gjithë borxhet e Shtetit të kohës së kaluar të paguhen; nëpunësit të cilët prej 2-3 vjetëve qenë mësuar të paguheshin me një vonesë prej 3-4 muajsh, arritën ditë e fundit të administrimit të tij të paguhen rregullisht. Dhe barasimin e buxhetit e bëri pa mbyllur asnjë pagesë të dobishme në arësim e P. Botore, pa pakësuar ushtrinë dhe duke i dhënë xhandarmëris sa kërkoi Komanda e Përgjithëshme."

Pas shtypjes së Lëvizjes së qershorit shkoi në Itali, ku më 2 mars 1925 u vra në Bari prej Baltjon Stamollës në derë të Hotel Cavour, kushëri i vetë Luigjit. Ishte mbremja e 2 marsit, në restorantin e hotelit, Luigj Gurakuqi po darkonte me dy miq të tij dhe gruan e njërit prej tyre: Riza Dani me bashkëshorten Makbule dhe vëllai i tij Dan Hasani. Kërkoj leje prej tyre duke i paraqitur arsyen: do t'shkoj tek Sotiri, mbasi i kam premtue një kukull vajzes së tij. Në xhepat e shkyer të ish-Ministrit të financave policia italiane gjeti vetëm 350 lira. Nisi të hante një herë në ditë me të dalë refugjat.

N'organizimin e këtij atentanti kishin dorë si Ahmet Zogu, Ceno Kryeziu, ashtu dhe Çatin Saraçi, dëftuar kjo nga letra nisur nga vrasësi që kërkon ndihmë: "Kërkoj mbrojtje dërgoni të holla ndërmjetsoni për pshtim pranë Qeverisë Italjane. Pyetni Çatin Saraçin ku asht...? "besa" ndihma!..."

Miku i tij, Hasan Prishtina, mbi varrin e tij do të shprehej: "Flej i qetë Gurakuqi, shpagan tände do ta marrim me përparimin e Shqipniës."

Autoritetet italiane nuk lejuan që funerali të mbahej në qytet, por vetëm brenda mureve të varrezave. N'ato çaste tragjike miku i afërt i Gurakuqit, Lin Kamsi ruajti veshjen me të cilën ishte vra "trimi i bardhë si dborë" për t'ia lanë si kujtim brezave të ardhshëm. Në Bari rendën refugjatë shqiptarë prej gjithkrah. U mbajtën fjalime prej bashkëshortes së Sotir Gjijkës, zonjës Lilli Quarta, prej Hasan Prishtinës, L Lazar Fundos, Beqir Valterit etj.

Krimi lëviz gjithmonë me makina luksi



Lorenc VANGJELI

Histori të tilla të ngjashme në Gjermani nuk kursejnë askënd. Madje sa më i njohur në publik dhe sa më lart në hierarkinë shoqërore, aq më i fortë ngjan edhe ndëshkimi në rast se kapesh

Pak vite më parë, ekonomisti i njohur Mario Monti, për një përputhje të habitshme koincidence, rastësisht, por dhe ligjësish, e pa veten kryeministër në një qeveri teknokratësh italianë, në një vend që kishte njohur breza të tërë burokratësh politikë. Monti ishte atipik. Dhe si kryeministër, ndër shumë gjëra të tjera, do të kujtohet për mënyrën sesi ai tentoi të luftojë evazionin e frikshëm fiskal në Itali. Çfarë dukej e pamundur të zbulohet dhe aq më pak të ndëshkohej, në fare pak kohë u bë e pamundur të mbulohej dhe të shmangej ndëshkimi. Sepse është aksiomë: krimi lëviz gjithmonë me makina luksi. Dhe duke ndjekur makinat, u arrit tek banditët e të gjitha llojeve. Mediat italiane të kohës u vunë në garë të botonin lajmet më të çuditshme të evazionit. Dikush që bënte pushime luksoze dhe paguhej me ndihmë sociale, një tjetër kishte Ferrari dhe përfitonte bursë shtetërore për të birin, një tjetër kishte një park të tërë makinash, vazhdonte të blinte makina antike dhe gjithashtu konsiderohej i varfër, e kështu me rradhë. Tatimorët e Montit bënë diçka fare të thjeshtë: trazuan urjat. Kontrolluan makinat për të zbuluar të ardhurat, zbarkuan në vendet VIP të pushimit dhe identifikuan turistët e "varfër". Për t'i detyruar të paguajnë atë çfarë është e Çezarit që nga koha e Çezarit.

Histori të tilla të ngjashme në Gjermani nuk kursejnë askënd. Madje sa më i njohur në publik dhe sa më lart në hierarkinë shoqërore, aq më i fortë ngjan edhe ndëshkimi në rast se kapesh. Edhe në një vend si Spanja, sa për të marrë një shembull tjetër, futbollistët më të njohur në botë, Messi dhe Ronaldo, po kalojnë ditë e netë ankthi për shkak të problemeve me taksat. Dhe, pavarësisht përbetimeve për pafajësi, prokurorë e gjykatës, vendosin edhe burg për këto dy makineri industriale e njerëzore të prodhimit të parave dhe të emocioneve.

Shqipëria është ndryshe. Në Shqipëri nuk bëhet ende fjalë për të kontrolluar artistë, këngëtarë apo futbollistë. Këta, si rregull, janë të pasur vetëm në fotot e instagramit. As për njerëz me poste politike, që pjesmarrjen në politikë e kanë një biznes që nuk paguan fare taksat. Edhe pse në Shqipëri politika vazhdon të jetë biznesi më i madh. Kryeministri në fund të mandatit Edi Rama dhe kryeministri i ri në pritje të mandatit të dytë të tij Edi Rama, paralajmëroi ditë të vështira për një kategori gjithashtu të "rëndësishme" banditësh. Duke ndjekur aksiomën e vjetër se krimi lëviz me makina luksi. Duke paralajmëruar se "...mjafton që ky operacion të vihet në zbatim duke kontrolluar automjetet e këtyre personazheve. Mjafton që këta elementë shumë shqetësues për komunitetet, shumë shqetësues për rendin dhe për sigurinë, shumë shqetësues për faktin se mishërojnë pandëshkueshmërinë e më shumë se një çerekshekulli, të vihen para përgjegjësisë për të justifikuar vlerat marramendëse të automjeteve dhe aseteve të tyre...".

Kaq e thjeshtë është që të nisë nga banditët. Nga njerëz të cilët lëvizin me makina dhjetra mijëra euro dhe nuk kanë librezë pune, që kanë standart orientat luksi dhe nuk dinë të shkruajnë as emrin e tyre. Zakonisht këta janë trafikantët e drogës që gjenden gjithkund. Apo dhe më keq akoma, gjobvënës të bizneseve apo tek njerëz të thjeshtë. Kjo është hierarkia e krimiit ordiner. Goditja e premtuar e tyre është vetëm një hap i parë dhe një rifillim i mbarë. Vullneti politik kundër krimiit ka bën të pamundur jetën krimiit ordiner, por do të ishte vërtet mëkat e krim nëse nuk do të kishte vullnet për të goditur krimin shumë më lart në hierarki. Në politikë e biznes. Aty ku banditët nuk mund të identifikohen thjesht nga makinat e tyre të luksit, në fakt. (javanevs)



Denis McSHANE

Partitë socialiste dhe socialdemokrate europiane janë të gjitha duke përjetuar një periudhë të zymtë dhe të vështirë. Me një përjashtim - Ballkanin Perëndimor. Pa shumë zhurmë, Shqipëria dhe Maqedonia kanë zgjedhur këtë verë qeveri socialdemokrate. I zgjedhur në vitin 2013 me një maxhorancë të brishtë, Edi Rama, kryeministri socialist i Shqipërisë, u rizgjodh me një maxhorancë të gjerë në qershor dhe do të vazhdojë të udhëheqë vendin e tij edhe për katër vjet.

I veshur me pantallona të shkurtra, atlete dhe një t-shirt të zi, kryeministri shqiptar, në rezidencën e tij verore në Durrës, në breg të detit, tregohet besimplotë dhe përgatitë të rindërtojë Shqipërinë. Ish - student i Shkollës së Arteve të Bukura në Paris në vitet 1990, është një fans i presidentit Macron dhe dëshiron të vendosë lidhje të reja midis Shqipërisë dhe Francës. Ai ka qenë një kryetar bashkie shumë popullor i Tiranës për mbi 8 vite. "Shqipëria ka qenë gjithmonë një komb, por ne duam të bëhemi një shtet që funksionon me korrektësi", thotë ai.

Ai nuk subvencionon më kompaninë kombëtare të shpërndarjes së energjisë dhe detyron përdoruesit të paguajnë faturat e tyre, në

Rama-Zaev, përjashtimi nga rregulli në Europë...

Ish - student i Shkollës së Arteve të Bukura në Paris në vitet 1990, është një fans i presidentit Macron dhe dëshiron të vendosë lidhje të reja midis Shqipërisë dhe Francës. Ai ka qenë një kryetar bashkie shumë popullor i Tiranës për mbi 8 vite

dallim nga qeveria e mëparshme e djathtë që kërkonte vota duke premtuar furnizimin falas me energji elektrike.

Përpjekje reale për të reformuar ekonominë

Z.Rama ka trashëguar një shërbim policor dhe rendi lehtësisht të korruptueshëm. Aktualisht, oficerët e vjetër të policisë kanë dalë në pension dhe shkolla e re e policisë formon gjithnjë e më shumë oficerë femra. Numri i vrasjeve është zvogëluar në mënyrë spektakolare dhe shtetet balltike rregjistrojnë dy herë më shumë vrasje se Shqipëria/për banor. Universitetet private që jepnin diploma universitare vetëm me pagesë janë mbyllur. Mësuesit u ftuan të reformojnë programin dhe el-



eminuan 600 tekste shkollore që nxënësit i mësonin më parë. Gjysma e Qeverisë Rama përbëhet nga femra. Aktualisht është e ndaluar që të pish duhan në vende publike. Në një deklaratë, që do të surprizonte Jeremy Corbyn, ai shpjegon me gëzim.

"Programi ynë është shumë "New Labour": modernizimi i shtetit, një ekonomi e shëndoshë tregu dhe rritja e pagave për punën e nënpaguar".

Por mbi të gjitha, kryeministri interesohet për Europën. Kur u bë president i Komisionit European më 2014, Jean-Claude Juncker njoftonte se nuk do të kishte më zgjerim para 2019. Vendet e Ballkanit perëndimor, si Shqipëria, kanë bërë përpjekje reale për të reformuar ekonominë, për të hequr qafe gjyqtarët e korruptuar, për të eliminuar praktikën e korrupsionit

brenda aparatit shtetëror. Ata kanë kaluar shpejt vendet e Europës së lindjes, që u pranuan më 2004 dhe 2007.

Serbia më afër Moskës se Brukselit

Vendi që dominon në këtë rajon është Serbia e cila tani është më afër Moskës sesa Brukselit. Vladimir Putin i jep asaj avionë luftarakë dhe mjete ushtarake dhe ndikimi mediatic i lajmeve të rreme ruse është mjaft i dukshëm në shtypin dhe mediat serbe. Aleksander Vuçiç, presidenti serb, flet për bazën amerikane Bondsteel, në Kosovë, sikur ajo të ndodhej në territorin e Serbisë dhe nuk humb asnjë mundësi t'i kujtojë diplomatëve europianë dhe Uashingtonit pretendimet serbe në territorin e Kosovës.

Al-Aksa, pika e derdhur e kupës së mbushur



Harry HAGOPIAN

Detektorët metalik në hyrje të kompleksit të xhamisë Al-Aksa nuk janë kurrëgjë më shumë se pengesat më të reja në rrugën e gjatë dhe jo të rrafshët. E në mënyrë të caktuar, largimi i tyre është pjesa e marrëveshjes në mes mbretit të Jordanisë Abdullahit të dytë dhe kryeministrit izraelit Benjamin Netanjahut për kthimin e zyrtarëve izraelit të ambasadës në Jerusalem pas "incidentit" në ambasadën izraelite në Aman, në të cilin rojtari i ambasadës izraelite vrau dy shtetas jordanëz.

Por kjo nuk ishte ngjarja e parë, këtu nuk është puna me pajisje sikurse në aeroporte. Mjaft jam i vjetër që të kujtoj luftën 6 ditore të vitit

Në të vërtetë, është e qartë se po themelohen aleancat e reja dhe armiqësitë e reja, Izraeli është më shumë aleat strategjik me të cilën këmbëjnë informatat e sigurisë, e jo kundër tij i cili po lufton për vendet e veta të shenjta dhe drejtave të uzurpuara. Duke qenë se Irani është armik i përbetuar i disa liderëve arab, vlen parimi se armiku i armikut tim bëhet mik. Prandaj, vështirë është të shikosh të ashtuquajturin kuartetin antiterrorist i cili teatralisht po bllokun Katarin, njërin prej tyre, dhe e dënojnë për procedurat të cilët kurrëgjë nuk janë të ndryshme nga procedurat e atyre të cilët e akuzojnë

1967 me ç'rast hebrenjë izraelit kanë deklaruar triumfalisht se më në fund do të luten në Kodrën e Tempullit, siç e thërrasin kompleksin e xhamisë Al Aksa. Nga ajo kohë ky territor i

rrethakuar prej 35 hektarësh, i njohur si Tempulli i shenjtë(Harem al Shariף), apo kompleksi i xhamisë Al Aksa, ka qenë arenë e ngjarjeve të shumta të shëmtuara dhe situatave të pazgjidhura. A ju kujtohet viti 1969, kur xhamia Al Aksa është djegur, apo të hënës së zezë të vitit 1990 kur 20 palestinezë janë vrarë në masakër në Al-Aksa? A ju kujtohen 63 persona të cilët janë vrarë në vitin 1996 gjatë protestave pasi që izraelitët hapën tunelin e ri nën murin perëndimor? Apo intifadës së dytë në vitin 2000, e cila rrisi pasi që Ariel Sharoni sillte rreth kompleksit. Prej asaj kohe konfrontimet në mes palestinezëve dhe ardhacakëve izraelit të cilët i mbrojnë forcat izraelite sollën gjer të eskalimi i dhunës në Izrael dhe në territoret e okupuara arabe. Në të vërtetë Izraeli një kohë të gjatë ndjek qëllimet e t'ia politike të shkeljes së vendit palestinez nëpërmjet prizmës religjioze. Thjesht, grabit tokën në bazë të ideologjisë politike dhe pastaj e thekson se e merr për nevo-

jë fetare. Në të vërtetë, Izraeli diskuton për konceptin e ngjashëm me të cilin hebrenjtë dhe myslimanët të ndajnë Tempullin e shenjtë.

Izraeli ka propozuar që të ndanin edhe në kohë edhe në hapësirë, në të cilin myslimanët dhe çifutët do të hynin në kompleksin e xhamisë Al-Aksa në kohë të ndryshme. Duke propozuar këtë, Izraeli ka shfrytëzuar marrëveshjen për xhaminë e Ibrahimit (të njohur tek hebrenjtë Shpella e patrikut) në Hebron si shembulli i ardhshëm për Jerusalem. Në Hebron, p.sh. Hebrenjtë shfrytëzojnë 60% të xhamisë gjersa myslimanët e kanë vetëm 40%. Në përputhje me këtë, kolonët çifut religjioz po luftojnë të rrëmbejnë këto të drejta në bazë fetare, ndërsa zyrtarët qeveritarët i inkurajojnë nga arsyet politike. Pikërisht këtë javë gazeta Al-Resalah ka lajmëruar se Bezalel Smotrich nga partia Shtëpia Çifute bëri thirrje për ndërtimin e sinagogës në oborr të Al-Aksës. Është e rrezikshme kur religjioni dhe politika bashkohen në këtë

"Ka me të vërtetë nevojë për perspektivën e një anëtarësimi në BE, me qëllim që Shqipëria të mbetet e përqendruar në reforma dhe modernizim", deklaroi Rama, që thotë se është gati të pranojë një anëtarësim pa gjithë të drejtat e votës. Macron dhe Merkel që udhëheqin BE-në e reformuar pas Brexit në 2019, do të duhej të ftonin z.Rama në debatet mbi të ardhmen e Europës.

Në anën tjetër të maleve që ndajnë Shqipërinë nga Maqedonia, një tjetër qeveri socialdemokrate vjen në pushtet. Ashtu si Rama, Zoran Zaev, 40 vjeç, ka qenë kryetar bashkie i qytetit të dytë më të madh të Maqedonisë përgjatë 12 viteve. Ai flet për arsimin dhe furnizim me ujë dhe energji elektrike. Zv/presidentja e partisë së tij politike dhe ministre e mbrojtjes, Radmilla Sekerinka, është diplomuar në një universitet amerikan dhe ishte vendosur në SHBA apo Bruksel gjatë kohës që vendi i saj qeverisej nga Gruevski, një kryeministër nacionalist-populist i së djathtës në pushtet, qysh prej 2006.

Afrimi me Europën

Ai ka ngritur në Shkup statuja gjigande të Aleksandrit Madh dhe pretendon heroin helen si baba të kombit sllavo-shqiptar. Nikolla Gruevski ka krijuar atë që mund ta përshkruajmë si një "autogarki" (përzjerje e autokracisë me oligarkinë) dhe i ka lejuar shokëve të tij të djathtë të përfitojnë kontratat më të mira. I kapur pas pushtetit, Gruevski ka përgjuar kundërshtarët e tij.

mënyrë ndezëse. Ndërsa rezultati është se çdo çast shfrytëzohet që të paraqiten realitetet e reja në terren. A nuk është rasti gjatë gjithë kohës me vendbanimet ilegale? Detektorët metalik, kur të shikohen ndaras, vetëm janë faktor i vogël. Por në shikim të gjerë ato bëhen mjet për vendosjen e kontrollit gradual në territorin palestinez në mënyrën e cila nuk do të shqetësojë ndjenjat arabe dhe myslimane, dhe veçanërisht nuk do të alarmojë bashkësinë ndërkombëtare duke përfshirë edhe Bashkimin Evropian. Çdo rritje e drejtave të hebrenjeve izraelit çon në reduktimin e drejtave të myslimanëve palestinez, gjersa një mëngjes myslimanët në Palestinë dhe kudo tjetër të kuptojnë se aranzhmani nga Hebroni është kopjuar në Jerusalem. Por, ka ekzistuar diferenca. Në të kaluarën, bota arabe dhe myslimane i ka mbrojtë drejtat e palestinezëve në vendin e tretë të shenjët në islam. Nga Arabia Saudite gjer në Marok, nga Egjipti gjer në Jordani, këto shtete shfrytëzuan pozitën e vet morale dhe politike të parandalonin zhvillimin e këtyre planeve grabitëse. Megjithatë, pas kryengritjeve arabe nga periudha 2010-2011 topografia politike e rajonit dukshëm është ndryshuar, në disa raste në

Pas zbulimit të këtij skandalit, miqtë e tij politikë të rretheve konservatore të Berlinit dhe Brukselit nuk mund t'i jepnin më atij mbështetjen e tyre. Aktualisht ai po i nënshtrohet një hetimi dhe një procesi gjyqësor.

Radmilla Shekerinska shprehet si një socialdemokrate e Europës së veriut. Rroga minimale duhet të rritet me 20% dhe sektorët e energjisë dhe transportit duhet të jenë të hapur për investitorët e huaj për të frenuar korrupsionin që bëhet me kontratat që i jepen shokëve kur ka monopol shteti. Partia e saj ka një zv/president shqiptar dhe deputetë shqiptarë. Objektivi kryesor është anëtarësimi në NATO dhe ajo deklaroi që Shkupi është gati të pranojë një kompromis me Greqinë për çështjen e emrit. Në sytë e botës, kjo kontradiktë lidhur me emrin e këtij vendi është jodomethënëse, por asnjë nuk ka arritur të gjejë një zgjidhje as në Athinë, as në Shkup. Me disfatën e regjimit ultra-nacionalist të Nikolla Gruevskit, qeveria greke e Syriza do të jetë ndoshta e gatshme të lëshojë terren për këtë çështje, e cila ngjall ndjenja nacionaliste edhe në Greqi. Për Maqedoninë gjithashtu afrimi me Brukselin është një prioritet. Në një kohë që laburistët britanikë po tregohen gjithnjë e më të vendosur për të prerë lidhjet me Europën, partitë socialdemokrate në Shqipëri dhe në Maqedoni shohin tek Europa perspektivat më të mira. I kapur pas pushtetit, Gruevski ka përgjuar kundërshtarët e tij.

mënyrë delikate e në disa raste të dukshme. Këto ditë masat arabe janë të zënë me luftërat sizif kundër despotizmit të pushtetarëve të vet, e jo për të ngrit zërin për drejtat e palestinezëve. Në të vërtetë, Palestina sot ka mbështetje më të madh jashtë botës arabe, se brenda saj. Janë të pakta qeveritë arabe të cilët edhe më tutje i përkrahin të drejtat e palestinezëve, po të jetë fjalë për drejtën në vetëvendosje, apo në lëvizje të lire, apo në rrëfimim e fesë. Në të vërtetë, është e qartë se po themelohen aleancat e reja dhe armiqësitë e reja, Izraeli është më shumë aleat strategjik me të cilën këmbëjnë informatat e sigurisë, e jo kundër tij i cili po lufton për vendet e veta të shenjta dhe drejtave të uzurpuara. Duke qenë se Irani është armik i përbetuar i disa liderëve arab, vlen parimi se armiku i armikut tim bëhet mik. Prandaj, vështirë është të shikosh të ashtuquajturin kuartetin antiterrorist i cili teatralisht po bllokoi Katarin, njërin prej tyre, dhe e dënojnë për procedurat të cilët kurrë nuk janë të ndryshme nga procedurat e atyre të cilët e akuzojnë. A nuk do të ishte më mire të investojnë kohën, energjinë dhe parat duke mbrojtur të drejtat arabe të cilët dalëngadalë për vidhen në mënyrë të vazhdueshme?



Lisen BASHKURTI

Mbas zgjedhjes në postin e Presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq ka inicuar një debat të gjerë dhe të hapur publik lidhur me Kosovën dhe raportet e Serbisë me të. Iniciativa e Vuçiq vjen në një kohë kur Serbia ka hyrë në një fazë shumë të avancuar të negociatave për anëtarësim në BE. Në këtë fazë është imperative që Serbia t'i jap zgjidhje qëndrimit të saj lidhur me statusin e Kosovës, politikën e fqinjësisë së mirë si dhe përaftrimin e politikës së jashtme në linjë me BE. Debatit shoqëror në Serbi mbi statusin e Kosovës hapet në një kohë kur kjo e fundit tanimë është një realitet i pamohueshëm dhe i njohur ndërkombëtarisht nga 113 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara. Në një kontekst më të gjerë, debati mbarëshoqëror i Serbisë për definimin e qëndrimit për statusin e Kosovës është hapur kur Ballkani Perëndimor ka hedhur hapa të mëtejshëm drejt Euro-Atlantizmit. Pranimi i Malit të Zi në NATO, afrimi i shpejt i Maqedonisë drejt saj si dhe avancimi i Shqipërisë drejt hapjes së negociatave për anëtarësim në BE përbëjnë një zhvendosje pozitive të Ballkanit Perëndimor drejt Euro-Atlantizmit.

Në këtë dinamikë ballkanike drejt Euro-Atlantizmit, Serbia nuk mundet të qëndrojë e izoluar dhe madje as e mënjanojë kryesisht për shkak

Mbi hapjen e dialogut në Serbi për Kosovën

Në këtë dinamikë ballkanike drejt Euro-Atlantizmit, Serbia nuk mundet të qëndrojë e izoluar dhe madje as e mënjanojë kryesisht për shkak të qëndrimit të ngurtë ndaj Kosovës

të qëndrimit të ngurtë ndaj Kosovës. Ndërsa në kontekst më të gjerë Evropian, Perëndimor, Rus dhe global debati Serb për Kosovën hapet kur krizat ndërkombëtare janë shtuar dhe komplikuar tej mase, duke rrezikuar edhe vet Ballkanin Perëndimor të përfshihet në to. Përballë këtij rreziku duket që është rritur vëmendja e BE dhe SHBA për Ballkanin Perëndimor, për sigurimin e paqes, stabilitetit, demokracisë, zhvillimit socio-ekonomik dhe integritetit. Ky zhvillim i ri synon, gjithashtu që të vetëpërmbyjë edhe Rusinë nga ambiciet e saj gjeopolitike në drejtim të Ballkanit. Hapja e debatit publik të Serbisë për qëndrimin ndaj Kosovës ka vlera të gjithanshme që lypet të konsiderohen pozitivisht, pavaresisht pritshmëri për përfundimet e tij.

Së pari, debati është një hap pozitiv për të hapur tabutë dogmatike të së kaluarës mbi Kosovën. Lënia pas e miteve krijon premisa për qasje realiste të Serbisë ndaj Kosovës. Hapja e tabuve dhe rrëzimi i miteve të së kaluarës në Serbi për Kosovën

kërkon debat të hapur shoqëror sepse prej afro një shekulli e gjysmë shoqëria serbe është viktimë akademike e politike e këtij indoktrinimi.

Së dyti, hapja e debatit kërkon që të krijojë një bazë të gjerë mbështetëse shoqërore për aktorët shtetëror e politik për ndryshimet kushtetuese të domosdoshme që nevojiten të bëhen për Kosovën dhe qëndrimin ndaj statusit të saj. Pa mbështetje të gjerë shoqërore në Serbi nuk mund të ketë ndryshime pozitive politike dhe as mundësi për zbatimin e tyre. Së treti, hapja e debatit publik Serb për Kosovën krijon klimë pozitive për qarqet akademike, mediatake dhe të shoqërisë civile për gjithëpërfshirje në politikë-bërje dhe vendim-marrje në lidhje me qëndrimin ndaj Kosovës dhe statusit të saj.

Së katërti, hapja e debatit publik në Serbi për Kosovën synon të qartësojë krahas qëndrimit për statusin e saj politik disa aspekte të cilat përbëjnë kërkesa të diskutueshme. Këto kërkesa të diskutueshme lidhen me dy aspekte: statusi i pakicës Serbe në Kosovë; statusi i trashëgimisë kulturore religjioze të Serbisë në Kosovë. Për të dy këto aspekte ka qasje të paqarta, konfuze e kontradiktore brenda Serbisë, midis Serbisë dhe Kosovës, madje edhe në qarqet Euro-Atlantike dhe Ruse. Natyrisht debati publik nuk mund t'i japë defini-

cion zgjidhjes së këtyre dy aspekteve. Por, gjithsesi debati do jetë një test publik për t'i hapë rrugë edhe përcaktimeve për zgjidhjet që lypet të bëhen lidhur me pakicat Serbe në Kosovë dhe trashëgiminë kulturore dhe religjioze të tyre.

Së fundi hapja e debatit publik do nxisë më tej transparencën dhe bazën e gjerë demokratike në politikën publike përfshirë edhe politikën e jashtme si pjesë integrale e tyre. Është ky një mesazh që Serbia i drejton BE, por, për hir të vërtetës duhet thënë se është edhe një model për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, që akoma vuajnë nga mungesa e debateve publike për politikën publike, nga mungesa e transparencës, përgjegjëshmërisë dhe gjithëpërfshirjes. Se çfarë rezultatesh do dalin nga debati publik Serb për Kosovën dhe statusin e saj është herët të gjykojmë. Por, ajo që mund të thuhet është fakti që ky debat i gjerë dhe i hapur publik do e nxjerrë Serbinë nga rrethi i mbyllur vicioz aktual dhe do ndikojë në ndryshimin e mjedisit politik në mbarë Ballkanin Perëndimor. Si i tillë hapja e debatit Serb për Kosovën dhe statusin e saj lypet të përshëndetet dhe të inkurajohet. Armiqësitë e vjetra midis popujve nuk duhet të pengojnë vështrimin dhe vlerësimin e zhvillimeve pozitive të reja ndërmjet tyre. (gazeta blic)

Korriku gjallëronte vendin tim

Gëzim XHAMBAZI

Gjithmonë në mars gjallëron natyra, në korrik gjallëronte vendi im. Ishte muaji më i dashur dhe më i lodhshëm për të gjithë. Të korrrat, fejesat e martesat, mevludet e pagëzimet, të gjitha bëheshin në korrik. Gratë, në veturë i mbanin shamitë edhe për dasmë edhe për mort (siç e kërkonte tradita). Aspak e kollajshme kjo. Nevojitet forcë magjike për të përballuar pikëllimin dhe gëzimin njëkohësisht. Rrugët e fshatit ishin plot njerëz, në çdo kohë. Fëmijët e mërgimtarëve as që hynin në shtëpi, pasi që në oborr, me plot dashuri, i pritnin të afërmit dhe shokët e tyre të fshatit, dhe së bashku rrezatonin gjallëri. Dhe kur niseshin për mërgim, nuk dilyn nga shtëpia, por largoheshin nga rruga, duke lënë moshatarët me lojën në gjysmë dhe me lot në sy.

Viteve të fundit, korriku jep vetëm zhurmë, jo gjallëri. Fëmijët e mërgimtarëve, në vend të shokëve, tani i pret super shtëpia, me super oborr, dhe aty afër derës së hyrjes një pishinë gome. Ata në vazhdimësi vëzhgojnë prindërit e

kemi filluar të presim edhe gjeneratën e katër nga mërgimi, dhe është koha e fundit për të ndërmarrë diçka, për të provuar të kthejmë gjallërinë. Këtyre fëmijëve dikush duhet t'ua bëjë me dije se ky është vendi i tyre

tyre duke vrapsuar pas TERMIN-EVE, dhe fjala më e shpeshtë që dëgjojnë është STRESI. Këta fëmijë janë shumë të singertë, janë shumë të mençur. Si të gjithë fëmijët tjerë. Ata kurrë nuk ankohen, se drekë e darkë kanë vetëm ushqime të shpejta, asnjëherë nuk e shprehin ndjenjën e diskriminimit, edhe pse nga disa përqeshen apo quhen të huaj (AUSLANDER), bile detyrohen edhe të gënjajnë, ashtu siç i kanë mësuar prindërit, tu thonë të tjerëve se KËTU MË PËLQEN MË SHUMË. Gënjeshtra një ves, aspak i zakonit për ta. Ata shumë pak flasin dhe gjithmonë anashkalojnë bisedat, por u shkëlqejnë sytë kur dikush ju flet gjuhën që flasin në shkollë. Jo se nuk e duan shqipen, porse ndjejnë pasiguri.

Tanimë, kemi filluar të presim edhe gjeneratën e katër nga mërgi-

mi, dhe është koha e fundit për të ndërmarrë diçka, për të provuar të kthejmë gjallërinë. Këtyre fëmijëve dikush duhet t'ua bëjë me dije se ky është vendi i tyre, se vijnë në shtëpitë e tyre, dhe këtu flitet gjuha e bukur shqipe, të cilën me shekuj e kanë folur të parët e tyre. Këta fëmijë kërkojnë kujdes, ata janë krijesa të pastra, si ti edukoni ashtu do ti keni. E njejtja si shtëpia, po investove dhe u kujdese më shumë, patjetër do të jetë më e mira. Të rriturve, mjafton tu bëhet me dije se fëmijët janë ardhmëria, e jo mburrja e politika. Duhet hequr dorë nga salltanatet, nga politika-profesion i mallkuar dhe nga NE aq i preferuar. Dëgjoj shumë njerëz të cilët këmbëngulin se me aftësitë dhe idetë e tyre janë të gatshëm të ndërtojnë strategji afatgjata, si për komunën, kombin e regionin, bile edhe për AMERIKËN. Por se, për të realizuar këtë, kanë vetëm një problem...nuk ua merr kush mendimet në konsideratë! Korriku është i nxehët dhe i thatë, ai të vëshk shpejt, kërkon UJË, kërkon racionalitet. Në korrik bëni shumë kujdes me korrikun, përndryshe ai të përvëlton!

Martesa më së fundi fiksohet për datën 21 gusht 1745. Mëngjesin e kësaj dite Katerina, pasi bën një banjë, drejtohet nga apartamentet e Elizabetës, e cila me disa gra të tjera e zhveshin lakuriq dhe e kontrollojnë. Katerina duket në vështrimin e tyre se është e aftë për të bërë fëmijë. Duke parë veten në pasqyrë kupton se, vajza që nuk kishte qenë aspak e bukur në fëmijëri, me trup të shtrembër, të hollë si skelet dhe me fytyrë të deformuar, tashmë kishte marrë format dhe një siluetën e një femre të pjekur të paraqitshme, e cila ndihmuar dhe nga gjatësia dukej si të ishte një femër tjetër nga ajo e dikurshmja

Ajo është një nga femrat më të njohura të historisë, dhe gruaja që për vite me radhë drejtoi perandorinë ruse. Por jeta e saj nuk ka qenë e lehtë, jo vetëm për luftën për të mbajtur pushtetin, por dhe për të ndjekur zemrën. Sa e ashpër aq edhe delikate, Katerina e Madhe e Rusisë nuk ka reshur s' dashuruari. Vetë ajo ka shkruar gjithçka në kujtime. Historitë e saj finisin me Pjetrin, ai lidhja me të cilin do ta ofronte me pushtetin. Pikërisht kur lidhja e saj me të po bëhej e ftohtë, mbretëresha Elisabetë do të ndërhyjë. Nuk luanin më bashkë si më parë nëpër korridorët e pambarimta të pallatit petroburgez, edhe lojërat e tyre do të ndërpriteshin duke ia lënë vendin një ftohtësie dhe distance, që sa vinte e po ndryshonte sjelljen e tyre duke i lënë vendin një situatë marrëdhënieje si mes dy të panjohurve. E tërë kjo vinte prej shkëputjes së Pjetrit, i cili duke mos e duruar dot Katerinën, tek shihte përkushtimin e saj për mësimin e gjuhës dhe të riteve fetare ruse, e përçmonte akoma më shumë. Ndoshta pse i dukej se po tradhtonte çfarë ata që kishin pasur të përbashkët dhe të veçantë; faktin e të qenit gjermanë ose ndoshta prej admirimit dhe vëmendjes së perandores dhe aristokratëve të lartë. Katerina nga ana e saj, do ta vuante këtë qëndrim të bashkëshortit të saj të ardhshëm. "Ndërgjegjësohesha me kalimin e kohës për ftohtësinë e tij dhe mungesën e vëmendjes, por dhe ndjeja se afeksioni për të, po më largohej edhe mua. Krenaria ime dhe mendimi për veten po shuheshin me këtë sjellje, por ishte përsëri krenaria

KATERINA E MADHE E RUSISË

Pa dashuruar, zemra ime nuk mund të jetë e lumtur



që më bënte mos ta jepja veten. Do të ndihesha më e helmuar, nëse do të kishte shfaqur vëmendje ndaj meje për mëshirë. Megjithatë, qaja vetëm, pastaj fshija lotët dhe shkoja të humbisja mendjen me shoqërueset e mia", shkruan Katerina në kujtimet e saj.

Elizabeta e vëren këtë mungesë vëmendje totale të të nipit, ndaj mendon se nuk duhet të humbasë kohë për t'i martuar, sepse ndonjë vendim i papritur i adoleshentëve për të prishur publikisht fejesën, mund t'ia shkatërronjë planet. Nuk i intereson aspak nëse ata e duan njeri-tjetrin, por ardhja në jetë e një fëmije prej çiftit, përbën një domosdoshmëri për legjitimitimin e pushtetit të saj, për fronin, për Rusinë. Edhe pse mjekët e informojnë se Pjetri, shtatëmbëdhjetëvjeçar, ende nuk është pjekur seksualisht dhe për pasojë nuk është në gjendje të bëjë fëmijë. Nuk ka kohë të presë më shumë dhe vendos datën e martesës. Përgatitjet për dasmën fillojnë me një jehonë të madhe në oborrin perandorak, por edhe në të gjithë Rusinë. Edhe shoqëruesit e Pjetrit im-



penjohen për t'i treguar atij sekretet e fshehta të seksit dhe t'i shpjegojnë kënaqësitë që vijnë prej tij duke e vënë në provë, për të mësuar e për t'u aftësuar për jetën bashkëshortore, perandorin e ardhshëm, që reagoonte si një i vonuar mendor. Martesa më së fundi fiksohet për datën

21 gusht 1745. Mëngjesin e kësaj dite Katerina, pasi bën një banjë, drejtohet nga apartamentet e Elizabetës, e cila me disa gra të tjera e zhveshin lakuriq dhe e kontrollojnë. Katerina duket në vështrimin e tyre se është e aftë për të bërë fëmijë. Duke parë veten në pasqyrë kupton se, vajza që nuk kishte

qenë aspak e bukur në fëmijëri, me trup të shtrembër, të hollë si skelet dhe me fytyrë të deformuar, tashmë kishte marrë format dhe një siluetën e një femre të pjekur të paraqitshme, e cila ndihmuar dhe nga gjatësia dukej si të ishte një femër tjetër nga ajo e dikurshmja. Edhe pse nuk kishte tipare goditëse, hijeshia dhe ëmbëlsia që shprehte, nxjerrë në pah nga sytë e mëdhenj shprehës dhe plot jetë, e bënin Katerinën të dukej një efekt të veçantë befasues. Caresha i vë në kokë kurorën e grandukeshës, që është aq e rëndë sa mund ta rrëzojë në ecje. Karroca e tërhequr nga tetë kuaj të bardhë të stolisur nisat drejt Katedrales së Kazanit. Në të qëndrojnë perandorja Elizabet dhe dy grandukët e rinj, shkëlqyes nga zburimet e veshjeve të tyre të praruara, mes turmës së madhe që ka mbushur rrugët e Shën Petërburgut, që i nderon duke u përkulur deri në tokë. Pas ceremonisë fetare disa orëshe, shtrohet një banket i madh në Pallatin e Dimrit, në përfundim të të cilit nis festa e ballos që do të zgjasë tërë natën. Çifti ndihet i dërrmuar nga gjithë ajo ditë impenjative ku nuk kanë ndalur asnjë çast, kur ende pa mbaruar balloja, Perandorja, shoqëruar nga dinjitarët më të mëdhenj, nga oborrtarët dhe damat shoqëruese, do t'i vërë përpara për ti çuar dy të rinjtë në shtratin martesor. Do të kalojë nata e parë dhe më pas, shumë net të tjera e Katerina, në shtrat me burrin e saj, do të mbetet një femër ende e virgjër. Elizabeta pret lajmin e mirë të shtatzënisë, i cili nuk po vjen. Kjo e bën të tërbohët dhe të shpërthejë në kriza hysterizmi që përfundojnë me vendime drastike ndaj oborrtarëve, ku arreston dhe torturon edhe njerëz të afërt. Do të largojë nga Rusia gjithë familjarët e shumë gjermanë të grandukës që ishin rezidentë aty, miqtë e lojrave të tij do të mbyllen nëpër fortesa ose do të degdisen në pronat largëta të familjeve të tyre, detyron gjithë femrat e oborrit të rruajnë kokën dhe me dhimbje ato i binden perandores. Asnjë nuk është i mbrojtur dhe këtë Katerina e di mirë, qysh kur njëherë i thirri më Pjetrin dhe i kërcënoi për disa lojëra të papëlqyera, se mund të tregojë si babai i saj, Pjetri i

Madh, i cili burgosi dhe torturoi deri në vdekje të birin e tij dhe vëllain e Elizabetës, Aleksejin.

Nën frikën e burgosjes apo internimit, intrigat nuk kanë të sosur dhe asnjë nuk është imun prej tyre. Katerina ndjen ankth dhe për frikën e dëshpërimit shkruan: "Jeta ime është e tillë sa dhjetë të tjerë do të ishin çmendur në vend tim dhe njëzet, do të kishin vdekur nga dhimbja". Përpigjet ta kalonte kohën në natyrë duke shkuar për të gjuajtur rosa ose për të kalëruar, gjë që e zbaviste pamasë. Mund të kalëronte edhe trembëdhjetë orë pa pushim duke arritur në një lodhje fizike, si alternativë për të mbajtur mendjen. Perandorja nuk ka më durim për të pritur një fëmijë nga çifti dhe thërret mjekët për t'i kontrolluar përsëri të dy. Pjetri diagnostikohet me një problem në organet gjenitale, që sipas doktorëve në vendet e lindjes zgjidhet duke e bërë synet. Katerina nga ana e saj e di mirë se, nëse ajo nuk do të jetë e aftë të sjellë në jetë një fëmijë, e pret fortesa apo ndonjë burg siberian, si dënim më ngushëllues.

Por ja ku shfaqet në oborrin e grandukëve, një i djalosh ri i quajtur Sergej Saltikov, pinjoll i një prej familjeve më antike dhe aristokrate të Rusisë. "Është i bukur si një diell dhe nuk i afrohej për nga bukuria asnjë mashkull, si në oborrin perandorak ashtu dhe atë tonin. Nuk i mungonte as shpirti e as ai total njohurish, mënyrash e sjelljesh, që janë fryt i prejardhjes nga një botë e lartë. Ishte njëzetegjashmë vjeç dhe nga çdo pikëpamje, si për origjinë familjare dhe për cilësitë e panumërta, paraqiste aristokratit shumë të rafinuar", shkruan Katerina për të. Sergej është nga ata tipa të ndërgjegjshëm për atë çfarë ata janë dhe sa mbërrin në oborr, me sigurinë në vetvetë, nis t'i vardiset grandukeshës. Ka eksperiencë të pasur me femrat edhe pse i martuar dhe me fëmijë, përpigjet pa nguruar të joshë Katerinën, duke e vënë veten në një rrezik të madh. Por duket se tipit të tij i pëlqen dhe eksitohet nga kjo lloj përkundjeje, midis kënaqësisë së joshjes dhe internimit. Katerina ndihet shumë mirë në shoqërinë e tij dhe një natë, kur gjithë rrethi i tyre gjendet në një ishull të lumit Neva, koha e keqe do t'i detyrojë ta kalojnë natën aty. Sergej përfiton duke iu afruar grandukeshës në errësirën e natës, ndriçuar dobët nga pak qirinj, ku fjalët e dashurisë nuk do t'i mungojnë, derisa e mbërthen Katerinën pas një peme, larg vëmendjes së të tjerëve dhe të Pjetrit duke e shtërnguar fort, e detyron t'i pohojë se edhe ajo ndjen për të. Katerina reziston derisa e pranon faktin dhe kur sapo ai largohet i thotë: "Jo, Jo". Por Sergej e ka kuptuar se e ka fituar zemrën e saj dhe e ka të qartë, se pas gohej si babai i saj, Pjetri i



netët së bashku, pa rënë në sy të tjerëve. Të paktën kështu do të kujtojnë.

Katerina më së fundi kupton se është shtatzënë. Guximi i djaloshtit çapkën shndërron tashmë nga një frikë të madhe. Po sikur të zbulohet se është ai babai i fëmijës? Pjetri nuk është i aftë për të kryer një raport seksual dhe Sergej përdor tërë aftësitë e tij që ta bindë të kryejë ndërhyrjen kirurgjikale, tek e cila granduka nuk beson. Gjithë miqtë e tij të oborrit, të shtyrë edhe nga Sergej, i ulen në gjunjë dhe i luten që të pranojë ta bëjë. Pjetri i nënshtrohet operacionit dhe mbas disa kohësh e ndjen veten të aftë për të shkruar përsëri në shtratin e bashkëshortes së tij, por kësaj herë me qëllime të tjera.

Katerina, e cila e dashuruar marrëzisht me Sergejin, zihet ngushtë dhe detyron ta mbajë mbi trupin e saj atë bashkëshortin, për të cilën tashmë, ndjen veç neveri. Sergej mendon edhe një lëvizje tjetër të djallëzuar. Bën një pako dhe ia çon Perandores si dëshmi që akti seksual midis trashëgimtarëve të fronit ishte kryer dhe provat dëshmonin, se Katerina ishte e virgjër. Perandorja Elizabet është entuziaste në ekstrem. Sergej Saltikov është çliruar nga persekutimi që e priste. Eksperiencia e ka bërë të kuptojë se ka rrezikuar shumë dhe se duhet të jetë më i kujdesshëm, ndaj fillon e të largohet përherë e më shumë nga Katerina, e cila e ndjen këtë dhe dëshpërohet. Pasioni që ka lindur për herë të parë në jetën e saj, ia errëson logjikën dhe frikën e ndëshkimit, që zbulimi i lidhjes mund të sjellë edhe për të. Një ditë Sergej i thotë se duhet ta ndërpresin marrëdhënien, pse dikush i ka spiunuar tek perandorja dhe janë në rrezik të madh. Sergej tregohet jo i drejtë me të duke iu shmangur edhe lutjeve të Katerinës, që të qëndrojnë bashkë, qoftë edhe për pak caste. Pasi lidhja nuk kishte mbetur më sekret i tyre, ai do të dërgohet si diplomat në Hamburg dhe Katerina nuk do ta shohë më kurrë. Më vonë ajo do të shkruajë që për lidhjen e tyre, padyshim ishte në dijeni edhe Elizabeta, por shtatzënia e saj ishte tashmë një detyrim shtetëror, një detyrim ndaj Rusisë dhe prandaj rëndësi kishte, më shumë se detaje të tjera, ardhja në jetë e një fëmije. Të gjithë janë euforikë për shtatzëninë e Katerinës dhe të gjithë të kujdesshëm që gjithçka të shkojë mirë. Më 20 shtator 1754, në prezencën e perandores, të grandukës dhe disa personave të tjerë, mamia nxjerr një trup të vogël foshnjeje nga trupi i Katerinës. Është djalë dhe Elizabeta ndihet kjaç dhe shumë e mbështjelljes, e merr në apartamentet e saj duke e

privuar njëherë e mirë të emën e tij, për ta parë e për t'u kujdesur për vogëlushin. Do ta quajnë Pavël Petroviç, trashëgimtari i fronit dhe car i ardhshëm i Rusisë.

"Fatkeqësia ime", shkruan vite më vonë Katerina, "është se pa dashuruar, zemra ime nuk mund të jetë e lumtur, as edhe për një orë". Sër Uiliams, diplomati anglez, mik i saj që i ofron edhe ndihmë financiare, i prezanton një djalë të ri polak, njëzetvjeçar. Konti Stanislao Poniatovski vjen nga një familje e lartë e aristokracisë polake, është tepër i rafinuar, një mirë filozofinë, flet shumë gjuhë dhe ka qëndruar në oborret mbretërorë evropianë, ku në Paris ka lënë një mbresë të mirë si njeri me përgatitje dhe elokuencë të rrallë. Përveç këtyre cilësive, është tej mase i bukur, fytyrë perfekte dhe një trup të formuar bukur. Të dy bien në dashuri menjëherë me njeri-tjetrin dhe konti polak do të mbetet dashuruar tërë jetën. Katerina është e pushtuar nga ndjenjat për polakun dhe shumë netë, do të vishet si mashkull shërbyes, duke mbështjellë flokët nën një beretë, për t'u larguar në fshehtësi të madhe me një karrocë anonime, në shtëpinë e një mikut të saj, për të kaluar momente të zjarra në krahët e Poniatovskit. Por një natë të ftohtë, karroca në të kthyer rëshqet në akull duke u kthyer dhe nxjerr Katerinën në rrugë. Për një moment mbeti pa frymë, por pastaj u përmend dhe e vrarë në trup u drejtua drejt pallatit, ku një nga dama e saj kishte harruar t'i linte hapur për të hyrë, një nga dyert e shërbimit. Për të evituar të tilla incidente, dy të dashuruarit filluan të takohen fshehurazi në dhomën e Katerinës në pallat. "Ndjenim një kënaqësi të jashtëzakonshme nga këto takime të fshehta dhe me ankth", kujton Katerina. Ajo, njëzetepesë vjeçare, i tregon djaloshtit polak kënaqësitë e seksit duke harruar se ekzistonte Siberia.

Eksperiencia me Sergejin i ka mësuar edhe një gjë tjetër të rëndësishme: është bukur të lëshohet në krahët e dashurisë dhe të provosh kënaqësitë e epshit, por duhet refuzuar ideja se ai është qendra e universit. "Isha një kavalier me një shpirt më mashkullor sesa femëror. Tek mua gjendeshin bashkuar me shpirtin dhe karakterin e një djali, tërheqjet e një femre me shumë nevojë për dashuri", shkruan Katerina. Si pasojë e përkëqësimit të marrëdhënieve të Rusisë me Anglinë, perandorja Elizabet kërkon që diplomati anglez Uiliams të largohet si i padëshiruar nga vendi e me të edhe mikun e tij, konti polak Stanislao Poniatovski. Jo shumë vite më vonë Katerina do të kurorëzohet atë mbret të Polonisë. (gazeta shqip)



Sheriati nuk është ligj!

Sipas studiuesit me emër të fesë islame Abdullahi Ahmed An-Na'im, sheriati dhe shteti shekullar nuk janë patjetër në kontradiktë me njëri-tjetrin

Shumë njerëz e lidhin sheriatin me ligjin, por në fakt ai është i tërë sistemi normativ i fesë islame, sikurse janë paraqitur në Kur'an, suna dhe hadithet. Pra sheriati përmban edhe rregulla se si të lutesh apo të agjërosh. "Parë në këtë aspekt edhe në një shtet shekullar është e pamundur t'u mohosh muslimanëve që të mos orientohen nga sheriati. Por një shtet, qoftë me shumicë muslimane apo jo, nuk mund ta miratojë kurrë sheriatin, sepse sheriati nuk është ligj i kodifikuar. Sheriati ka të bëjë me interpretime që njerëzit duhet t'i zgjedhin me bindjen e tyre", thotë Abdullahi Ahmed An-Na'im. Sheriati është sipas An-Na'im "një udhëzues etik veprimi për çdo musliman". Dhe sipas tij shteti dhe feja duhet të ndahen në mënyrë të qartë nga njëri-tjetri. "Për mua si musliman, shteti duhet të jetë shekullar (i ndarë nga feja), në mënyrë që unë të mund ta ushtrojë besimin tim nga bindja dhe si vendim të lirë. Pra, nga një perspektivë islame, kjo nuk ka të bëjë me iluminizmin evropian. Shtetit nuk ka se ç'i duhet, nëse unë jam ateist apo besimtar". Sipas An-Na'im, ka një dallim mes shtetit dhe politikës. Shteti nuk ka të bëjë fare me fenë, kurse për politikën feja ka rëndësi. P.sh. në Gjermani partia CDU i sheh bindjet e saj politike të frymëzuara nga krishterimi.

JO GJITHÇKA NË BOTË LIDHET ME PËRFYTYRIMET EVROPIANE TË SHTETIT SHEKULLAR

Kur muslimanë themeluan 1.400 vjet më parë shtetin e tyre në Medinë, ai nuk ishte as islamik, as fetar. Ky shtet ishte një institucion politik, dhe as muslimanët dhe as kundërshtarët e tyre nuk e përshkruanin atë si një shtet fetar. Koncepti i shtetit islamik është një konstrukt post-kolonial që e lidh shtetin kombëtar evropian me idenë e vetëvendosjes mysliane. Jo gjithçka në

botë lidhet me iluminizmin dhe përfytyrimet evropiane të shtetit shekullar.

Po ashtu, sipas mënyrës së të kuptuar të shtetit shekullar në Francë, Gjermania nuk do të konsiderohej si e tillë. Madje Britania e Madhe, ku mbretëresha është njëkohësisht edhe kryesuese e "Church of England" nuk do të konsiderohej si shekullare as sipas standardeve gjermane. Megjithatë të tri këto shtete konsiderohen si shekullare. Lidhja e shtetit shekullar me iluminizmin është një thjeshtëzim që nuk mbështetet tek historia evropiane. Shteti kombëtar është konstrukt evropian që iu imponua edhe vendeve të kolonizuara në Afrikë dhe në Azi. Pas shpalljes së pavarësisë në vende të ndryshme, mysliantët u gjendën në shtete kombëtare sipas përfytyrimit evropian, të cilët nuk u përgjigjeshin kulturës dhe vlerave të tyre. Fuqitë evropiane ua imponuan atyre shtetin kombëtar dhe pasojat tragjike të kësaj i shohim tani në Siri dhe në Irak.

SHERIATI PËRMBAN EDHE RREGULLA LIGJORE, POR AI NUK ËSHTË LIGJ

Sheriati nga natyra e tij nuk është diçka që mund të kodifikohet, mendon Abdullahi Ahmed An-Na'im.

"Çdo kodifikim do të reduktonte kompleksitetin e një traditë të gjatë me një shumicë opinionesh kontradiktore në një këndvështrim të thjeshtë, i cili do të reflektonte pastaj vetëm mendimin e atyre që kanë për momentin pushtetin në shtet". Sipas tij, vërtet që shtete si Maroku, Mauritania apo Indonezia këmbëngulin për zbatimin e sheriati, por kjo nuk është e ligjshme. Sepse autoritetet shtetërore përzgjedhin nga sheriati kudo në mënyrë shumë selektive dispozita, në vend që t'u lejojnë muslimanëve që të vendosin vetë. Për shumë shoqëri identiteti fetar është një tipar qendror, por ky nuk ka pasoja ligjore. Nga ana tjetër ka edhe vende jo-muslimane me fe zyrtare, si Irlanda. Në Pakistan, Iran apo Mauritania feja islame është fe shtetërore, po ato janë shtete krejt të ndryshme.

REFORMIMI I FESË ISLAME

Sot ka shumë intelektualë që bëjnë thirrje për reformimin e

fesë islame, por me këtë ata kuptojnë gjëra të ndryshme. Edhe studiuesi i fesë islame Abdullahi Ahmed An-Na'im ka shkruar një libër me titullin "Drejt një Reformimi Islamik". Sipas tij reformacioni i Luterit dhe është shumë më tepër se historia e një murgu që vari kërkesat e tij në derën e kishës.

Lëvizjet transformuese kanë nevojë për një kohë të gjatë dhe janë pjesë e një konsensusi. Njerëzit e asaj kohe nuk e dinin se ishin pjesë e reformimit të fesë së krishterë. Vetëm në retrospektivë mund t'i vësh re këto procese. "Edhe në rastin e reformimit të fesë islame kemi një proces të ngjashëm. 1,6 miliardë muslimanët kanë një diapazon të madh drejtimesh besimi. Dhe reformimi nuk bëhet si me magji, sepse ka shumë ide që pranojnë apo refuzohen", thotë Abdullahi Ahmed An-Na'im. Sipas tij, për sa kohë bota islame do të imitojë modelet evropiane, ajo nuk do të jetë vërtet e çliruara prej kolonializmit.

"Ne duhet t'i bazojmë modelet tona politike tek historia janë, duke u përpjekur ta zbërthejmë rëndësinë e historisë mysliane në epoka dhe rajone të ndryshme. "Unë nuk dua të imitoj modelin gjerman, francez apo britanik. Unë e formuloj doktrinën time politike në koncepte, që janë jashtë kufizimeve koloniale evropiane", thotë Abdullahi Ahmed An-Na'im.

Gjithsesi, ai e lidh nevojën që sheh për reformimin e fesë islame me faktin, që kur studionte në universitetin e Khartumit në Sudan kishte nisur të kuptonte se parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut binin në kundërshtim me konceptin e sheriati që ofrohej në leksione. Sipas tij ka mjaft muslimanë që nuk janë dakord me kuptimin tradicional të fesë islame, si mungesa e të drejtave për gratë apo e lirisë fetare.

Abdullahi Ahmed An-Na'im, lindur në Sudan në vitin 1946, është ndër studjuesit më të spikatur të fesë islame në SHBA. Fushat e tij të studimeve janë legjislacioni islam, të drejtat e njeriut dhe e drejta ndërkombehtarë. Një ndër librat e tij më të rëndësishëm është "The Future of Sharia: Islam and the Secular State" (2009)

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 e vendimit për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit nr. 07-7450/1 të datës 30.10.2014 "Gazeta Zyrtare e Qytetit të Shkupit" nr. 12, ndërsa në pajtim me Vendimin për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit, ndërsa shfrytëzues i së cilës është SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup, në pajtim me vendimin e sjellë nga Këshilli i shkollës së SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup nr. 02-267/2 të datës 20.04.2017 dhe Pajtimit nga Kryetari i Qytetit të Shkupit nr. 08-3335/12 të datës 15.05.2017, SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup publikon

Shpallje 01-2017

Për dhënie me qira të hapësirës së shkollës në katin përderes për kryerje të veprimtarive hotelerike – bufe përmes ankandit publik

- Qiradhënësi:** SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup, me seli në rr. Llazo Trpovski pn Shkup, tel. 02 2634-312, faks 02 2634-311
- Ofertues:** Të drejtë për të parashtruar kërkesë për qira të hapësirës së theksuar shkollore ka secili subjekt i cili është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën për qira.

- Lënda për qira:** 3.1 Hapësirë në katin përderes të shkollës për kryerje të veprimtarisë hotelerike – bufe me sipërfaqe prej **15,80 m2**
- Çmimi fillestar:** 4.1 Çmimi fillestar i ankandit publik për hapësirën e theksuar nga pika 3.1 është 5 euro për metra katror, në kundërvlerë denarë pa TVSH të përlogantur sipas kursit mesatar të BPRM, plus shpenzimet materiale, ngrohje për m2, ujë-ujëmatës, rrymë me numërues.

- Afati dhe mënyra e dorëzimit të dokumenteve:** 5.1 Shpallja për dhënie me qira të hapësirës së shkollë zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit të saj. 5.2 Ofertat dhe dokumentet të dorëzohen në zarf të mbyllur me shenjë "mos hap" dhe me shenjë "për shpallje për dhënie me qira të pronës së patundshme" dhe numri i shpalljes. Dokumentet e nevojshme dorëzohen përmes postës në adresën rr. "Llazo Trpovski" pn, ose në arkivin e shkollës deri sa të zgjasë shpallja prej ora 09:00 deri në ora 14:00.

- Koha e fillimit dhe kohëzgjatja e ankandit publik:** 5.3 Oferta e cila nuk përmban dokumentet e nevojshme do të konsiderohet si e pakompletuar dhe si e tillë nuk do të shqyrtohet
- Koha e fillimit dhe kohëzgjatja e ankandit publik:** 5.4 Dokumentet e dorëzuara në shpallje nuk do të kthehen.

- Koha e fillimit dhe kohëzgjatja e ankandit publik:** Ankandi publik do të fillojë më datë 24.08.2016 në ora 10, në lokala e shkollës në kohëzgjatje prej një orë.
- Kushtet për pjesëmarrje në shpallje dhe dokumentacioni i domosdoshëm:** Pjesëmarrësit në shpallje për ankandin publik me ofertën duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin në vijim
 - për subjektet juridike
 - dokument për veprimtari të regjistruar, jo më të vjetër se 6 muaj
 - vërtetimi për procedurë falimentimi, në original ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent
 - certifikatë për bilancin e gjendjes dhe të dhënat për bilancin e suksesit, në original ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent
 - certifikatë për tatime dhe kontribute të paguara, në original ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent
 - për subjekte fizike
 - numri i llogarisë transaksionale
 - fletëpagesë për depozitë të paguar

- Depozitë** 8.1 Depozita për pjesëmarrje në ankandin publik është 5% nga çmimi i përgjithshëm fillestar për tërë sipërfaqen, në euro në kundërvlerë denarë sipas kursit mesatar të BPRM, i cili duhet të paguhet në ditën e përfundimit të llogarisë 785010400678716, shifra e të hyrave 723019, programi H2

- Pagesa e realizuar pas kalimit të afatit llogaritet si e vonuar dhe personat që kanë realizuar pagesë të vonuar në pajtim me afatin e caktuar nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankandin publik.**
- Depozita e ofertuesve të cilat nuk kanë marrë statusin e ofertuesit më të volitshëm do të kthehet në tërësi në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa depozita e ofertuesit më të volitshëm i kthehet i zvogëluar prej 10% në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës të qirasë së parë.**

- Mënyra e realizimit të ankandit dhe zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm:** 9.1 Ankandi publik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik i cili plotëson kushtet e theksuara në shpallje dhe e ofron çmimin fillestar.

- Pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin më të lartë merr statusin ofertues më të volitshëm**
- Komisioni pas ankandit të realizuar publik cakton ofertuesin më të volitshëm dhe propozimin e dorëzon deri tek drejtori i shkollës.**
- Kohëzgjatja e qirasë.** 10.1 Hapësira jepet me qira për periudhë prej 1 vit.

- Marrëveshja me ofertuesin më të volitshëm nënshkruhet në afat prej 5 ditëve pas pëlqimit të marrë nga Kryetari i Qytetit të Shkupit.**
- Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk lidhë marrëveshje, depozita e paguar nuk i kthehet.**
- Qiramarrësi është i obliguar që në llogari të tij të sigurojë të gjitha pëlqimet e nevojshme – lejet nga ana e organeve kompetente.**
- Qiramarrësi është i obliguar në realizimin e veprimtarisë së tij të mos pengojë funksionin, ecurinë dhe kualitetin e veprimtarisë edukativo-arsimore në shkollë.**

- Shpenzimet për mirëmbajtjen e vazhdueshme të hapësirës afariste nuk futen në qira gjegjësisht të njëjtat bien mbi barrën e qiramarrësit.**
- Qiramarrësi është i obliguar që të paguajë depozitë prej 500 euro në kundërvlerë denarë për mbulimin e dëmit të supozuar që mund të shkaktohet gjatë përdorimit të hapësirës në afat prej tre ditëve të punës nga dita e lidhjes së marrëveshjes dhe i njëjti do të kthehet tërësisht në afat prej 15 ditëve pas kalimit të marrëveshjes.**

SHQSH "Zef Lush Marku" – Shkup

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të caktuar me kohëzgjatje për 1 vit në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë, publikon shpallje për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të caktuar për pozitën në vijim

1. Nëpunës i pavarur profesional, dy (2) realizues

Kandidatët duhet të përbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë (për të gjithë kandidatët):
Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
Në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
Të jetë i moshës së rritur;
Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë.
Për të dyja vendet e punës me numër rendor 1 dhe 2 (një dhe dy)
Përgatitje sipërore profesionale PSP, shkalla 7/1, fakulteti filozofik drejtimi punë sociale dhe politikë sociale pa përvojë pune.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorjnë dëshmitë për përbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të gjitha pozitat e punës, duhet të parashtrorjnë dokumentet në vijim:
Dëshmi të shtetësisë;
Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
Dëshmi për njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht); (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME NË PAJTIM ME SISTEMATIZIMIN);
Biografi të shkurtë;
Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23.176,00 denarë

Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të caktuar.

Punësimi është me kohëzgjatje prej 1 një viti.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrorhet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë, ose përmes postës në adresën në vijim:
rr. "Aco Axhi Iliov" pn, Negotinë
(me shenjë "për shpallje"): nr. 03-410/3.
Personi për kontakt: U. D Drejtor Zhivko Angeleski
Kontakt telefoni: 071/249 762

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë
u. d Drejtor
Zhivko Angeleski

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strumicë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.07.2017 në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strumicë

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strumicë publikon shpallje për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të caktuar për pozitat në vijim

- Psikolog – 1 (një) realizues**
- Punëtor i diplomuar social – 1 (një) realizues**

Kandidatët duhet të përbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strumicë (për të gjithë kandidatët):
-Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
-Në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
-Të jetë i moshës së rritur;
-Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
-Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strumicë:

Për vendin e punës me numër rendor 1 (një):
-Për nivelin A5 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti filozofik drejtimi psikologji dhe së paku dy vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale.
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Aptsis; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Për vendin e punës me numër rendor 2 (dy):
- Për nivelin A6 180 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti filozofik drejtimi Punë sociale dhe politikë sociale dhe pa ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale.
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Aptsis; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorjnë dëshmitë për përbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter. Kandidatët për të gjitha pozitat e punës, duhet të parashtrorjnë dokumentet në vijim:
-Dëshmi të shtetësisë jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
-Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
-Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
-Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
-Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
Dëshmi për njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Aptsis; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.
Biografi të shkurtë;

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30. Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23.181,00 denarë. Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të caktuar. Punësimi është në kohëzgjatje deri më 31.12.2017. Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përbushin në momentin e paraqitjes. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrorhet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strumicë, ose përmes postës në adresën në vijim: rr. Leninova nr. 84, Strumicë (me shenjë "për shpallje") Personi për kontakt Zoran Manev Kontakt telefoni 075/377-798 Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strumicë

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 1 (një) realizuesi për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.12.2017 në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole publikon shpallje për punësim të 1 (një) realizuesi për kohë të caktuar për pozitën në vijim

1.Punëtor i diplomuar social 1 (një) realizues

Kandidatët duhet të përbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole:
-Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
-Në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
-Të jetë i moshës së rritur;
-Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
-Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole nr. 01-454 të datës 15.05.2015. Për vendin e punës punëtor i diplomuar social duhet të ketë -240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit, fakulteti filozofik drejtimi punë sociale dhe politikë sociale, me së paku 2 vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale. -Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, -Njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Aptsis; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete. Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorjnë dëshmitë për përbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët duhet të parashtrorjnë dokumentet në vijim:
-Dëshmi të shtetësisë;
-Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
-Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit.
-Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
-Dëshmi për njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
-Biografi të shkurtë;
-Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23,181,00 denarë

Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të caktuar deri më 31.12.2017.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrorhet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole, ose përmes postës në adresën në vijim: rr. Velko Vllahoviq nr. 38 a Sveti Nikole (me shenjë "për shpallje") nr. 04-681/4. Personi për kontakt Melita Stojkova Kontakt telefoni 072 210 995

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Sveti Nikole



Konstituohet Parlamenti në Kosovë

Megjithatë, seanca në fjalë është shtyrë për sot (e premte) për në orën 10:00 nga kryesuesi i Kuvendit, Adem Mikullovc

Seanca konstituive e kuvendit të Kosovës ka rinisur në orën 15.00 pasi u ndërpre më herët nga drejtuesi i saj, deputeti më i vjetër Adem Mikullovc. Megjithatë, seanca në fjalë është shtyrë për sot (e premte) për në orën 10:00 nga kryesuesi i Kuvendit, Adem Mikullovc. Pas dramës së krijuar që nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit, më në fund u vendos që nesër, të premten, do të vazhdojë seanca e ndërprerë. Para disa minutash, nënkryetari i PDK'së, Enver Hoxhaj ka konfirmuar se PAN nuk merr pjesë në vazhdimin e seancës që u thirr për në orën 15:00, raporton Express. Arsyja e kësaj, Hoxhaj tha se deputetët e PAN nuk gjenden në Kuvend, pasi kryesuesi i seancës Adem Mikullovc, e përmbylli seancën e kaluar në mënyrë arbitrare. Ndërprerja u bë pasi koalicioni PAN që fitoi zgjedhjet kërkoi 2 orë kohë shtesë për konsultime për emrin e kandidatit për kryetar të Kuvendit. Shtyrja e seancës së parë të kuvendit, u vendos nga deputeti Mikullovc pavarësisht se në votimin e kryer paraprakisht, 60 deputetë votuan kundër shtyrjes së kërkuar nga koalicioni PAN, i përbërë nga Partia demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma. Mediat në Kosovë raportojnë se edhe pas konsultimeve Kadri Veseli mbetet kandidati i vetëm për kryeparlamentar nga koalicioni PAN, zgjedhja e të cilit është edhe qëllimi kryesor i seancës së sotme. Parlamenti i ri i Kosovës pritet gjithashtu që të votojë për zgjedhjen e kryesisë së tij. Analistët politikë mendojnë se problemet që legjislativi i ri has që në seancën e parë tregojnë për vështirësitë që ai do të ketë në vazhdim.



Gati për ditë ka sulme kundër të huajve në Poloni. Opozita ia hedh fajin populistëve të djathtë në pushtet. Qeveria distancohet rrallë nga sulmet raciste

Muslimanët nuk kanë vend në Poloni!

Ndodhi në mes të ditës, në qendër të Varshavës: "Mbathja nga Polonia!" thirri një burrë dhe i vuri një pistoletë në kurriz një vietnamezi. Sulmi ksenofob i javës së kaluar përfundoi pa pasoja serioze. Bëhej fjalë vetëm për një pistoletë frikësuese, bëri të ditur policia. Vietnamezi shpëtoi vetëm duke u frikësuar, sulmuesin e pret një proces gjyqësor. Të huajt poshtëroheshin dhe rriheshin rrallë më parë në Poloni, por tani këto raste janë shtuar në mënyrë alarmante. Ka pasur madje kërcënime me vdekje me sfond ksenofob, si në rastin e një imami në metropolin ekonomik polak të Poznanit. Youssef Chadid ka që në vitin 1996 pasaportë polake, ai është Kryetar i Këshillit të Ligës Myslimane në Poloni. Por kjo nuk e mbron nga emaillet kërcënuese dhe nga telefonatat. "Duan të më heqin

qafe dhe prandaj më kërcënojnë ditën dhe natën", ankohe Chadid. Ai madje mendon që të shpërngulet në një vend tjetër, po të vazhdojë kjo gjendje. Në mediat kritike ndaj qeverisë u raportua edhe për rastin e një nxënëseje myslimane nga Berlina, të cilën e pështrinë gjatë një udhëtimi me klasën në Lublin të Polonisë lindore. Ajo tregoi se policët polakë vetëm patën qeshur, kur ajo u kërkoi ndihmë. Edhe një patrullë e dytë policore e pati banalizuar këtë rast. Vetëm pas një proteste të Ombudsmanit të qytetarëve, Adam Bodnar, prokuroria nisi një procedurë hetimore: në të nuk bëhet fjalë vetëm për sulmin në vetvete, por edhe për pasivitetin e policisë. Atmosfera kundër të huajve po keqësohet. Disa sulme madje drejtohen edhe kundër polakëve,

të cilët i kujtojnë për arabë, për shkak të "pamjes së tyre si evropianojugorë", bën të ditur qendra e pavarur e monitorimit për sjellje raciste dhe ksenofobe. "Në përgjithësi vërejmë një rritje të madhe të sulmeve kundër të huajve - si përsa i përket numrit të tyre, ashtu edhe shkallës së tyre", deklaroi Konrad Dulkovski, nga Qendra e Monitorimit të Ksenofobisë. Dulkovski sheh këtu një lidhje të qartë me ardhjen në pushtet të PiS një vit e gjysmë më parë. Sot te kjo qendër mbërrin çdo ditë 30-100 emaile me ankesa. Edhe statistikat e policisë së Polonisë nxjerrin në pah një pamje shqetësuese. Kështu, numri i veprave penale me motive raciste ose ksenofobe është gjashtëfishuar që prej vitit 2010. Në vitin 2016 madje zyrtarisht pati mbi 700 vepra penale të tilla.

Politikanë të PiS në pushtet sot, në fushatën elektorale madje e ushqyen frikën kundër emigrantëve nga Lindja e Mesme dhe nga Afrika. Shefi i partisë, Kaczynski madje ushqeu frikë për epidemi si kolera, që do të sillnin refugjatët me vete dhe paralajmëroi për rrezikun e sulmeve ndaj grave polake. Kandidatët kryesorë të PiS e quajtën fenë islame "një rrezik kryesor", duke vendosur një lidhje direkte midis valës së refugjatëve dhe atentateve terroriste në Paris dhe në Bruksel. Kjo ka çuar në pasiguri tek qytetarët. Por në bazë të të dhënave të Zyrës Qendrore të të Huajve, numri i lutjeve për lejeqëndrim në Poloni, është rritur me 86 për qind që prej vitit 2015. Para së gjithash ukrainasit, indianët, kinezët dhe vietnamezët duan të vendosen në Poloni.

Çfarë do të bëhet me mijëra transgjiorët e ushtrisë amerikane?

Rreth 10.700 transgjiorë vlerësohet se shërbejnë në ushtrinë amerikane, e cila ka 1.4 milionë anëtarë. Ekspertët llogarisin se 134 mijë të tjerë janë veteranë transgjiorë

ekspertët ushtarakë dhe se vendimi i tij ka për qëllim të shmangë "shpenzimet e jashtëzakonshme mjekësore dhe përçarjen" që mund të shkaktojë prania e transgjiorëve në ushtri. Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders, tha se administrata do të punojë me Pentagonin për të vendosur se si të vazhdohet tutje. Ajo tha se vendimi i presidentit është ushtarak.



Shtëpia e Bardhë nuk ka vendosur ende se si do të zbatohet vendimi i presidentit Donald Trump për t'iu ndaluar njerëzve transgjiorë të shërbejnë në ushtrinë amerikane. Njoftimi i befasishëm i Trumpit, të mërkurën në Twitter, është kritikuar nga grupet e të drejtave të njeriut dhe ka shkakuar protesta në disa qytete të SHBA-së. Presidenti ka thënë se ka konsultuar

"Presidenti ka shumë mbështetje për të gjithë amerikanët dhe dëshiron t'i mbrojë ata në çdo kohë", tha Sanders, por shtoi se politika e shërbimit të transgjiorëve në ushtri "është shumë e shtrenjtë". Vendimi për t'iu lejuar transgjiorëve të shërbejnë hapur në ushtrinë amerikane është marrë nga ish-presidenti Barack Obama vitin e

kaluar. Republikanët që kanë lobuar kundër kësaj çështjeje tek administrata Trump, thonë se kanë kërkuar vetëm ndalimin e pagesave për shërbimet mjekësore që lidhen me konfirmimin gjinor dhe jo pengimin e plotë të transgjiorëve nga shërbimi në ushtri.

Republikanët konservatorë kanë propozuar një amendament në Ligjin për mbrojtje që do t'i mundë-

sonte Penagonit të mos paguajë për operacionet e transgjiorëve dhe terapinë e hormoneve. Disa media amerikane, megjithatë, e kanë vënë në dyshim justifikimin për shpenzime. Gazeta Washington Post ka tërhequr vëmendjen te një analizë që tregon se ushtria amerikane shpenzon gati 42 milionë dollarë në vit në medikamentet për mosfunksionim efektiv, që

do të thotë disa herë më shumë se kostoja e vlerësuar për mbështetjen mjekësore të transgjiorëve. Nuk është ende e qartë se si do të ndikojë vendimi te transgjiorët aktualë në ushtri. E pyetur nëse trupat në fushëbeteja do të kthehen menjëherë në shtëpi, zëdhënësja Sanders tha se politika nuk është përpunuar ende. Trump ka thënë se vendimi i tij bazohet në konsultimet me gjeneralët e tij, por reagimet kanë qenë të përziera. Ish-sekretari amerikan i Mbrojtjes, Ash Carter, i cili ka hequr ndalimin për transgjiorët vitin e kaluar, tha se "të zgjedhësh anëtarët shërbyes në baza të tjera, jashtë kualifikimit ushtarak, është politikë sociale" dhe se ajo nuk ka vend në ushtrinë amerikane. Kreu i

Komitetit të Senatit për Shërbime të Armatosura, republikani John McCain, tha se njoftimet e mëdha nuk duhet të bëhen përmes Twitterit.

"Çdo amerikan që i plotëson standardet aktuale mjekësore dhe ka gatishmërinë, duhet të lejohet të shërbejë", tha McCain. Duke folur për agjencinë Reuters, Jennifer Long, veterane transgjiorë, tha se "është e tronditur" me vendimin e presidentit Trump. "Ishte krejtësisht e papritur. Nuk mendoj se dikush në komunitetin tonë e ka pritur një mesazh të tillë", tha Long, e cila ka shërbyer në ushtri për 29 vjet. Rreth 10.700 transgjiorë vlerësohet se shërbejnë në ushtrinë amerikane, e cila ka 1.4 milionë anëtarë. Ekspertët llogarisin se 134 mijë të tjerë janë veteranë transgjiorë.



UNIVERSITETI NËNË TEREZA
УНИВЕРЗИТЕТ МАЈКА ТЕРЕЗА
MOTHER TERESA UNIVERSITY

KONKURS PËR PUNËSIM NË UNIVERSITETIN "NËNË TEREZA" NË SHKUP

Në bazë të nenit 22 paragrafi (1) pika 1, nenit 23, nenit 24, nenit 25, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/15 dhe 27/2016) Universiteti "Nënë Tereza" shpall

KONKURS PUBLIK

për punësim të 19 (nëntëmbëdhjetë) personave në kohë të pacaktuar edhe atë:

1. UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT PËR PUNË TË PËRGJITHSHME DHE JURIDIKE - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave juridike;
- Së paku pesë vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, përkatësisht së paku tetë vite përvojë pune në profesion prej të cilave së paku tre vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B2 të CEFR, përkatësisht IELTS me 5-6 poenë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT së paku 500 pikë, TOEFEL CBT me së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Serifikat, Test DAF.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 36.558 denarë.

2. UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT PËR FINANCA, KONTABILITET, INVESTIME DHE ZHVILLIM - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave juridike, shkencave ekonomike dhe shkencave organizative dhe menaxhment;
- Së paku pesë vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, përkatësisht së paku tetë vite përvojë pune në profesion prej të cilave së paku tre vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B2 të CEFR, përkatësisht IELTS me 5-6 poenë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT së paku 500 pikë, TOEFEL CBT me së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Serifikat, Test DAF.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 36.558 denarë.

3. UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT PËR ARSIM DHE SHKENCË - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave shoqërore, shkencave matematiko - natyrore dhe shkencave tekniko - teknologjike;
- Së paku pesë vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, përkatësisht së paku tetë vite përvojë pune në profesion prej të cilave së paku tre vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B2 të CEFR, përkatësisht IELTS me 5-6 poenë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT së paku 500 pikë, TOEFEL CBT me së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Serifikat, Test DAF.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 36.558 denarë.

4. UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave juridike, shkencave politike dhe menaxhim dhe administrim publik;
- Së paku pesë vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, përkatësisht së paku tetë vite përvojë pune në profesion prej të cilave së paku tre vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B2 të CEFR, përkatësisht IELTS me 5-6 poenë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT së paku 500 pikë, TOEFEL CBT me së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Serifikat, Test DAF.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 36.558 denarë.

5. UDHËHEQËS I DEPARTAMENTIT PËR MËSIM TË PËRJETSHËM - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK-së (EKTS), ose

të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave juridike, shkenca e letërsisë, shkenca e gjuhës, ose edukim;

- Së paku pesë vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, përkatësisht së paku tetë vite përvojë pune në profesion prej të cilave së paku tre vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B2 të CEFR, përkatësisht IELTS me 5-6 poenë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT së paku 500 pikë, TOEFEL CBT me së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Serifikat, Test DAF.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 36.558 denarë.

6. UDHËHEQËS I NJËSISË PËR E - INDEKS - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas SETK-së (EKTS-së), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e teknikës kompjuterike dhe informatikës, elektroteknikës ose informatikës;
- Së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B1 të CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 - 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT me së paku 450 pikë, TOEFEL CBT me së paku 135 pikë, ose TOEFEL IBT me së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose GETE Serifikat.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 28.778 denarë.

7. UDHËHEQËS I NJËSISË PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas SETK-së (EKTS-së), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencës së gjuhës (lingistikë), menaxhim dhe administrim public ose shkenca politike;
- Së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B1 të CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 - 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT me së paku 450 pikë, TOEFEL CBT me së paku 135 pikë, ose TOEFEL IBT me së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose GETE Serifikat.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 28.778 denarë.

8. UDHËHEQËS I NJËSISË PËR FURNIZIME PUBLIKE - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e menaxhimit dhe administrimit public, shkencave juridike ose shkencave ekonomike;
- Së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B1 të CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 - 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT me së paku 450 pikë, TOEFEL CBT me së paku 135 pikë, ose TOEFEL IBT me së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose GETE Serifikat;
- Vërtetim për provimin e dhënë për person për furnizime publike.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 28.778 denarë.

9. UDHËHEQËS I NJËSISË PËR MENAXHIM ME BURIMET NJERËZORE - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave organizative dhe menaxhmentit, shkencave juridike ose shkencave politike;
- Së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;

- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B1 të CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 - 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT me së paku 450 pikë, TOEFEL CBT me së paku 135 pikë, ose TOEFEL IBT me së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose GETE Serifikat;

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 28.778 denarë.

10. UDHËHEQËS I NJËSISË PËR PUNË TË PËRGJITHSHME DHE JURIDIKE - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave juridike;
- Së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit B1 të CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 - 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT me së paku 450 pikë, TOEFEL CBT me së paku 135 pikë, ose TOEFEL IBT me së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose GETE Serifikat;

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 28.778 denarë.

11. KËSHILLTAR PËR PUNË FINANCIARE, KONTABILISTE DHE MATERIALE - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave organizative dhe menaxhment;
- Së paku tre vjet përvojë pune në profesion;
- Njohje aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me maksimum 3 pikë, BULATS, APTIS, ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Serifikat.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 25.405 denarë.

12. KËSHILLTAR PËR PUNË METODIKE - KËSHILLTAR PËR PROTOKOL DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN - (1) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e informatikës, shkencave organizative dhe menaxhimit, shkencës për gjuhën (linguistikë);
- Së paku tre vjet përvojë pune në profesion;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me maksimum 3 pikë, BULATS, APTIS, ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Serifikat.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 25.405 denarë.

13. KËSHILLTAR PËR PUNË TË PËRGJITHSHME DHE NORMATIVO JURIDIKE - (1) përmbarues

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave juridike, shkencave organizative dhe menaxhmentit ose edukim;
- Së paku tre vjet përvojë pune në profesion;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar europian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve europian të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me maksimum 3 pikë, BULATS, APTIS, ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Serifikat.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 25.405 denarë.

14. KËSHILLTAR - LEKTOR I UNIVERSITETIT - (2) përmbarues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencës për gjuhën (linguistikë) ose shkencës për letërsinë;

- Së paku tre vjet përvojë pune në profesion;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar evropian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me maksimum 3 pikë, BULATS, APTIS, ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Sertifikat.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 25.405 denarë.

15. BASHKËPUNËTOR I LARTË PËR FURNIZIME PUBLIKE – (1) përmbaues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase për kualifikimet dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 nga fusha e shkencave ekonomike, shkencave juridike ose edukim;
- Së paku dy vite përvojë punë në profesion;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar evropian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me maksimum 3 pikë, BULATS, APTIS, ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Sertifikat;
- Vërtetim për provimin e dhënë për person për furnizime publike.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 23.590 denarë.

16. BASHKËPUNËTOR I LARTË PËR ÇËSHTJE STUDENTORE – (1) përmbaues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës maqedonase për kualifikimet dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 nga fusha e shkencës për gjuhën (linguistikë), informatikës, teknikës kompjuterike dhe informatikës ose shkencave organizative dhe menaxhimit;
- Së paku dy vite përvojë punë në profesion;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar evropian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me maksimum 3 pikë, BULATS, APTIS, ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose GETE Sertifikat;

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 23.590 denarë.

17. KËSHILLTAR I REKTORIT – (1) përmbaues;
Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e informatikës, arkitekturës, urbanizmit dhe planifikimit ose stomatologjisë;
- Së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, përkatësisht së paku dhjetë vite përvojë pune në profesion prej të cilave tre vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar evropian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2 të CEFR, përkatësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK B, ILEK, IKFE, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT me së paku 500 pikë, TOEFEL CBT me së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF ose GETE Sertifikat, TestDAF.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 37.596 denarë.

18. AUDITOR KRYESOR I BRENDSHËM – (1) përmbaues;
Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e shkencave ekonomike ose shkencave organizative dhe menaxhimentit;
- Së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin publik, përkatësisht së paku dhjetë vite përvojë pune në profesion prej të cilave tre vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Europian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar evropian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2 të CEFR, përkatësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK B, ILEK, IKFE, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT me së paku 500 pikë, TOEFEL CBT me së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë ose DELF, TCF, TEF ose GETE Sertifikat, TestDAF;
- Dëshmi për provimin e dhënë për auditor zyrtar i brendshëm ose Sertifikat të pranuar ndërkombëtarisht për auditor.

Shuma neto e pagës bazë do të arrin deri 37.596 denarë.

Kandidatët përveç kushteve të lartpërmendura, duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë
- Në mënyrë aktive ta njeh(përdorë) gjuhën maqedonase;
- Të jenë të moshës madhore;

- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me vendim nga gjykata se nuk ka të shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për të aplikuar.

Kandidatët së bashku me fletëaplikimin duhet të dorëzojnë edhe dëshmitë se i plotësojnë kushtet, në formë origjinale ose të vërtetuara nga noteri, edhe atë:

1. Dëshmi mbi shtetësinë e Republikës së Maqedonisë
2. Dëshmi e shëndetit të përgjithshëm për vendin e punës
3. Vërtetim nga gjykata se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
4. Certifikata / Diploma për nivelin e kryer arsimor në përputhje me kërkesat në konkurs;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës;
6. Dëshmi për kryerje të punëve në nivel udhëheqës (vetëm për pozitë udhëheqëse – numrat rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,17 dhe 18);
7. Dëshmi për njohje të gjuhëve të huaja në përputhje me kërkesat në konkurs;
8. Për vendet e punës me numrat rendor 08 dhe 15 – Vërtetim për provimin e dhënë për person për furnizime publike;
9. Për vendin e punës me numër rendor 18, Dëshmi për dhënien e provimit për auditor i brendshëm zyrtar ose Certifikatë të pranuar ndërkombëtare për auditor.

Orari i punës: 40 orë në javë, prej 08:30 deri 16:30 gjatë ditëve të javës, nga e hëna deri të premtën.

Me kandidatin e përzgjedhur do të firmoset kontrata e punës me kohëzgjatje të pacaktuar.

Afati për dorëzimin e fletëaplikimeve me dokumentet e kërkuara do të zgjasë 10 ditë pune nga dita pas shpalljes së konkursit (duke përfshirë ditën e shpalljes).

Kushtet e përcaktuara në konkurs, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Nëse në konkurs paraqiten 200 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 45 ditëve, nga 201 deri në 500 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 90 ditëve dhe më shumë se 500 kandidatë, zgjedhja duhet të bëhet brenda 120 ditëve, pas afatit për aplikim.

Fletëaplikimet me dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, në rrugën 12 Udarina Brigada 2a / katin e 7-të, me shënimin "konkurs për punësim në Universitet."

Fletëaplikimet jo të plota dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të merren parasysh.

Afati i fundit për aplikim: _____.

Kontakt personi: Bujar Kajolli, mob. 072/651-970

Me respect,
U.D. REKTORI,
prof. dr. Aziz Pollozhani



UNIVERSITETI NËNË TEREZA
УНИВЕРЗИТЕТ МАЈКА ТЕРЕЗА
MOTHER TERESA UNIVERSITY

KONKURS PËR PUNËSIM NË UNIVERSITETIN "NËNË TEREZA" NË SHKUP

Në bazë të nenit 22 paragrafi (1) pika 1, nenit 23, nenit 24, nenit 26 dhe nenit 27 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/15 dhe 27/2016) Universiteti "Nënë Tereza" shpall

KONKURS PUBLIK

për punësim të 1 (një) personi në kohë të pacaktuar edhe atë:

1. SEKRETAR GJENERAL I UNIVERSITETIT - (1) përmbaues;

Kandidatët për këtë vend pune duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas SETK-së (EKTS-së), ose të përfunduar shkallën VII/1 nga fusha e teknikës kompjuterike dhe informatikës, elektroteknikës ose informatikës;
- Së paku katër vjet përvojë pune në profesion prej të cilave së paku një vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku gjashtë vite përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vite në pozitë udhëheqëse në sektorin privat;
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (angleze, gjermane, frënge), edhe atë: përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatorizyrtar evropian, anëtare e shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B1 të CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 - 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS ose APTIS ose TOEFEL PBT me së paku 450 pikë, TOEFEL CBT me së paku 135 pikë, ose TOEFEL IBT me së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose GETE Certifikatë.

Shuma neto e pagës bazë arrin deri 47.454 denarë.

Kandidatët përveç kushteve të lartpërmendura, duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë
- Në mënyrë aktive ta njeh(përdorë) gjuhën maqedonase;
- Të jenë të moshës madhore;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me vendim nga gjykata se nuk ka të shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për të aplikuar.

Kandidatët së bashku me fletëaplikimin duhet të dorëzojnë edhe dëshmitë se i plotësojnë kushtet, në formë origjinale ose të vërtetuara nga noteri, edhe atë:

1. Dëshmi mbi shtetësinë e Republikës së Maqedonisë
2. Dëshmi e shëndetit të përgjithshëm për vendin e punës
3. Vërtetim nga gjykata se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
4. Certifikata / Diploma për nivelin e kryer arsimor në përputhje me kërkesat në konkurs;
5. Dëshmi mbi përvojën e punës;
6. Dëshmi për njohje të gjuhëve të huaja në përputhje me kërkesat në konkurs;

Orari i punës: 40 orë në javë, prej 08:30 deri 16:30 gjatë ditëve të javës, nga e hëna deri të premtën.

Me kandidatin e përzgjedhur do të firmoset kontrata e punës me kohëzgjatje të pacaktuar.

Afati për dorëzimin e fletëaplikimeve me dokumentet e kërkuara do të zgjasë 10 ditë pune nga dita pas shpalljes së konkursit (duke përfshirë ditën e shpalljes).

Kushtet e përcaktuara në konkurs, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Nëse në konkurs paraqiten 200 kandidatë, zgjedhja do të bëhet brenda 45 ditëve, nga 201 deri në 500 kandidatë, zgjedhja duhet të bëhet brenda 90 ditëve dhe më shumë se 500 kandidatë, zgjedhja duhet të bëhet brenda 120 ditëve, pas afatit për aplikim.

Fletëaplikimet me dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, në rrugën 12 Udarina Brigada 2a / katin e 7-të, me shënimin "konkurs për punësim në Universitet."

Fletëaplikimet jo të plota dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të merren parasysh.

Afati i fundit për aplikim: _____.

Me respect,
U.D. REKTORI,
prof. dr. Aziz Pollozhani



Një grup i vogël artizanësh në qytetin e Prizrenit në Kosovë po përpunon të mbajnë gjallë një traditë shekullore të bizhuterive të filigranit të bëra me dorë, duke e trashëguar atë nga babai tek i biri.

Die MORINA

I mbledhur në një cep të dyqanit të tij në qytetin jugor të Prizrenit, një burrë trupvogël me flokë gri merr një copë të vogël argjendi dhe e kthen atë në një fije të hollë e të përdredhur. Pastaj ai e kombinon atë me fije të vogla metali dhe rruaza, duke përdorur një tub për t'i dhënë metalit forma të ndryshme. Ato më vonë do të bëhen një gjerdan, shpjegon ai. Nrec Gjini, 49 vjeç, e trashëgoi këtë zanat të lashtë nga babai i tij, i cili e trashëgoi atë nga babai i tij.

Ai s'e ka menduar kurrë të ndryshojë ndonjë gjë për mënyrën se si ai punon, edhe pse shpesh ka qenë e vështirë dhe teknologjia moderne do t'i kishte bërë më të lehta të gjitha. Atje, në punishten e tij të vogël, në një qoshe, ai është vetëm dhe i lumtur me argjendin.

"Ne punojmë me fije të përdredhura argjendi," thotë Gjini. Jo të gjithë mund ta mjeshtërojnë si duhet këtë art, vëren ai, duke shpjeguar se përveç talentit artistik, kjo punë kërkon saktësi absolute, pasi motivet dhe detajet e argjendit janë shumë të vogla.

Gjini është një nga argjendarët e paktë që kanë mbetur në Prizren të cilët ende e njohin dhe praktikojnë artin e filigranit, një lloj bizhuterie tepër delikate që bëhet me fije në formë fjongosh, rruaza të vogla dhe fije të përdredhura. Arti mbetet tepër i njohur në Azi, sidomos në Indi, por edhe në Afrikën e Veriut – por është i rrallë në Europën moderne.

Ky zanat i ka dhënë shumë famë Prizrenit gjatë shekujve. Nuk ka një datë të saktë se kur shqiptarët në Kosovë filluan të punojnë me argjend, por historianët thonë se kjo ndodhi ndoshta dikur në shekullin e 18-të.

Prizreni u bë qendra kryesore për argjendarët, por kishte artizanë të famshëm edhe në Pejë, Gjakovë dhe Prishtinë, ku argjendarët i trashëgonin me kujdes sekretet nga babai tek djali. Tregtia s'e pati origjinën në Kosovë, por kjo e fundit ishte e famshme sidomos për artizanët e saj, tha për BIRN etnografi Bekim Xhemili.

"Ndërsa teknika e filigranit u trashëgova gjatë shekujve, artizanët filluan të punonin me baballarët e tyre që në moshë shumë e re, gjë që i bëri ata përfeksionistë. Kjo i bëri teknikën, stilin dhe motivet e tyre unike," shtoi Xhemili.

Dikur, Kosova kishte minierat e saj të argjendit në Trepçë dhe Novobërdë dhe argjendarët kishin shumë material të papërpunuar për të punuar. Por në Kosovë nuk nxirret më argjend, kështu që artizanët e mbetur duhet ta



importojnë atë, duke bërë që mezi të mbulojnë shpenzimet e tyre.

Tregtia po vdes. Xhemili thotë se shteti i Kosovës duhet t'i mbështesë ata artizanët e vegjël që ende përpunon të mbajnë gjallë traditën.

Ai thekson se arti është përfshirë në një listë perkohësisht të mbrojtur, ku përfshihen 1,543 asete trashëgimie kulturore. Ai është nën një mbrojtje të tillë për një vit.

Në vitet 1980, tregtia e filigranit lulëzoi. Në atë kohë në Prizren kishte 150 deri në 200 artizanë.

Familja e Gjinit ishte ndër ta. Ata punonin shumë, por gjithashtu

Zanati i lashtë kosovar

Artizanët prizrenas të filigranit

gjallë profesionin e familjes së tij.

"Ne e kemi trashëguar këtë për shekuj me radhë, gjë që më bën të ndihem mirë ndërsa punoj. Dua ta vazhdoj këtë traditë," këmbëngul ai.

"Nuk mendoj se ka ndonjë artizan tjetër të moshës sime në Prizren. Nëse do të kishte një, padyshim që do ta njihnim njëri-tjetrin," thekson ai.

Gjatë viteve të vështira të viteve 1990 për artizanët filigranë, ata ishin të detyruar të tregtonin bizhuteri të tjera argjendi dhe ari, duke importuar mallra nga vende si Turqia, Italia dhe vende të tjera.

Në ditët e sotme një gramë filigran kushton midis 4-5 euro, gjë që e bën të vështirë për një familje artizani të mbijetojë vetëm nga kjo punë, kështu që ata ende shesin bizhuteri të tjera ari dhe argjendi të eksportuara nga vende të tjera.

Klientët më të interesuar për filigranin në Prizren janë turistët, kryesisht të prezantuar me të nga guidat që e prezantojnë këtë punim argjendi si pjesë të identitetit të qytetit. Por, Nrec Gjini thotë se së fundmi njerëz nga Kosova po interesohen gjithashtu gjithnjë e më shumë për bizhuteritë e filigranit. Nuk mund të krahasohet ende me vitet 1980, por ai shpreson se gjërat do të përmirësohen.

"Së fundmi kemi pasur kliente që do dëshironin të vendosnin bizhuteri filigrani në ditën e tyre të dasmës," thotë ai plot shpresë, duke kujtuar se si babai i tij bënte unaza martesë.



Festivali këtë vit do të mbahet nga data 4 gusht deri më 12 gusht, dhe është i hapur për të gjithë dashamirët e filmit dhe muzikës. Nga 230 filma të cilët do të prezantohen, në kategori garuese do të marrin pjesë 102 filma

Festivali DokuFest, sivjet mbahet për të gjashtëmbëdhjetën herë me radhë. Drejtoresha e Festivalit Nita Deda thotë se DokuFest këtë vit ka në fokus temën e së ardhmes dhe se këtë vit do të jetë një program i ngjeshur i cili i përshtatet të gjitha moshave, që marrin pjesë në festival. Ajo tha se 230 filma do të prezantohen, ndërsa në kategori garuese janë 102 filma.

"Ne jemi gati për edicionin e këtij DokuFesti, i cili si fokus e ka temën e të ardhmes dhe ka një program shumë të gjerë që përfshin shfaqjen e mbi 230 filmave të cilët janë përzgjedhur prej mijëra fil-

Nis edicioni i 16-të i DokuFest

Shfaqjen mbi 230 filma



mave që kanë aplikuar me qenë pjesë e DokuFest, koncertet e muzikës që mbahen në parkun e Marashit edhe në Kalanë e qytetit, Festivalin e fëmijëve, i cili sivjet shënohet me shfaqjen e filmave për fëmijë, dhe po ashtu punëtori të ndryshme, dhe një ekspozitë shumë të veçan-

lari, bëri të ditur se këtë vit në festival do të jenë mysafir dy filmbërës të famshëm nga bota, dhe se kjo është hera e parë që ata vijnë në DokuFest.

të në bashkëpunim me institucionin 'Marubi', tha ajo. Deda gjithashtu ka shpalosur edhe programin muzikor që do të mbahet në festival, dhe ajo bëri të ditur që këtë vit do të mbahen koncerte filharmonike në festival.

Drejtori artistik i DokuFest, Veton Nurkol-

Smith, me afro 20 filma, që është retrospektiva e John Smithit. Smith do të jetë mysafir dhe do të ligjërojë në Master Class. Po ashtu për herë të parë kemi edhe retrospektivën më të madhe të një prej filmbërësve meqë interesant amerikanë Travis Smitherson që do ta ketë në DokuFest, asnjëherë nuk e ka pas as në Evropë, e as në Amerikë, u shpreh ai. Me këtë rast, Eroll Bilibani, tha se këtë vit, fal suksesit të filmave të vitit të kaluar, interesimi për shkollën e filmit "E ardhmja është këtu" është rritur shumë. Ai tha se pjesë e kësaj shkolle janë edhe nxënësit nga rajoni, si nga Shqipëria dhe Serbia, ndërsa shtoi se në kinemanë "Lumi", të interesuarit do të mund t'i

shohin filmat e tyre.

Unë dua të potencoj një fakt me të cilin të gjithë ne jemi shumë krenar që shkolla jonë e filmit e cila është themeluar para pesë vitesh dhe jo rastësisht e kemi quajtur 'E ardhmja është këtu', e cila këtë vit shkon edhe me temën e festivalit. Kemi pasur një interesim të jashtëzakonshëm, falë suksesit të filmave vitin të kaluar, të cilat kanë shkuar në mëse 27 festivale pothuajse në tërë globin. Këtë vit kemi pasur një interesim të jashtëzakonshëm për pjesëmarrje dhe në fund 8 pjesëmarrës të udhëhequr nga tutorët e tyre, kanë arritur t'i realizojnë filmat e tyre dhe do ta kenë premierën e tyre në DokuFest", tha ai.

Festivali këtë vit do të mbahet nga data 4 gusht deri më 12 gusht, dhe është i hapur për të gjithë dashamirët e filmit dhe muzikës. Nga 230 filma të cilët do të prezantohen, në kategori garuese do të marrin pjesë 102 filma.



Keidi Bare, një yll botëror!

Gol ndaj Liverpoolit dhe paraqitje fantastike në "Audi Cup", turneu në Gjermani. Me merkaton e bllokuar, Simeone do t'i japë shanset e tij. Panuçi mban shënim dhe fërkon duart



Që kur ishte fëmijë, ëndërra e tij e madhe ishte të luante në një stadium prestigjioz dhe me një ekip "big", tekta në Akademinë e Apolonisë, zakonisht s'është e ndaluar të fantazosh edhe për të ardhmen tënde. Kështu ishte për Roshin, që megjithatë fatin e tij e pati në Gjermani me skuadrën e Këlnit, ndërsa sot është pikë kyçe e kombëtares. Atë kombëtare të madhe që po ndjek edhe Keidi Bare, tekta Kristian Panuçi nuk ia ndan sytë, aq sa edhe ditën e sotme e ka hapur tv në dy kanale... Për sfidën Legia Varshavë-Astana, ku u aktivizua Sadiku, por edhe në sfidën miqësore mes Atletiko Madridit dhe Liverpoolit, në Gjermani. Aty ku, çuditërisht, dy lojtarët që luajnë me dy klube të nivelit botëror (Bare-Atletiko dhe Hysaj-Napoli) sa i përket futbollistëve shqiptar.

Nga Fieri – Por, të ndalemi te fieraku, i cili më 26 dhjetor 2013 do të kalonte në Akademinë e skuadrës madrilene, aty ku edhe do të niste ngjitja e tij dhe formimi si futbollist. "Scout" të Atletikos e kishin parë dhe vendosën se fieraku shfaqte në këmbët e tij një të ardhme të madhe,

thjesht duhej "skalitur"... Detyrë jo e vështirë, për një klub që këto vitet e fundit ka prodhuar lojtarë të nivelit botëror: vetëm pak kohë më parë, Teo Hernandez kaloi te Real Madridi për gati 26 milionë euro... i rritur, edhe ai, në Akademinë "Rojas" të Atletikos. Por, fiksimi i Diego Pablo Simeones shkon deri aty saqë, kur ka kohë dhe s'ka impenjime me ekipin e parë, të shkojë të ndjekë edhe ndeshjet e Atletikos B, ashtu sikurse edhe bëri. Shënime për Baren dhe, më pas, thirrja në ekip të parë. Stërvitje me yjet, tekta fieraku nis të mësojë edhe sekretet e tyre. Forcohet fizikisht, duke shtuar masë muskulore. Sot, goli ndaj Liverpoolit me kokë është vetëm një "kartëvizitë", sepse Keidi sapo ka nisur të

na mrekullojë. Shumë shpejt, do ta kuptojmë se pse...

Besimi – Kohë më parë, "AS" i dedikoi një artikull talentit nga Fieri, duke u ndalur te faza përgatitore që ai po zhvillon nën urdhrat e Simeones dhe te ndeshjet miqësore. "Keidi Bare është një nga ata futbollistë që ka gjithçka që i pëlqen Simeones. Agresivitet, intenzitet, vrap, aftësi të rikuperojë topin dhe të bëjë trysni. Më 10 janar 2017 u bë nga Simeone futbollisti i parë shqiptar që vesh fanellën e Atletiko Madrid. Ishte kundër Las Palmas, në Kupë, me fanellën numër 44. Këtë verë, ai është një nga 5 lojtarët e akademisë që u zgjodh për të bërë fazën përgatitore në Segovia, por që u mor me vete edhe në Gjermani, në

"Audi Cup".

Shenja e fatit – Ishte pas një prej arritjeve të tij (debutimi në moshën 15-vjeçare në Kupën e Shqipërisë me Apoloninë e Fierit), kur Atletiko e bleu për ekipin e paraterinje të vitit të dytë. Por nuk e regjistroi në klub derisa të mbushte 18-vjeç, për të mos u përballur me probleme. Tani është thuhetse 20 vjeç, ka qenë pjesë e Kombëtares U-21 dhe në fazën përgatitore me ekipin e parë të Atletikos, ishte i dyti në testet fizike (pas Vrsajlko), si dhe shënoi një supergol në seancën e fundit të javës së parë, shkruan "As", duke vijuar... "Serioz, shumë serioz në punë. Dhe i përqendruar, shumë i përqendruar, edhe pse argëton me pasime. Është nga ato futbollistët e rrallë, mund të luajë si një numër 6 apo një numër 8. Por kur avancohet në pozicionin e tij, ia vështirëson lojën kundërshtarëve. I fortë fizikisht, di të mbulojë mirë edhe mbresa. I mbetet vetëm të përmirësojë aftësinë për të bashkëpunuar me të tjerët, por për këtë mjafton Simeone, i cili bën gjithmonë më të mirë çdo lojtar. Dhe ai nuk ia heq kurrë sytë akademisë. Nëse ndokush shkëlqen, ai i beson. Kaio nuk është këtë vit, Keidi po. Ai është një lojtar që dhuron shumë orë lojë, i cili është koherent edhe në mënyrën e mbajtjes së topit. Ai vazhdon të jetojë në konviktin e Atletiko Madrid, por ka një objektiv: të bëjë të mundur që familjarët e tij të vijnë të jetojnë në Spanjë, ëndërra e tij më e madhe".

Leverkuseni kërkon 10 mln euro për Mehmedin

Drejtuësit e skuadrës gjermane, Bajer Leverkusen, nuk do të lirojnë sulmuesin shqiptar, Admir Mehmedi, nëse nuk i marrin dhjetë milionë euro. Interesim për sulmuesin e përfaqësueses së Zvicrës ka shprehur klubi francez, Nica. "Trajneri i Nicas, zvicerani Lucien Favre, pëlqen mënyrën e lojës së Mehmedit dhe do të bëjë gjithçka që ta transferojë në ekip", shkruan "kicker.de" të mërkurën. Por, "Kicker" ka raportuar, po ashtu se Leverkuseni ia ka vënë çmimin lojtarit në vlerë dhjetë milionë euro. Sulmuesi Mehmedi nuk ka dashur të komentojë asgjë rreth interesimit të Nices. Ka theksuar se ende nuk ka asgjë konkrete. "Kam njerëz që përkujdesen për mua, por për sa kohë që nuk ka asgjë për t'u raportuar, nuk kam koment. Ka shumë spekulime rreth së ardhmes sime", ka thënë Mehmedi për "Kicker". Sulmuesi 26-vjeçar me skuadrën e Leverkusenis ka kontratë deri në verën e vitit 2019. Te Leverkuseni u transferua në verën e vitit 2015 nga klubi tjetër gjerman, Freiburg. Karrierë ka bërë edhe te Dinamo Kiev në Ukrainë dhe Cyrih në Zvicër.



Hadergjonaj akuzon Ingolshadtin se e ka prerë në besë

Kërkon transferimin në Shtutgart

Florent Hadergjonaj (23) kërkon me padurim transferimin drejt Shtutgartit. Për këtë ai ka probleme me klubin e tij të Ingolshadt, shruan "Bildplus". Klubi gjerman i Shtutgartit ka ofruar plot 4 milion euro për mbrojtësin e kombëtares helvete Florent Hadergjonaj (23). Vetë 23 vjeçari e ka konfirmuar për median gjermane se e ka lutur Ingolshadt për t'u transferuar. Bile ai akuzon për gënjeshtria ish klubin. "Kur unë verës së kaluar erdha nga Berni, kishte një marrëveshje gojore mes meje, ish drejtorit sportiv Thomas Linke dhe agentit tim, që vitin e parë nuk do kisha rritje të klauzolës në rast se largohesha. Zoti Linke më kishte premtuar se do gjenim gjithashtu një zgjidhje, nëse do vinte deri te ndonjë ofertë largimi. Nga kjo marrëveshje tani nuk kërkon askush të dëgjojë në FCI, kjo pasi zoti Linke më është premtuar më aty", tha Hadergjonaj. Në qershor Hadergjonaj debutoi me kombëtaren helvete gjatë ndeshjes kundër Bellorusisë. Megjithatë prezenca e tij në kombëtaren helvete vendoset në pikëpyetje nëse nuk arrin sukses në klubin e tij.



Partizani merr sulmuesin e kombëtares Edgar Çanin

Godet Partizani. Edgar Çani do të jetë pjesë e të kuqe kryeqytetas për dy vitet e ardhshme. Akordi është gjendur mes futbollistit në fjalë e menaxherit të vet dhe Luciano Moxhit. Ka qenë ky i fundit që e ka bindur ish-sulmuesin e kombëtares kuqezi, për t'u bërë pjesë e 15 herë kampioneve të Shqipërisë. Kështu, gjendet zgjidhja për

repartin e përpamë të "demave të kuq", që sezonin e kaluar kishte një "mbret", Kaleb Ekuban, i cili u largua kësaj vere për në Angli, te Lids Junajted. Trajneri Mark Juliano duhet të jetë i kënaqur me këtë përfundim, ashtu si me ardhjen e mesfushorit hungarez, që ka qenë pjesë e Liverpoolit, Kristian Adorian.



Historike, Kosova mposht Maqedoninë

Greenberg: Një fillim i shkëlqyeshëm, të mbetemi me këmbë në tokë

Historike. Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ka shënuar fitoren e parë zyrtare në histori, duke e mundur Maqedoninë 72-68 në ndeshjen hapëse të para-eliminatore për Botërorin Kina 2019. Rezultati në fund 72:68 me djemtë e Kosovës që lan shpirtin në parket gjatë gjithë takimit, duke bërë një paraqitje fantastike, sidomos në pjesën e parë. Në një ndeshje të zjarrtë në Pallatin e Rinisë në Prishtinë përfaqësuesja e Kosovës ka shënuar fitore historike, të parën në



ndeshjet kualifikuese, ndaj Maqedonisë në parakualifikimet për Botëror "Kina 2019". Me udhëheqjen fantastike të kapitenit, Dardan

Berisha, Kosova shënoi fitore ndaj fqinjit, Maqedonisë me rezultat 72-68. Çereku i parë iu takoi djelmohave të Brad Greenbergut, të cilët e mbyllën

atë me 12 pikë epërsi, 23-11. Kjo seri e mirë vazhdoi edhe në çerekun e dytë, të cilin Kosova e fitoi 17-9. Mysafirët u treguan më efikas në çerekun e tretë dhe të katërt, duke i fituar ato, 15-23 dhe 17-25. Dardan Berisha ishte ai që mori barrën e skuadrës, duke qenë fantastik në këtë përballje me 28 pikë, 6 kërcime e 4 asistime, përdërisa Granit e Fisnik Rugova shënuan së bashku 23 pikë, dhe në fund të ndeshjes 22 vjeçari, Leonard Mekaj ruajtë qetësinë duke shënuar

dy pikët e fundit. Më i miri në radhët e Maqedonisë ishte Jordan Theodore me 22 pikë dhe 6 asiste. Sfidën e radhës Kosova do ta ketë më 9 gusht ndaj Estonisë në Talinn, pastaj luan më 12 gusht ndaj Maqedonisë në Shkup në ndeshjen kthyesë, dhe e pret në shtëpi Estoninë më 19 gusht. Ndryshe, trajneri i përfaqësueses së Kosovës në basketboll, Brad Greenberg është ndarë shumë i kënaqur me performancën e lojtarëve të tij në fitoren ndaj Maqedonisë, por ka

kërkuar që "të mbetemi me këmbë në tokë". "Ky është një fillim i shkëlqyeshëm, por ne duhet të mbetemi me këmbë në tokë. Ishte një përvojë e veçantë për mua të shikoj Dardanin (Berisha) dhe mënyrën se si ai luajti. Ky ekip duhet të vazhdojë me këtë ritëm", ka thënë Greenberg për KTV. Ai më tutje ka shtuar se, "ne patëm një performancë të mirë në mbrojtje. Unë jam shumë i lumtur dhe krenar për të gjithë. Kjo do të jetë një natë e veçantë".

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 të Ligjit për punonjësit e sektorit publik ("Gazeta Zyrtare" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligji i punës ("Gazeta zyrtare" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11 / 12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 27/16 dhe 129/15), Institucioni publik qendra për punë sociale Tetovë ,shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të një (1) realizuesi në kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.12.2017 në IP Qendra për punë sociale në Tetovë

Institucioni publik qendra për punë sociale në Tetovë, publikon shpallje për punësim të një (1) realizuesi të detyrës pedagog i diplomuar në një kohë të caktuar në pozitat në vijim

1. Pedagog i diplomuar (1) një realizues

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme dhe kushtet e përcaktuara me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IP Qendrën për Punë Sociale Tetovë (për të gjithë kandidatët):

të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;

në mënyrë aktive te përdor gjuhën maqedonase;

të jetë në moshë të rritur

Të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe

Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos jetë i shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit ,veprimtarisë ose detyrës

Kandidatët duhet të përmbush kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në IP Qendrën për Punë Sociale Tetovë:

Për punën në numrin 1 (një)

Kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen sociale për dhënesin e shërbimeve në sferën e mbrojtjes sociale

Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë qytetarët e Maqedonisë të cilët i plotësojnë kushtet për konkurrim . Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të paraqesë prova të përputhshmërisë me kërkesat në origjinal ose në kopje të vërtetuara nga noteri si dhe dokumentet në vijim

Dëshmi të shtetësisë;

Dëshmi se nuk është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit ,veprimtarisë ose detyrës

Certifikata / diploma për kryerjen e arsimit përkatës

njohuri të vërtetuara me kompjuter për njohjen e programeve të administrimit të zyrës

Dëshmi për njohjen e një nga tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht); Biografi e shkurtër

Letra e motivimit.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40 orë nga e hëna deri të premten nga ora 08:30 deri në 16:30.

Shuma monetare e pagës neto e paguar do të jetë 23.181.00 denarë.

Me kandidatët e përzgjedhur nënshkruhet marrëveshje pune për kohë të caktuar.

Punësimi është në periudhë prej 1 viti, deri më 31.12.2017

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve me dokumentet e kërkuara është 5 ditë pune nga dita pas publikimit të njoftimit (duke përfshirë ditën e postimit vetë). Kushtet e përcaktuara në njoftimin, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Aplikimi me dokumentacionin e kërkuar duhet të dorëzohet në arkivat e IP Qendra për Punë Sociale Tetovë, ose me postë në adresën e mëposhtme:

rr. 121 nr. 2, Tetovë

Resurset njerëzore

(Me theks për") diplomuar Mësues Pedagog të diplomuar

telefoni kontakti 044 331 575

Aplikacionet të cilat nuk arrijnë në kohën e caktuar dhe dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

IP Qendra ndërkomunale për
Punë Sociale Tetovë
D R E J T O R
Naser Sadiki

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, , nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16), nenit 22,23 të Ligjit për marrëdhënie pune („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, , nr. 62/05, 106/08, 114/09, 50/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/15 dhe 27/16) , nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrjet publike („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, , nr. 38/1996,,...39/2016) dhe Rregullores për elementet e obligueshëm të shpalljes publike për plotësimin e vendeve të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe forma, përmbajtja dhe mënyra e udhëheqjes të regjistrimit për persona që kanë dhënë të dhëna të rrejtshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, , nr. 34/15), NKP „Pisha,, f. Likovë,Komuna e Likovës publikon:

SHPALLJEN PUBLIKE NUMËR 03-95/3

për punësimin e (12) dymbëdhjetë personave, dhënës të shërbimeve në kohë të pacaktuar në NKP „Pisha,, f. Likovë, Komunën e Likovës për vendet e punës në vijim :

- 7 (shtatë) realizues** për vendin e punës „Grumbullues të mbeturinave “, shifra e vendit të punës KDR 03 05 V02 002, me arsim fillor , në kohë të pa caktuar;
- 3 (tre) realizues** për vendin e punës „Vozitës të autobusit “, shifra e vendit të punës KDR 03 05 V01 022, me arsim fillor dhe leje për vozitje të kategorisë D, së paku 1 vit përvojë punë në sektorin publik ose privat, në kohë të pa caktuar;
- 1 (një) realizues** për vendin e punës „Vozitës i kamionit “, shifra e vendit të punës të punës KDR 0305 V01 026, me arsim fillor dhe leje të vozitjes të kategorisë C, së paku 1 vit përvojë të punës në sektorin publik ose privat, në kohë të pa caktuar dhe
- 1 (një) realizues** për vendin e punës „Punëtor në deponi “, shifra e vendit të punës të punës KDR 0305 V01 014, me arsim fillor , së paku 1 vit përvojë të punës në sektorin publik ose privat, në kohë të pa caktuar

Kushtet e përgjithshme:

-të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë

-të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedone

-të jetë i moshës madhore

-të ketë aftësi shëndetësore për vendin e punës dhe

-me aktgjykim gjyqësor të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim për ndërprerje të kryerjes të profesionit, veprimtarisë ose detyrave.

Kushtet e veçanta:

-të posedoj kualifikim profesional përkatës për vendin e punës

- të posedoj përvojë pune përkatëse të nevojshme për vendin e punës dhe

- të posedoj kompetenca të punës të veçanta të nevojshme për vendin e punës

Orari i punës :

-ditë të punës: e hënë - e premte

-orë të punës në javë: 40

-koha e punës prej orës: 07:00 deri 15:00

- për vendin e punës me numër rendor 1 (një) „Grumbullues të mbeturinave “, rroga neto bazë 12.112,00 denarë plus shtesa e përvojës së punës nga 0,5 % për çdo vit të përvojës së punës,

- për vendin e punës me numër rendor 1 (një) „ Vozitës të autobusit “, rroga neto bazë 13.261,00 denarë plus shtesa e përvojës së punës nga 0,5 % për çdo vit të përvojës së punës,

- për vendin e punës me numër rendor 1 (një) „ Vozitës i kamionit “, rroga neto bazë 13.261,00 denarë plus shtesa e përvojës së punës nga 0,5 % për çdo vit të përvojës së punës dhe

- për vendin e punës me numër rendor 1 (një) „ Punëtor në deponi “, rroga neto bazë 12.112,00 denarë plus shtesa e përvojës së punës nga 0,5 % për çdo vit të përvojës së punës,

VËREJTJE : Punësimet janë të parapara në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2017 janë: **shqiptar(e)**.

Afati i paraqitjes është 15 ditë pune, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes.

Palët e interesuara duhet të dorëzojnë:

-fletëparaqitje, me shtesë të dokumentacionit të nevojshëm, origjinal ose të vërtetuara te noteri

-paraqitja e biografisë së shkurtë

-diploma e kryerjes të shkallës arsimore e cila kërkohet për vendin e punës,

-vërtetimi për shtetësi

-vërtetimi se nuk i është shqiptuar dënim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë dhe detyrave

-vërtetimi mjekësor për aftësitë e përgjithshme shëndetësore.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm, kandidatët duhet ta dorëzojnë në adresën në vijim:

NKP „Pisha,, f. Likovë, Komuna e Likovës

f. Likovë, Komuna e Likovës, 1307

(me shenjë „ për shpallje,,)

Kandidatët janë të detyruar të dorëzojnë të dhëna precize dhe të sakta.

Selektimi dhe intervista e kandidatëve të paraqitur do ta zbatoj komisioni kompetent për zbatimin e procedurës për punësim.

Kandidatët e paraqitur do të njoftohen me kohë për vendin dhe kohën ku do të mbahet intervista.

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni jo me kohë, jo i plotë dhe jo komplet nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit.

NKP „Pisha,, f. Likovë, Komuna e Likovës
Drejtor
Gazmend Bakiji

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 62/05, 106/08, 161/08, 63/09, 114/09, 130/09, 149/09, 10/10, 50/10, 52/10, 58/10, 124/10, 132/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 106/14, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 134/16), nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 27/14, 199/14, 27/16), nenit 37-e, 37-i, 37-gj të Ligjit për ndërmarrjet publike (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 38/96, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16), Vendimit për nevojë të punëtorit nr. 04-270/1 të datës 03.08.2017, nenit 54 pika 6 e Statutit të NPK “BOSHAVA” Demir Kapi, ndërsa në pajtim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës NPK “BOSHAVA” Demir Kapi nr. 01-64/1 të datës 29.01.2016 dhe Planit për punësim për vitin 2017 dhe Planit për plotësim të Planit për punësim për vitin 2017, Drejtori i ndërmarrjes publikon

SHPALLJE Për pranin të punëtorëve

NPK “BOSHAVA” Demir Kapi ka nevojë për pranin të punëtorëve për kohë të pacaktuar të punës edhe atë për vendet e punës në vijim:

1. Punëtor për grumbullim të mbeturinave – në Departamentin për grumbullim, transport dhe deponim në Shërbimin administrativ-profesional, 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 021, kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri në ditën e premte ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës bazë është 12.753,00 denarë;

2. Pastrues – në Departamentin për grumbullim, transport dhe deponim në Shërbimin administrativ-profesional, 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 020, kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri në ditën e premte ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës bazë është 12.753,00 denarë;

3. Klorinator – në Departamentin për hortikulturë, ujësjellës dhe kanalizim, Shërbimi administrativ-profesional, 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 B04 057, kandidatët të kenë të arritur së paku nivelin e kualifikimit IV, 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose arsim të mesëm katërvjeçar – Kimik-teknologjik, makinerisë ose elektroteknik, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri në ditën e premte ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës bazë është 13.704,00 denarë;

4. Punëtor i përgjithshëm komunal - në Departamentin për hortikulturë, ujësjellës dhe kanalizim, Shërbimi administrativ-profesional, 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 V02 001 kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri në ditën e premte ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës bazë është 12.753,00 denarë;

5. Mirëmbajtës të higjienës – në Departamentin për punë administrative, Shërbimi administrativ-profesional, 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 04 01 A03 005, kandidatët të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune në profesion, orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri në ditën e premte ose 40 orë në javë, shuma në të holla e neto pagesës bazë është 12.753,00 denarë;

Kandidatët parashtrojnë fletëparaqitje që duhet të përmbajë:

1. të dhëna personale për kandidatit,

2. të dhëna për përmbushje të kushteve të përgjithshme,

3. të dhëna për përmbushje të kushteve të posaçme,

4. deklaratë me vërtetim se të dhënat e shënuara në fletëparaqitje janë të sakta, ndërsa dëshmitë e parashtuara janë të besueshme me origjinalin si dhe në pajtim me të gjitha informatat t'i dorëzohen në e-mail adresë ose përmes SMS porosisë në telefon celular, gjegjësisht në adresën e shënuar në fletëparaqitje,

5. datë të paraqitjes dhe nënshkrim të kandidatit.

Kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për marrëdhënie pune ose marrëveshjen kolektive janë:

1. Të jetë shtetas i RM;

2. Të jetë i moshës së rritur;

3. Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe;

4. Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët krahas fletëparaqitjes për punë të dorëzojnë dëshmi për arsimin e mbaruar dhe të parashtrojnë dëshmi për përmbushjen e kushteve të tjera të posaçme për vendin e punës.

Vërejtje: fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Shpallja është e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit.

Nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatët për një vend pune, zgjedhja e kandidatëve bëhet në afat prej 60 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatë prej 90 ditë, mbi 500 kandidatë prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në arkivin e NPK BOSHAVA Demir Kapi rr. Jane Sandanski pn Demir Kapi.

NPK BOSHAVA Demir Kapi
Drejtor
/Zvonko Kiçukov /

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), Ministria e Arsimit dhe Shkencës publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

Shpallja përfshinë punësim të 1 (një) realizuesi për kohë të pacaktuar për vendin e punës në vijim:

- Vozitës - 1 realizues;

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, në mënyrë aktive të njohin gjuhën maqedonase, të jenë të moshës së rritur, të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos u jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Arsim të mesëm dhe
- Leje të vozitjes të kategorisë B

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, gjegjësisht më së voni deri më 10.08.2017 deri në ora 16:30, ndërsa zgjedhja e kandidatëve do të realizohet më së voni deri më 25.08.2017.

Për vendin e lartpërmendur të punës, orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë pune (8:30-16:30), ndërsa pagesa bazë është 13.843,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen krahas biografisë së shkurtë, kandidatët janë të obliguar që të parashtrojnë edhe dëshmi përkatëse në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, në pikëpamje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme edhe atë:

Diplomë për arsim të mesëm të mbaruar që kërkohet për vendin e punës, Leje të vozitjes të kategorisë B, Certifikatës së shtetësisë, Certifikatës së njekut dhe Certifikatës e nuk është shqiptuar ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Dokumentet e kërkuara parashtrohen në zarf të mbyllur me shënim “Të mos hapet”, në adresën në vijim:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Departamenti për menaxhim me resurset njerëzore

Bul. “Sv. Kiril i Metodi” 54 Shkup

(me shenjë “për shpallje”)

Shkup

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës



Manchester Siti në kuadër të operacionit spastrimi, ka hapur dyert për disa futbollistë të cilët i cilësojnë si ta panevojshëm dhe njëri prej tyre është Samir Nasri. Ekipi francez i Nica ka shfaqur interes për shërbimet e lojtarit, ndërkohë që klubi anglez kërkon jo më pak se 10 milionë euro

Siç shkruan gazeta "Marca", tek Atletico Madrid kanë marrë frymë lirisht, sepse Antoine Grizman, lojtar i përmendur si synim i Barcelonës, nuk ka shans të transferohet në "Camp Nou". Arsyeja është e thjeshtë. Presidenti i nënkampionëve të Spanjës, Josep Maria Bartomeu, i ka garantuar shefit ekzekutiv të bardhekuqve, Miguel Angel Gil Marin, se nuk do të përpiqet ta kryejë këtë operacion të bujshëm

Edhe në ditët më të vështira, Barcelona është pikërisht si parulla e saj e përjetshme, "më shumë se një klub". Katalanasit nuk e kanë më yllin e skuadrës, Neymar, por kjo nuk do të thotë se do të tregohen të pamëshirshëm në treg për të gjetur pasuesin e tij. Siç shkruan gazeta "Marca", tek Atletico Madrid kanë marrë frymë lirisht, sepse Antoine Grizman, lojtar i përmendur si synim i Barcelonës, nuk ka shans të transferohet në "Camp Nou". Arsyeja është e thjeshtë. Presidenti i nënkampionëve të Spanjës, Josep Maria Bartomeu, i ka garantuar shefit

Barcelona ruan miqësinë me Atletikon

Nuk do të bëjë përpjekje ta transferon Grizmanin



ekzekutiv të bardhekuqve, Miguel Angel Gil Marin, se nuk do të përpiqet ta kryejë këtë operacion të bujshëm. Duke mar-

rë parasysh interesin e madh të klubeve, Atletico Madrid para një muaji e ngriti nga 100 në 200 milionë euro klauzolën e largimit të sulmuesit. Bartomeu, kështu, ka telefonuar drejtuesin madrilen vetëm për ta pyetur për gjendjen aktuale të lojtarit dhe nëse ekziston mundësia për ta blerë. Gil Marin i është përgjigjur se klubi do të vuante shumë nëse Grizman do të largohej, sepse dënimi i FIFA-s me ngrirjen e merkatos hyrëse nuk e lejon ta zëvendësojë. Bartomeu ka kuptuar se Atletico Madrid nuk do të hynte kurrsesi në negociata për shitjen e 24-vjeçarit, madje as për shifrat e përmendura në medie, kështu që ka vendosur të ruajë miqësinë ndërmjet klubeve. Kjo është diçka shembullore!

Milani "troket" te Çells



Kërkon huazimin e Diego Kosta

Ka të reja në rrugën që mund ta çojë Diego Kosta te Milan! Kuqezinjtë mbeten në kërkim të një qendërsulmuesi dhe spanjollit është në listën e kandidatëve bashkë me Kaliniç, Beloti, Aubamejang dhe Ibrahimoviç, aksionet e të cilëve ulen e ngrihen çdo ditë në bazë të drejtuesve dhe menaxherëve të tyre. Por, Mirabelli dhe Fassone kanë bërë një hap përpara në krahësim me dje, duke kërkuar zyrtarisht te Çells huazimin për një sezon. Kjo lëvizje duket se i pëlqen të gjitha palëve, mbi të gjitha futbollistit, që është në kërkim të një klubi me nivel të lartë, ku të luajë titull dhe të mos humbasë vendin në "Rusi 2018". Huazimi është mënyra që i pëlqen lojtarit të lindur në Brazil, pasi do të kishte sërish mundësinë të shkonte te Atletico Madrid, destinacioni i tij i preferuar, në momentin që FIFA do t'i heq embargon e merkatos skuadrës drejtuar nga Simeone. Edhe Çells do të ishte "pro" huazimit të një futbollisti që nuk është më në planet e Konte.

50 mln euro dhe 7.5 mln euro në sezon për lojtarin

Interi nuk heq dorë nga Vidal



"Nuk di asgjë, kam qenë me pushime", janë këto fjalët e para të Arturo Vidal. Gjumash, miqësor dhe misterioz. Vidal driblon në mënyrë të tillë një pyetje të bërë për interesimin e Interit karshi tij dhe e bën me këto fjalë të shoqëruara nga një buzëqeshje, ku nuk konfirmohet asgjë, por as nuk përgënjeshtrohet asgjë. Mesfushori i Bajern Muniht,

i kthyer prej pak ditësh në ekipin bavarez, pritet të luajë në miqësoren kundër Napolit dhe në rrjetet sociale është shprehur: "Ky vit, pa asnjë dyshim, do të jetë i imi". Mbetet për t'u kuptuar se në çfarë kampionati do të luajë dhe çfarë fanelle do të veshë. Klubi i Bajern Muniht ka ndërmend të heq dorë nga Vidal, por kiliani do të ishte gati

për një rikthim në Itali. Marrëveshja me Interin është aritur prej kohësh. Atë e pret një kontratë katër vjeçare me zikaltrit mbi bazën e 7.5 milionë eurove në sezon. Inter është gati të ofrojë edhe 50 milionë euro për të bindur Bajernin. Një ofertë shumë e lartë për një 30-vjeçar, që u ble për 35 milionë euro para dy vitesh.

Publicitet

Martial i hapur për kalimin tek Interi

Junajted nuk heq dorë nga Perishiç

Antoni Martial raportohet se është gati të shkojë tek Interi si pjesë e marrëveshjes që do të sillte Ivan Perishiç te Manchester Junajtedi. Sipas Zhan-Lukas Maskaro të calciomercato.com, Junajted nuk i ka humbur shpresat për transferimin e Perishiç dhe ka qenë në kontakt konstant me agjentin e lojtarit Fali Ramadani për të rihapur dialogun me



Zikaltrit të cilët nuk janë gati të pranojnë një ofertë poshtë 50 milionë euro.

Si rezultat i presingut konstant të Junajted, Interi ka ringjallur interesin për Martial teksa kanë marrë "Po" e lojtarit. Francezi nuk arriti të zhvillonte një sezon të parë impresionues tek Junajted por ka qenë në formë mjaft të mirë në fazën përgatitore nën drejtimin e Hoze Murinjos, i cili vështirë se do ta linte të largohej talentin 21-vjeçar.

Sipas "Le10Sport"

Mbape largohet nga Monako këtë verë

Mbape ka vendosur për të ardhmen. Dhe me sa duket është larg Monakos.

Sipas Le10Sport, 18-vjeçari ka vendosur të largohet nga ekipi aktual. Dhe tani mbetet për t'u gjetur destinacioni i ri. Ka shumë klube që do të ishin të lumtur të kishin super talentin e Evropës. PSZH, është e para, dhe po lufton për shërbimin e tij, por pas transferimit të Neymar do ta kishte

problem financiarisht ta blinte francezin.

Barcelona është një tjetër kandidat, paratë nuk mungojnë pas shitjes së Neymar. Një nga tekenovelat më të mëdha të verës mund të jetë drejt fundit.

Pas shitjes së Moratas, transferimit të Neymar, tashmë ka mbetur Mbappe. Pasi humbi Superkupën franceze një javë më parë, Mbappe mund të ketë vendosur të



largohet nga Monako përfundimisht.

Organizata Humanitare "Ogranok na MIHO" Tetovë në bazë të vendimit numër 203-5819-38 të datës 25/07/2017 bën Shpalljen Publike për ndërmarrjet që merren me rruajtjen, rritjen dhe tregtinë me kafshë të imta ose të mëdha që sipas traditave rajonale të vendit tonë, mund të përdoren dhe janë të përshtatshme për Kurban në ditën e festës së Kurban Bajramit 2017.

Sipas kësaj, të gjitha subjektet juridike që e kryejnë veprimtarinë në fjalë, duhet që të dërgojnë ofertat e tyre me shkrim edhe atë për

1. Kafshë të imta – DELE me madhësi mesatareÇmimi për kokë
2. Kafshë të imta – DESHE me madhësi mesatare Çmimi për kokë
3. Kafshë të imta – DHI me madhësi mesatare Çmimi për kokë
4. Kafshë të imta – CIAP me madhësi mesatare Çmimi për kokë
5. Kafshë të mëdha – LOPË me peshë mbi 300 kgr Çmimi për kgr /peshë e gjallë
6. Kafshë të mëdha – MUZETER me peshë mbi 300 kgr Çmimi për kgr/peshë e gjallë

Ofertat duhet të jenë me shkrim dhe të dërgohen me rekomandim në adresën e Organizatës humanitare në Tetovë deri më datë 4/08/2017 dhe sipas Ofertave të pranuar, komisioni zgjedhore do bëjë përzgjedhje të ofertës më të mirë dhe më të përshtatshme, për të cilën gjë Kompania fituese do jetë e lajmëruar me kohë që të përgatitet edhe nënshkrimi i kontratës me firmën fituese.

Kushtet tjera të përgjithshme që duhet të plotësohen nga ana e Kompanive që do dorëzojnë Ofertat janë :

- Në çmimin e ofruar për secilëndo ofertë pikë të shpalljes, kompanitë duhet të përfshijnë edhe
- transportin,
- thyerjen e kurbaneve,
- përgatitjen për thyerje,
- paketimin,
- copëtimin e mishit,
- vendosjen nëpër qese me Logon e Organizatës,
- distribuimin deri te shfrytëzuesit e këtij Projekti nëpër qytetet e Republikës me mjete transporti me frigo, sipas orarit të përgatitur nga ana e organizatës dhe datave të caktuara paraprakisht gjatë ditëve të Kurban Bajramit

Adresa e organizatës Humanitare është Rr. K. J. Pitu 99 Tetovë. Tel për kontakt 044/332-554
Ofertat e dërguara pas afatit të caktuar, nuk do merren parasysh gjatë vendosjes së ofertës me të mirë.

TETOVË 01/08/2017 Nga Drejtoria

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093



Nuk jemi të lumtur me situatën aktuale. Por sezoni akoma nuk ka filluar akoma dhe ndeshja e parë e vërtetë luhet të shtunën (Superkupa gjermane ndaj Dortmund)

Nga Maradona te Neymar, historia e largimeve të mëdha nga Barcelona

Historikisht, Barcelona ka pasur gjithmonë probleme me figurat e saj të mëdha. Klubi katalanas është përpjekur gjithmonë që të ketë lojtarët më të mirë në botë, ia ka arritur kësaj, por shumica e tyre kanë shkuar nga dera e pasme. Kjo gjë filloi me Maradonën, u pasua nga Figo, Laudrup, Shuster, Rivaldo, Romario, Ronaldinjo dhe përfundon, të paktën deri më tani, nga Neymar.



Maradona ishte një nga blerjet e para të mëdha të Barcelonës. Ai u bashkua me klubin katalanas në sezonin 1982-1983, i ardhur nga Boka Juniors. Qëndroi aty për dy sezone, me një paraqitje të parregullt. Lëndimi i rëndë, i pësuar pas një ndërhyrjeje të ashpër të Goikoetçea, lojtar i Atletik,

ishte një nga shkaqet që performanca e tij nuk rezultoi siç pritej, pa haruar jetën e tij të keqe jashtë fushe. Më 5 maj 1984, në fund të finales së Kupës së Mbretit (humbja 1-0 kundër Atletik) ishte protagonist i një rrahje të rëndë ndërmjet lojtarëve të të dy ekipeve. Ai sulmoi Miguel Angel Sola dhe u ndalua për tre

muaj, pa qenë në gjendje të luajë. Ky sanksion, ndjenja pak e mbështetur nga direktiva dhe problemet ekonomike për shkak të keqmenaxhimit të përfaqësuesit të tij, Jorge Çysterpillar, udhëhoqën lamtumirën e tij për Barcelonën. Napoli pagoi për të 1.185 milionë pesetas (rreth 7,100 milionë euro).

Ronaldo

Ronaldo Nazario, që ta dallojmë atë nga Kristiano Ronaldo, arriti te Barcelona nga PSV në sezonin 1996-1997. Ai bëri një sezon sensacional, duke shënuar 34 gola në 37 ndeshje në ligë, disa prej tyre shumë spektakolare, ashtu siç bëri në fushën e Kompostela, ose në shtëpi, ndaj Valencias.

Çdo gjë dukej rozë. Por në fund të sezonit, kur filluan negociatat për të ripërtërirë kontratën, u duk tashmë se gjërat nuk po shkonin mirë. Ishte një takim i tensionuar, që përfundoi në mënyrën më të keqe të mundshme dhe në qershor 1997 pranoi një ofertë nga Interi. Brazili u largua duke lënë arkat e klubit të futbollit 4.000 milionë pesetas.

Luis Figo

Luis Figo ka qenë, pa dyshim, largimi që ka bërë më shumë dëm për Barcelonës. Së pari për shkak se ai shkoi te Real Madridi dhe, së dyti, për shkak se "barcelonistas" gënjyen. Ai arriti te Barcelona në sezonin 1995-1996 nga Sporting i Portugalisë dhe kaloi pesë vite në klubin katalanas, duke bërë paraqitje të mëdha. Ai kaloi ditët duke shitur për tifozët

dashurinë e tij për ngjyrat blu dhe të kuqe, por asgjë nuk bëri kur Florentino Perez pagoi klauzolën e tij, 61 milionë euro, në korrik të vitit 2000.

Këto ishin tri rastet më famëkeqe, por ka pasur lojtarë të tjerë të rëndësishëm, të cilët, gjithashtu, e lanë Barcelonën nga dera e pasme. Bernd Shuster, për shembull, ishte ai që, kur përfundoi kontratën e tij, la asgjë më shumë dhe asgjë më pak se Real Madridin. Kështu bëri Michael Laudrup. Rivaldo shkoi nga hero në horr dhe përfundoi duke u larguar nga klubi i tij si një lojtar i lirë për të marshuar në Milano. Romario ka zgatur vetëm një sezon në Barcelonë dhe vendosi për të vazhduar në Brazil. Edhe Ronaldinjo, idhull te Barcelona, mbledhi plaçkat dhe shkoi te Milani.

Nejmar shkriu "MSN", tredhëmbëshin që shkroi historinë e futbollit

Për vite me siglën "MSN" njihej një nga sistemet e para që mundësonte dërgimin dhe marrjen e mesazheve të dërguara në moment, që ndoshta mbahet mend nga më të rinjtë me një farë nostalgjie. Në 2014-ën Barcelona krijoi sulmin e ëndrrave, një tredhëmbësh të gjithin amerikano-jugor, të përbërë nga tre lojtarët më të fortë të vendeve të tyre: Messi, Suarez dhe Neymar. Për të gjithë është krijuar menjëherë "MSN", një sinonim i golit. Lamtumira e brazilianit ka shkruar një nga sulmet më të forta të historisë së futbollit, i aftë të arrinte shifra dhe statistika si alieno të vërtetë të sportit më popullor në botë.



Në tre sezone, "MSN" ka luajtur një total prej 8.896 minutash në 110 ndeshje, duke i dhuruar Barcelona-s 84 fitore, 76% të ndeshjeve të zhvilluara. Shifra këto që e kanë lejuar klubin spanjoll të ngrejë në qiell 10 trofe: 1 "Champions League", 1 Superkupë të Evropës, 1 Botëror për

Klube, 2 La Liga, 3 Kupa të Mbretit dhe 2 Superkupa të Spanjës. Në vetëm 3 vite, "MSN" ka hyrë në historinë e futbollit. Në fakt, janë 228 golat e realizuar nga kjo treshe. 228 gola në 110 ndeshje do të thonë një gol çdo 39 minuta, praktikisht

një për çdo pjesë loje, me ata në fushë, Barcelona e niste ndeshjen 2-0 në avantazh.

Në sezonin 2014/2015, "MSN" ka realizuar 122 gola (35 Messi, 42 Suarez dhe 43 Neymar), më i miri për brazilianin me fanellën numër 11. Një vit më pas kanë bërë akoma më mirë, duke realizuar 131 gola, 59 prej të cilëve nga Luis Suarez (41 për Messi, 31 për Neymar). Ky i fundit ka qenë më "zhgënjyesi", me 101 gola, 51 prej të cilëve janë shënuar nga Messi, 34 nga Suarez dhe 16 nga Neymar. Tani, Barcelona do të kërkojë të ndërtojë një tredhëmbësh të ri, që të paktën të jetë në gjendje t'i afrohet atij të tre viteve të fundit, por nuk do të jetë një detyrë aspak e lehtë.

Bajern Munihi po vuan



Ançeloti thotë se nuk ka më blerje

Bajerni nuk e di se ku ka e kokën. Forma fizike e lojtarëve është skandalozë dhe kjo fjalë nuk është aspak ekzagjerim. Në gjashtë ndeshjet miqësore të luajtura këtë verë, skuadra e trajnerit Karlo Ançeloti ka fituar vetëm një dhe ka humbur pesë. A mjafton si argument? Humbja e fundit e bavarezëve ndodhi dje në "Allianz Arena". Në ndeshjen për vendin e tretë dhe të katërt të turneut "Audi Cup" kundër Napolit, rekordmenët u mposhtën 2-0. Fjalët e para të tifozëve, të cilët u larguan nga stadiumi para se të mbyllej ndeshja, ishin për blerje të tjera, sepse, sipas tyre, kjo skuadër nuk mjafton për të fituar Ligën e Kampionëve. Megjithatë, Ançeloti nuk mendon kështu. "Jo, nuk do të ketë afrime të reja", - u shpreh italiani. Lajmi tjetër i keq që mori Bajern është dëmtimi i yllit Hames Rodriguez, i cili do të jetë jashtë fushave për katër javë. "Nuk është mirë ta shohim Hamesin të dëmtuar, sepse është lojtar i klasit botëror. Gjithsesi, kemi një departament mjekësor të shkëlqyer dhe do të përpiqemi ta kthejmë sa më shpejt në aksion", - u shpreh drejtori i ri sportiv i skuadrës kampione të Bundesligës, Hasan Salihamixhiç.

Koreografi "makthi", një pistoletë naziste në kokën e një fëmije

Një koreografi unikale dhe mbresëlënëse, me flamuj të shumtë, të bardhë e të kuq, me një datë të shkruar me të zezë: "1944". Mbi të gjitha edhe një banderolë që nuk lë hije dyshimi: "Gjatë revoltës së Varshavës gjermanët vranë 160 mijë njerëz dhe mijëra prej tyre ishin fëmijë." Një pamje e tmerrshme me një SS nazist, pa fytyrë, që i vendos një pistoletë në kokë një fëmije me kapelën, që mbante flamurin pokal. Kjo ka ndodhur në stadiumin e Varshavës, gjatë ndeshjes së Champions Ligës, kundër As-



tana, që u kualifikuar pikërisht në dëm të Legia. Për-

para se të fillonte loja, ka qenë kjo mënyrë e zgjedhur

nga tifozët për të kujtuar përvjetorin e rebelimit të Varshavës. Protestat nisën më 1 gusht 1944 dhe u mbyllën me gjakderdhje nga gjermanët më 2 tetor me një repretalje masive. Hitleri dha urdhër për asgjësimin total të qytetit. Përpara se të fillonte loja, futbollistët e të dyja skuadrave u ndalën në mesfushë dhe u përfaquan me njëri-tjetrin, duke mbajtur një minutë heshtje. Në shkallët e stadiumit nuk pati heshtje, për u këndua një këngë patriotike polake, gjithmonë të shoqëruar nga koreografia mbresëlënëse.

DASHI (20/III-20/IV)



Po iu hapen mundësi të reja për fitim dhe prisi të përfiton nga trashëgimia, partneri apo loja ma fat. Por nëse shpenzoni shumë, në mënyrë negative do të ktheni vëmendjen nga ju. Raporti me dikë nga familja do të kërkojë më shumë takt dhe tolerancë.

DEMI (21/IV-20/V)



Një pjesë e madhe e energjisë do të shpenzoni në punë tregtare. Disa mundësi nga jashtë do të jenë burim potencial i fitimit. Njerëzit me të cilët jeni emocionalisht të lidhur do të jenë përkrahje e madhe, por do të kërkojnë edhe diçka si rikthim.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Do të kënaqeni me kafe me miqtë, e nëse kushtet në punë nuk ua lejojnë pauzën më të gjatë, të mrrolur do t'iu ktheheni punëve tuaja. Pak më të kënaqur do të jeni nëse punoni në mjedis plot mirëkuptim dhe nëse keni për rreth njerëz që iu vlerësojnë.

GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Shkaku i trazirave të brendshme do t'iu mendojë kokëdhimbja, e ka mundësi edhe sëmundje të tjera. Nëse kujdeseni për secilin detaj, mund të ndodh që të humbni qasje në gjërat tërësisht. Përqendrohuni në atë që ka rëndësi dhe mos i lejoni tjerët që të ju pengojnë.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Do të jeni shumë nervoz, e në raport me fëmijët do t'iu mungojë durimi dhe qetësia. Dalja me shoqëri do t'iu sjell takimin me personin i cili ka pas rëndësi për ju, por reagimi i tij s'do t'iu pëlqejë. Përpuni të mbani kontroll mbi veprimet.

VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Miqe dhe bashkëpunëtorë tuaj do t'iu jepni këshilla të mira, por kur do t'iu duhej t'i zgjidhni problemet tuaja, do të jeni shumë të pasigurt dhe të pavendosur. Do të ndjeheni më mirë në punë sesa me familje. Kujdesi për shtëpi dhe familje do t'iu lodh shumë.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Nuk do të nervozoheni nëse gjërat nuk zhvillohen ashtu si keni pritur; besimi në rezultat të mirë nuk do t'iu braktisë. Nëse ju jepet rasti për një shoqërim të këndshëm, do ta shfrytëzoni pavarësisht a jeni të lirë apo jo. Kujdes që mos t'ia teproni me ushqim dhe alkool.

AKREPI (22/X-21/XII)



Do të ngopeni me punë dhe obligime të përditshme. Do të ndjeni dëshirën për ndryshim por asgjë serioze nuk do të bëni. Kini kujdes me para dhe të gjitha transaksionet financiare. Nëse kushëri apo fqinji kërkojnë ndihmën tuaj, gjeni kohë t'i dëgjoni.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Do të jeni shumë ambicioz dhe plot vetëbesim. Do t'iu përgjigjet jeta aktive shoqërore, si dhe komunikimi më i gjallë dhe më i dashur me bashkëpunëtorët. Do t'iu duhej vërtetimi i rrethit që po punoni mirë, përndryshe nuk do të bren-goseni me frikë nga rezultatet e këqija.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Do të hasni në njerëz që do të zgjojnë pasiguri në ju dhe do të ballafaqoheni me probleme për të cilat keni menduar se i takojnë të kaluarës. Nëse jeni në lidhje, me heshtjen tuaj dhe sjellje të mërzitura do të thelloni krizën. Mendoni mirë para se të sillni në pyetje lidhjen apo martesën.

UJORI (20/I-19/II)



Me shumë sukses do të zgjidhni çështjet financiare, kursimet apo trashëgimin. Burimet e reja të përfitimt po ju presin, por kos pranoni detyra që mund të dëmtojnë një projekt të rëndësishëm në të cilin po merrni pjesë. Kujdes që shkaku i 'moskujdesit' dhe vozitjes së shpejtë të bëni ndonjë aksident.

PESHQIT (20/II-19/III)



Shoqërimin me familje, fqinjët apo miqtë e vjetër nga shkolla do ta intensifikoni. Nëse vendosni që kohën e lirë prapë ta kaloni në koncert, ekspozitë apo tubim shoqëror do të kaloni për mrekulli. Nëse ju pëlqen dikush, gjeni mënyrë që t'ia tregoni këtë.



KOHA	POSTI I POLITIKANIT NE FOTO (2009-2017)	RUMANIA	NGJYRË E ÇELË	QYTET NË OREGON ...BIÇ	JO RELATIVE	FUTBOLLISTI I KOMBETARES, ERVIN FUTBOLLISTI FRENG, TIERI	Mensur Mamuti	POLITIKANI AMERIKAN NE FOTO	POROSIA PARA VDEKJES	KRYEQYTETI I HAWAII, Vendlindja E POLITIKANIT NE FOTO	OTURAK SHURRETORE
PREZENCA							KOMPOZITORI GJERMAN, JOHAN SEBASTIAN (SHQ.)				
REOMIRI		QYT. NË UKRAINË (KATASTROFA NUKLEARE) KËSHILLA, MESIMI					PERËNDIA ROMAKE E DASHURISË				
MBILËKURA							FUTBOLLISTI GJERMAN, KEDIRA				
HEROI MIC							MBAN NJERËNANË SQIFURI				
AKTORJA KOSOVARE, CAHANI						MINERALI QË DEL NGA VULLKANI TOKAT E PUNUARA	AKTORI AMERIKAN, PITER NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE				
NOTË MUZIKORE			ZOTI I DËNIMIT SIPAS MIT. MONGOLE ERAN SHAHAR BEN								POLITIKANI SHQIPTAR, NGJELA
LLOJ VEPRE LETRARE				PERSISHT SHQIPËRIA					UNITED STATES MËRGIM		
LUMË NË BULLGARI DHE SERBI							AKTORJA AMERIKANE, UEST AKTORJA AMERIKANE, FAROU				FOSFORI GRUJAJA E POLITIKANIT NE FOTO
HAPET, ILAÇET											LIDHJA KOMUNISTE

ZGJIDHJET: BAHU, AMOR, RANI, ANON, SKELA, PRANIA, O TUL, R, ÇERNOBIL, EPIDERMA, US, SOKOLI, ME, P, IRENA, MAGMA, DO, ATAI, ZIR, ESE, IRANISHT, NISHAVA, ALEA, TABLETAT, LK.

Sudoku

shumë i lehtë

shumë i vështirë

			5	1						4						9		
1	7					3							9	1				
		3	6			9	7			6			4			3	7	
		9	2					6		8			4			3		6
8															9		5	
4		7				5	2					5				2		
		5	7			8	2					7	2					3
				9						3								
				6	2		4					3	6		7		8	5

Shumë i lehtë: 946517382, 178423956, 253689714, 592134678, 861275493, 437896521, 315748269, 624951837, 789362145. Shumë i vështirë: 453782961, 827961534, 691453728, 948527316, 236149857, 175836249, 782615493, 514398672, 369274185.



Sarkazma të bën njeri më të mirë

Të gjithë bëjnë ndonjë koment sarkastik herë pas here, dhe ata që identifikohen si sarkastikë nga natyra nuk mund të mos e bëjnë këtë humor verbal. Sarkazma mund të jetë një biletë e shpejtë për t'u keqkuptuar prej të tjerëve, por nuk është domosdoshmërisht një tipar i keq i personalitetit. Ka shumë gjëra pozitive kur ke një personalitet sarkastik. Studimet tregojnë se sarkazma është shenjë e një shëndeti të mirë mendor. Ajo të ndihmon të përzgjedhësh miq, sepse këta njerëz që kuptojnë dhe duan që të rrethohen nga vlerësojnë sensin e tyre të



humorit. Një studim i kohëve të fundit zbuloi se komentet sarkastike janë shenjë krijueshmërie, si dhe mendimi abstrakt. Studimet tregojnë gjithashtu se trurit i duhet të punojë më shumë për të përpunuar një thënie sarkastike, prandaj njerëzit e tillë kanë tru më të mprehtë. Sarkazma luan gjithashtu një rol në aftësitë e mbijetesës në shoqëri. Sarkazma është pjesë e sjelljes njerëzore, kështu që sa më shumë të identifikoheni me të, aq më mirë.

Diamanti i rrallë i kuq në ankand për 10 milionë dollarë



Diamantët e kuq janë më të rrallët absolutisht. Ai që arrin të mbajë një të tillë në dorën e tij është me të vërtetë me fat. Kështu thotë Graeme Thompson i shtëpisë së ankandëve Bonhams që do të nxjerrë shumë shpejt në shitje të çmuarën Argyle Everglow, një diamant i kuq nga 2.11 karat. Për të kuptuar se sa i rrallë është ky gur i çmuar mjafton të dish se Rio Tinto, shoqëria pronare e minierës australiane Argyle, që ka nxjerrë diamantin, ka nxjerrë vetëm 20 ekzemplarë të diamantit të kuq në 33 vitet e fundit të aktivitetit të saj. Diamanti do të dalë në ankand për çmim bazë prej 10 milionë dollarësh, bëjnë të ditur burime. Everglow nuk është më pak i çmuar mes diamanteve të kuq të ekzistojnë, i pari është gjetur në Brazil në 1990 Moussaieff Red, 5.11 karat.

Charlize Theron, biondja atomike

Në filmin "Atomic Blonde" (28 korrik), Charlize Theron luan rolin e Lorraine Broughton, një agjente e MI6 dërguar në një mision në Berlin në vitin 1989, pesë ditë përpara se të binte Muri. Filmi është i mbushur me festa underground dhe aksion, mbështetur nga muzikë pop e viteve 80.

Lorraine, bazuar në një personazh nga romani grafik "Qyteti më i Ftohtë", nuk është si shumica e heroinave femra: ajo nuk është një e ve e pikëlluar, ajo nuk është një nënë protektive dhe ajo definitivisht nuk ka

probleme të babait. "Shkrimtarët gjithmonë u japin grave, burra të vdekur ose fëmijë që t'ju bëjnë të investoheni emocionalisht", thotë Theron për revistën TIME. "Burrat shkojnë në një udhëtim argëtues. Grave u duhet një histori dhe një sfond i gjatë, me qëllim që ju t'i falni për atë që do të bëjnë". Por jo Lorraine. Ajo bën gjithçka që burrat kanë bërë gjithmonë - duke përfshirë shkëmbim goditjesh dhe plumbash - vetëm se së prapthi dhe me taka. Deri kur merr një nga ato taka dhe e përdor si armë.




KALENDARI HISTORIK 4 GUSHT

- 939 - Beteja e Simankas-Spanja mund Murët.
- 1538 - Bogotá në Kolumbi themelohet nga Gonzalo Jiménez de Quesada.
- 1661 - Traktati i Hagës nënshkruhet nga Portugalia dhe Republika holandeze.
- 1726 - Perandori Karli VI dhe carina Katerina e Madhe nënshkruajnë traktat ushtarak.
- 1819 - Themelohet Universiteti i Norwich-it në Vermont si shkolla e parë private ushtarake në SHBA.
- 1825 - Bolivia fiton pavarësinë nga Peru (Dita Kombëtare).
- 1845 - Themelohet Shoqata Gjeografike Ruse në Shën Petersburg.
- 1870 - Beteja e Spiherenit: Prusia mund Francën.
- 1896 - Franca përvetëson Madagaskarin.
- 1914 - Austro-Hungaria i shpall luftë Rusisë dhe Serbisë.
- 1940 - Estonia bëhet pjesë e Bashkimit Sovjetik.
- 1962 - Xhamajka shpall pavarësinë pas 300 vjet sundimi britanik.

A E DINI SE... ?

A e dini se arsyeja më e mundshme që qentë hanë bari është sepse ata kanë stomak të dobët. Do të vëreni se normalisht qentë nuk hanë bari në sasi të madhe, por ata marrin disa fije të barit të cilat pastaj i përtypin me një shpejtësi minimale. Shija e barit njëherë do t'ia përziejë stomakun qenit, por pastaj do ta bëjë të ndihet më mirë.



E dini se çdo dite trupi prodhon 1.5 litër pështyme, pra rreth 40.000 litra gjate gjithë jetës? Në fakt, pështyma është shume e nevojshme për mbijetesën pasi ajo e bën me te lehte gëlltëjen, tretjen, ndihmon në pastrimin e gojës dhe luan rol të madh në shijim.



BARSOLETA



NË SPITALIN PSIKIATRIK

Një burrë dhe një grua. Të shtruar në Spitalin Psikiatrik. Një ditë kishin dalë dhe po bënin xhiro rreth pishinës. Papritur burri rrëshqet dhe bie në pishinë. Gati po mbytej. Hidhet gruaja dhe e shpëton. Gruas, vendosin t'i japin medalje dhe ta nxjerrin nga spitali, sepse mendonin që ishte shëruar tashmë. I thotë drejtori i spitalit: - Kam dy lajme. Një i mirë dhe një i keq. Po të jap të mirin në fillim. Ti do dalësh nga spitali, sepse je shëruar plotësisht.
- Po i keqi?, - e pyet gruaja.
- I keqi është se ai burri që shpëtove, e kishte ndarë mendjen për të vdekur. Ishte vetëvarur tek dushi, - i thotë drejtori me zë të dridhur.
- Jo, jo, drejtor, - thotë gruaja. E vara unë të thahej, pasi kur e nxora nga pishina ishte i lagur...

THËNIA E DITËS

Kurrë mos hiqni dorë nga një ëndërr, thjesht sepse do të duhet kohë për ta arritur. Koha do të kalojë gjithsesi. (Earl Nightingale)

